

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Lënda Nr. P 8/13 (PPS 425/09)

Data: 01 korrik 2013

AKTVENDIM

LIDHUR ME KUNDËRSHTIMET NDAJ PROVAVE

DHE KËRKESAT PËR TË RRËZUAR AKTAKUZËN

Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska - Gallant, duke vepruar si kryetare e trupit gjykues,

Në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. F.L.
2. Fl.L.
3. D.L.
4. E.L.
5. N.K.
6. F.Z.
7. G.Z.

Të akuzuar me këto vepra penale:

1. F.L., Fl.L. D.L., E.L. dhe N.K., me krim të organizuar, në shkelje të Nenit 274 paragrafi 3 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012 ("KPK i vjetër") lidhur me paragrafin 1 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me

- burgim nga shtatë deri në njëzet vjet, lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje);
2. F.L. dhe N.K., me përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, në shkelje të Nenit 340 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga një deri në dhjetë vjet, lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje);
 3. F.L., N.K., E.L. dhe F.Z., me lidhje të kontratës së dëmshme, në shkelje të Nenit 237 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga një deri në dhjetë vjet, ku kryerësit e veprës shkaktojnë dëme që e kalojnë shumën 100.000 euro, lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje) dhe me Nenin 25 të KPK-së së vjetër (ndihmë) për sa i përket E.L. dhe F.Z.,
 4. F.L., N.K. dhe E.L., me shpërdorim të pozitës ose autoritetit zyrtar, në shkelje të Nenit 339 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga një deri në tetë vjet; lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje) për sa i përket F.L. dhe N.K., dhe lidhur me Nenin 25 të KPK-së së vjetër (ndihmë) për sa i përket E.L.; dhe gjithashtu lidhur me Nenin 117.1 a dhe d të Ligjit për Prokurimin Publik;
 5. F.L., N.K. dhe E.L., me pranim të ryshfeteve, në shkelje të Nenit 343 paragrafi 1 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet; lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje) dhe gjithashtu lidhur me Nenin 117.1 a dhe d të Ligjit për Prokurimin Publik;
 6. F.Z., me dhënie të ryshfeteve, në shkelje të Nenit 344 paragrafi 1 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet;
 7. F.Z., me keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi. në shkelje të Nenit 236 paragrafi 1 nënparagrafi 5 dhe paragrafi 2 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga një deri në tetë vjet;
 8. F.L., F.L. dhe D.L., me pastrim të parave, në shkelje të Nenit 10 paragrafi 2 pika b të Rregullores 2004/02 të UNMIK-ut, e ndryshuar, Mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme, vepër e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet dhe gjobë deri në tre herë sa vlera e pasurisë që është objekt i veprës penale;

9. G.Z., me pengim të provave, në shkelje të nenit 309 paragrafi 2 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim deri në tre vjet, lidhur me Nenin 25 të KPK-së së vjetër (bashkëndihmë);
10. G.Z., me asgjësim apo fshehje të materialit arkivor, në shkelje të Nenit 324 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim deri në tre vjet;
11. F.L., me mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të Nenit 328 paragrafët 2 dhe 4 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me gjobë deri në 7.500 euro, ose me burgim nga një deri në tetë vjet;
12. F.L., me mosdeklarim të parave të pranuar për fushatë, në shkelje të Rregullores Nr. 2004/02 të UNMIK-ut, e ndryshuar, Mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme, Neni 10.8 dhe Neni 10.5, lidhur me Nenet 5.1 dhe 5.6, vepër e dënueshme me burgim deri në pesë vjet dhe gjobë deri në 100.000 euro;

pasi shqyrtoi Kundërshtimet ndaj Provave, të paraqitura nga Mbrojtësit e F.L., D.L., E.L., N.K., F.Z. dhe G.Z.,

pasi shqyrtoi Kërkesat për të Rrëzuar Aktakuzën, të paraqitura nga ana e Mbrojtësve të F.L., Fl.L., D.L., E.L., N.K., F.Z. dhe G.Z.;

duke marrë parasysh përgjigjet e paraqitura nga Akuza;

dhe pasi zhvilloi Shqyrtimin Fillestar më 8 dhe 10 prill 2013 dhe Shqyrtimin e Dytë më 17 maj 2013 dhe 10 qershor 2013

në bazë të Neneve 249, 250, 253 dhe 254 të Kodit të Procedurës Penale, Ligji Penal Nr. 04/L-123 ("KPP");

shpall këtë

AKTVENDIM

- I. Kundërshtimet ndaj Provave, të paraqitura nga Mbrojtësit e F.L. më 30 prill 2013, nga Mbrojtësi i Fl.L. më 18 prill 2013, nga Mbrojtësi i E.L. më 30 prill 2013 dhe nga Mbrojtësi i G.Z. më 26 prill 2013, janë pjesërisht të bazuara dhe provat e mëposhtme konsiderohen të papranueshme dhe do të përjashtohen nga shkresat e lëndës dhe do të vulosen:

- provat e siguruara gjatë kontrollit të shtëpisë së F.L. në C., i kryer më 28 prill 2010;
 - deklarata e të pandehurit Fl.L. e dhënë para Prokurorit Special më 4 shtator 2012;
 - deklaratat e këtyre dëshmitarëve: B.P., e dhënë më 8 nëntor 2011, R.E., e dhënë më 9 nëntor 2011, V.O., e dhënë më 3 prill 2012 dhe A.I., e dhënë më 11 nëntor 2011,
 - deklaratat (dhe transkriptet) e M.S. para Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit,
 - provat e siguruara gjatë kontrollit të kryer në dhomën e serverëve të Kuvendit të Kosovës më 28 prill 2010;
- II. Kundërshtimet ndaj Provave, të paraqitura nga Mbrojtësi i F.Z., nga Mbrojtësi i N.K. dhe nga Mbrojtësi i D.L., të gjitha të paraqitura më 30 prill 2013, hidhen poshtë si të pabazuara.
- III. Kundërshtimet e paraqitura nga Mbrojtësit e D.L. dhe F.Z., të paraqitura më 30 prill 2013, që pretendojnë papajtueshmërinë e Aktakuzës me Nenin 241 të Kodit të Procedurës Penale, hidhen poshtë si të papranueshme.
- IV. Kryetarja e trupit gjykues, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, provat e siguruara nga Qendra e Hetimit Financiar (raportet e datës 21 qershor 2011, 30 janar dhe 29 mars 2012) i shpall të papranueshme dhe ato do të përjashtohen nga shkresat e lëndës dhe do të vulosen.
- V. Kërkesa për të Rrëzuar Aktakuzën, e paraqitur nga Mbrojtësi i G.Z. më 26 prill 2013, pranohet dhe procedura penale kundër të Pandehurit për akuzat e pengimit të provave dhe asgjësimit ose fshehjes së materialeve arkivore (akuzat 9 dhe 10) pushohet.
- VI. Kërkesat për të Rrëzuar Aktakuzën, të paraqitura nga Mbrojtësit e F.L. më 30 prill 2013, nga Mbrojtësi i Fl.L. më 18 prill 2013, nga Mbrojtësi i F.Z. më 30 prill 2013, nga Mbrojtësi i E.L. më 30 prill 2013, dhe nga Mbrojtësi i D.L. më 30 prill 2013, pranohen pjesërisht. Akuzat e mëposhtme të Aktakuzës hidhen poshtë dhe procedura penale për akuzat përkatëse pushohet:
- krim i organizuar, kundër Fl.L. dhe D.L. (akuza 1),
 - përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, kundër F.L. dhe N.K. (akuza 2),
 - lidhje e kontratës së dëmshme, kundër F.L., N.K., E.L. dhe F.Z. (akuza 3),

- pastrim i parave, kundër F.L., Fl.L. dhe D.L. (akuza 7),
- pengim i provave dhe asgjësim apo fshehje e materialit arkivor, kundër G.Z. (akuzat 9 dhe 10) dhe procedura penale kundër tij për këto akuza pushohet,
- mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, kundër F.L. (akuza 11),

ARSYETIM

I. Ecuria procedurale

- 1) Më 16 nëntor 2012, Prokuroria Speciale Kosovës ("PSRK") ngriti Aktakuzën PPS nr. 425/09 në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës. Prokurori Special i dha Mbrojtjes një kopje elektronike të të gjithë lëndës dhe shkresat origjinale i dorëzoi në Gjykatë.
- 2) Më 3 dhjetor 2012, Gjyqtari i Konfirmimit të Aktakuzës i EULEX-it ia ktheu aktakuzën Prokurorit, në bazë të Nenit 306 (2) të Kodit të Përkohshëm Procedurës Penale të Kosovës ("KPPK") dhe i kërkoi Prokurorit të plotësonte Aktakuzën.
- 3) Më 7 dhjetor 2012, Prokurorit paraqiti një version të ndryshuar të Aktakuzës fillestare dhe e ankimoi pjesërisht Kërkesën e Gjyqtarit të Konfirmimit të Aktakuzës, që Kolegji i Apelit i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës e anuloi më pas me Aktvendim të datës 18 dhjetor 2012.
- 4) Më 28 dhjetor 2012, në Gazetën Zyrtare të Kosovës (nr. 37/28, dhjetor 2012) u botua Kodi i Procedurës Penale ("KPP"), Kodi Nr. 04/L-123,. Në bazë të Nenit 547 të KPP-së, kodi i ri procedural hyri në fuqi më 1 janar 2013.
- 5) Kryetarja e trupit gjykues zhvilloi Shqyrtimin Fillestar më 8 dhe 10 prill 2013 dhe Shqyrtimin e Dytë më 17 maj 2013 dhe 10 qershor 2013.
- 6) Gjatë Shqyrtimit Fillestar, Prokurori Special lexoi Aktakuzën. Të gjithë të pandehurit ishin plotësisht në dijeni të përmbajtjes së aktakuzës dhe u vetë-deklaruan jo fajtorë për të gjitha akuzat e Aktakuzës.
- 7) Në bazë të Nenit 245 të KPP-së, Kryetarja e trupit gjykues caktoi Shqyrtimin e Dytë. Gjithashtu Mbrojtësve iu kërkua të paraqesin kërkesa deri në një datë të caktuar.
- 8) Në përputhje me datën e caktuar nga Kryetarja e Trupit Gjykues, të gjithë Mbrojtësit paraqitën kërkesa për të rrëzuar Aktakuzën dhe disa prej tyre paraqitën edhe kundërshtime ndaj provave të propozuara nga Prokurori. Ata bënë gjithashtu të ditur provat që ata dëshironin të paraqitnin gjatë shqyrtimit gjyqësor.
- 9) Prokurorit të PSRK-së iu dorëzuan parashtrësat e Mbrojtjes dhe ai iu përgjigj atyre brenda periudhës së përcaktuara nga Ligji (Neni 251 (3) i KPP-së).

II. Ligji material dhe procedural i zbatueshëm

- 10) Meqenëse gjatë procedurës penale kundër të pandehurve, ligji material dhe procedural ishte objekt i ndryshimeve themelore, Kryetarja e Trupit Gjykesor e vlerëson të nevojshme që, para se të trajtojë meritat e lëndës, të përshkruajë ligjin e zbatueshëm si çështje paraprake.
- 11) Në bazë të Nenit 3 (1) të Kodit Penal, Ligji 04/L- 082 i vitit 2012 (që hyri në fuqi më 1 janar 2013), lidhur me kryerësin zbatohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Në rast të ndonjë ndryshimi në ligjin e zbatueshëm në një lëndë të caktuar para marrjes së vendimit përfundimtar, zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin, gjë që parashikohet në paragrafin 2 të dispozitës së cekur më lart.
- 12) Me Kodin e ri të Procedurës Penale ("KPP"), Ligji 04/L-123 i vitit 2012, në fuqi që më 1 janar 2013, ligji procedural ka ndryshuar thelbësisht. Në bazë të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të vitit 2004 (KPPK) të UNMIK-ut, procedura ishte më shumë e orientuar nga e drejta kontinentale, ndërsa kodi i ri përfshiu më shumë aspekte të procedurë kundërshtare. Për lëndën në fjalë, çështjet themelore lidhur me ligjin e zbatueshëm janë nëse procedura para Gjykatës (aktakuza dhe faza e vetë-deklarimit, shqyrtimit gjyqësor dhe faza e mjetit ligjor) do të rregullohen nga KPP apo nga KPPK. Po kështu, është vendimtare të përcaktohet se cilat dispozita duhet të zbatohen nga Gjykata për të vlerësuar pranueshmërinë e provave të siguruara gjatë hetimit të kryer në bazë të Kodit të mëparshëm. Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, është e nevojshme t'u referohemi dispozitave të përcaktuara në Kapitullin XXXVIII të KPP-së.
- 13) Në bazë të Nenit 540 të KPP-së, dispozitat e këtij Kodi zbatohen përshtatshëm për çdo procedurë penale të filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, në të cilën nuk është ngritur aktakuzë.
- 14) Neni 541 (1) i KPP-së parashikon sa më poshtë:
- Procedurat penale në të cilat është ngritur aktakuza por nuk është konfirmuar para hyrjes në fuqi të këtij kodi, nuk do të konfirmohen sipas dispozitave të Kodit që ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së aktakuzës, por do të procedohen sipas dispozitave të këtij kodi.*
- 15) Në lëndën në fjalë, Aktakuza u ngrit më 21 nëntor 2012, një kohë kur KPPK ishte ende i zbatueshëm. Aktakuza nuk u konfirmua deri sa hyri në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale. Për këtë

arsye, meqenëse janë përmbushur kërkesat ligjore të Nenit 541 (1) të KPP-së, lënda para Gjykatës procedohet bazuar në dispozitat e ligjit të ri.

16) Duke zbatuar KPP-në në këtë lëndë, seanca e konfirmimit nuk ishte e nevojshme, pasi kjo fazë procedurale u eliminua sipas Kodit të ri. Në vend të kësaj, u mbajtën Shqyrtimi Fillestar dhe Shqyrtimi i Dytë, në bazë të neneve 26 dhe 240 e në vijim të KPP-së.

17) Gjatë kësaj faze fillestare të procedurës para Gjykatës në bazë të Kodit të ri, Kryetarja e Trupit Gjykues ka për detyrë të vendosë lidhur me kundërshtimet e paraqitura nga Mbrojtja kundër provave të mbledhura nga Prokurori gjatë hetimit, dhe të vendosë lidhur me kërkesat e mundshme për të rrëzuar Aktakuzën.

18) Për të përcaktuar se cili ligj procedural duhet zbatuar për të vlerësuar pranueshmërinë e provave, Kryetarja e Trupit Gjykues i referohet Nenit 545 (1) të KPP-së, i cili parashikon, në pjesët përkatëse:

“Veprat të cilat janë kryer para hyrjes në fuqi të këtij Kodi i nënshtrohen këtij Kodi nëse procedura penale për hetimin apo ndjekjen e asaj vepre është filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi.”

19) Në bazë të kësaj dispozite kalimtare, veprat e kryera para hyrjes në fuqi të KPP-së duhet të jenë objekt i këtij Kodi vetëm nëse hetimi penal për hetimin dhe ndjekjen e këtyre veprave ka filluar pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi. Qartazi, në këtë rast nuk ndodh kështu, sepse hetimet u filluan në vitin 2009 dhe Aktakuza u ngrit në vitin 2012.

20) Për të mbështetur këtë arsyetim, vlen të citohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit në lëndën PN/KR 93/2013 ku, *obiter dictum*, u trajtua çështja se cili ligj procedural duhet zbatuar pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri. Gjykata shpalli se *“Ka situata kur do të nevojitet të merret parasysh KPPK, edhe kur është i zbatueshëm KPP i ri; për shembull, vlerësimi i provave të mbledhura në bazë të KPPK-së; Neni 540 përshtatshmërisht”*.¹

21) Duke marrë parasysh sa më lart, Kryetarja e Trupit Gjykues mban qëndrimin se procedura para Gjykatës në lëndën në fjalë duhet të zhvillohet në pajtim me dispozitat të KPP-së, ndërsa për të

¹ Gjykata e Apelit, PN/KR 93/2013, Aktvendim lidhur me Ankesën, 28.01.2013, f. 2.

vlerësuar pranueshmërinë e provave të mbledhura gjatë hetimeve, duhet zbatuar Kodi i vjetër². Duhet nënvizuar se gjatë hetimeve të zhvilluara në bazë të Kodit të mëparshëm, Prokurorit nuk mund të kishte paramenduar që ligji i ri të pësonte ndryshime thelbësore dhe nuk mund të kishte parashikuar që, për provat që do të mblidheshin, do të bëheshin të zbatueshme rregulla të ndryshme.

22) Të gjitha dispozitat e Kodit të Procedurës Penales të mëparshëm dhe të tanishëm duhen interpretuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila përcakton parimet e përgjithshme të procedurës penale, përfshirë të drejtën për shqyrtim të drejtë gjyqësor, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për privatësi, të cilat mund të bëhen të gjitha objekt ndërhyrjeje nga autoritetet publike në rrethana rreptësisht të përcaktuara. Kjo qasje mbështetet edhe nga Neni 249 (5) i KPP-së (i zbatueshëm për këtë fazë të procedurës), i cili parashikon se të gjitha provat ku nuk është paraqitur asnjë kundërshtim, do të jenë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse Gjykata përcakton sipas detyrës zyrtare se pranimi i provave do të shkelte të drejtat që i janë garantuar të pandehurit nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

23) Në pajtim me Nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara nga marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, janë garantuar me këtë akt, janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Për sa i takon procedurës penale, dokumentet e mëposhtme janë veçanërisht të rëndësishme: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, bashkë me jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare të bazuara në to.

III. **Kundërshtimet ndaj provave**

1. *Komente të përgjithshme*

24) Qëllimi i shqyrtimit fillestar dhe të dytë, të parashikuar nga KPP, është të eliminohen lëndët që vërtet nuk kanë meritë, dhe të mbrohen të pandehurit nga ekspozimi i pajustificuar dhe potencialisht i gjatë në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata nuk ka më të drejtë të vlerësojë plotësisht Aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave duke vepruar sipas detyrës zyrtare. Kundërshtimet kundër provave dhe/ose kërkesave për të rrëzuar aktakuzën duhet të paraqiten nga Mbrojtja në

² Shih gjithashtu *Gjykata Themelore e Mitrovicës, Aktvendim për Aktakuzën dhe Aktvendim për Vazhdimin e Paraburgimit, f. 14/13, 12.04.13*

bazë të neneve 249 dhe 250 të KPP-së. Prokurori ka mundësinë t'u përgjigjet këtyre kundërshtimeve dhe/ose kërkesave, siç parashikohet në Nenin 251. Argumentet e ngritura nga të dyja palët shqyrtohen nga Kryetarja e Trupit Gjykses, me qëllim që të bëjë vlerësimet përkatëse.

25) Në bazë të Nenit 249 (1) të KPP-së, të pandehurit mund të paraqesin kundërshtime ndaj provave të renditura në Aktakuzë, bazuar në këto arsye:

- provat nuk u siguruan në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit, ose subjektet e tjera shtetërore;
- provat shkelin rregullat në Kapitullin XVI të këtij Kodi;
- ka një arsye të artikulueshme që Gjykata t'i gjejë provat thelbësisht të pambështetshme.

26) Në bazë të Nenit 249 (5) të KPP-së, e vetmja kompetencë e mbetur sipas detyrës zyrtare e Gjykatës në bazë të KPP-së është të përcaktojë nëse pranimi i provave do të shkelte të drejtat që i janë garantuar të pandehurit nga Kushtetuta e Kosovës (gjithashtu Neni 97 (4) i KPP-së).

27) Të dy Kodet e Procedurës Penale, i përkohshmi dhe ai i tashmi, vendosin përgjithësisht të njëjtin rregull në lidhje me pranueshmërinë e provave. Në pajtim me Nenin 257 (2) të KPP-së, provat e siguruar në shkelje të dispozitave të procedurës penale do të jenë të papranueshme kur Kodi i tanishëm ose dispozita të tjera ligjore e parashikojnë këtë shprehimisht. Ky rregull është zhvilluar në paragrafin 3 të këtij Neni, që shpall se Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme. Pikërisht të njëjtat dispozita u përfshinë në Nenin 153 të KPPK-së.

28) Duhet theksuar se në parashtratat e tyre Mbrojtësit zbatojnë shpesh dispozitat e ndërkëmbyeshme si të KPPK-së, ashtu dhe të KPP-së, pa bërë ndonjë specifikim, dhe parashtratat e tyre përqendrohen më tepër në qëllimin që dëshirojnë të arrijnë. Kjo zgjidhje mund të shpjerë në paqartësi. Për këtë arsye, për të vlerësuar kundërshtimet, Gjykata jo gjithmonë do t'u referohet neneve të përmendura nga Mbrojtja, por më tepër do të përqendrohet në parimin që pretendohet të jetë shkelur. Siç u cek më lart, zhvillimi i hetimeve dhe mbledhja e provave duhet të vlerësohen në bazë të pajtueshmërisë së tyre ligjin e zbatueshëm në kohën kur u zhvilluan këto hetime.

2. Parashtrësia e Mbrojtjes në lidhje me të drejtën për shqyrtim gjyqësor të drejtë dhe të drejtën për të këqyrur shkresat e lëndës

i. Parashtrësia e palëve

29) Mbrojtja e F.L. parashtron se pjesëmarrja e saj në veprimet hetimore iu mohua në mënyrë të paligjshme nga Akuza, e cila gjithashtu nuk u kishte deklaruar ose dhënë qasje në provat e siguruar gjatë hetimeve. Mbrojtja ngriti çështjen se Prokurori që zhvilloi hetimet kishte shkelur parimet e mëposhtme të procedurës penale: të drejtën për shqyrtim gjyqësor të drejtë, parimin e barazisë së palëve dhe të drejtën për qasje në veprimet hetimore dhe deklarimin e provave (Nenet 5 (1), 7 (1), 9, 131, 213, 244 (3) të KPP-së).

30) Akuza mbrohet me atë se ajo ka vepruar në pajtim me ligjin e zbatueshëm dhe Urdhrin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake të datës 2 nëntor 2012. Ajo parashtrë gjithashtu se shqetësimet e ngritura nga Mbrojtja duket se janë trajtuar tashmë në vitin 2010.

ii. Ligji i zbatueshëm

31) Neni 5 (1) i KPP-së përcakton të drejtën e personit të akuzuar me vepër penale për shqyrtim gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm brenda një kohe të arsyeshme. Gjykata është e detyruar ta zbatojë procedurën pa vonesë dhe të parandalojë çdo abuzim të të drejtave të pjesëmarrësve në procedurë (paragrafi 2). Të njëjtat dispozita ishin përfshirë edhe në KPPK (Neni 5).

32) Në nenet 7 të tyre, të dy Kodet parashikojnë që Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia, që kanë marrë pjesë në procedurë penale, duhet të vërtetojnë me vërtetësi dhe në mënyrë të plotë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm.

33) Kodet përcaktojnë gjithashtu parimin e barazisë së palëve (Neni 10 i KPPK-së, Neni 9 i KPP-së).

34) Neni 142 (1) i KPPK-së i siguron të pandehurit të drejtën për të pasur qasje në provat e mbledhura gjatë hetimeve, të lidhura drejtpërdrejt me to, të tilla si proces-verbalet e marrjes në pyetje të tij, materialet e siguruar nga ai ose që i përkasin atij, materialet lidhur me këto veprime hetimore të cilat janë pranuar ose duhej të ishin pranuar nga Mbrojtësi, ose ekspertizën.

35) Krahas të drejtave të gëzuara nga Mbrojtja sipas paragrafit 1 të Nenit 142, Mbrojtja duhet të lejohet nga prokurori publik të këqyrë, kopjojë ose fotoografojë çdo shkresë, libër, dokument, fotografi dhe objekt tjetër të prekshëm në posedim, ruajtje ose kontroll të prokurorit publik, që janë materiale për përgatitjen e Mbrojtjes, ose janë synuar për përdorin nga prokurori publik si prova për qëllime të seancës së konfirmimit të aktakuzës ose në shqyrtimin gjyqësor, sipas rastit, ose që janë marrë nga i pandehuri ose i përkasin të pandehurit. Prokurori publik mund të mos pranojë ta lejojë Mbrojtjen ta përdorë këtë të drejtë, në rast se ka gjasë të fortë se kjo këqyrje, ky kopjim ose fotografim mund të rrezikojë qëllimin e hetimeve ose jetën a shëndetin e njerëzve.

iii. Gjetjet e Gjykatës

36) Aspekt themelor i së drejtës për shqyrtim gjyqësor të drejtë është që procedura penale, përfshirë elementet që kanë të bëjnë me procedurën, duhet të jetë kundërshtar dhe se ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes duhet të ketë barazi të armëve. Në një lëndë penale, e drejta për shqyrtim gjyqësor kundërshtar do të thotë që si akuzës, ashtu dhe mbrojtjes duhet t'u jepet mundësia të kenë njohuri dhe të komentojnë lidhur me parashtresat e ushtruara dhe provat e paraqitura nga pala tjetër³. Kur vlerësohet nëse procedura ishte e drejtë në tërësinë e saj, rëndësi ka natyra e dëshmive dhe provave të pranuar dhe mënyra në të cilën janë marrë. Në një lëndë penale në veçanti, respektimi i të drejtave të mbrojtjes kërkon që në parim të gjitha provat duhet të paraqiten në praninë e të akuzuarit, në një seancë publike, ku ato mund të kundërshtohen me anë të procedurës kundërshtarë⁴. Kjo përfshin edhe mundësinë për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe për të komentuar lidhur me provat e tyre në argument⁵.

37) Në kuadrin e lëndëve penale, e drejta për shqyrtim gjyqësor kundërshtar do të thotë që autoritetet e akuzës duhet t'i bëjnë të ditur mbrojtjes të gjitha provat materiale në posedim të tyre, pro apo kundër të akuzuarit⁶.

38) Parimi i barazisë së armëve, në kuptimin e balancës së drejtë ndërmjet palëve, është tipar qendror i së drejtës për shqyrtim gjyqësor të drejtë, dhe është aspekt i qenësishëm i së drejtës për procedurë kundërshtarë. Në thelb ai kërkon që secilës pale duhet t'i jepet mundësi e

³ Brandstetter kundër Austrisë, Aktgjykim i GJEDNJ-së, 28 gusht 1991, Seritë A nr. 211,

⁴ Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, Aktgjykim i GJEDNJ-së, 6 dhjetor 1988, 10590/83

⁵ Bricmont kundër Belgjikës, Aktgjykim i KEDNJ-së, 07 korrik 1989, 10857/84

⁶ Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykim i GJEDNJ-së, 16 shkurt 2000, 28901/95

arsyeshme për të paraqitur mbrojtjen e saj – përfshirë provat e saj – në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh të theksuar kundrejt kundërshtarit të saj. Me fjalë të tjera, parimi i barazisë së armëve në thelb do të thotë barazi procedurale ndërmjet palëve⁷. Gjithashtu, parimi i barazisë së armëve përgjithësisht do të thotë që palës kundërshtare nuk duhet t'i jepen mundësi shtesë për të realizuar objektivin e saj, në thelb, për të akuzuarin, ose palën ndërgjygjëse.

39) Megjithatë, një pabarazi e vogël që nuk cenon drejtësinë e procedurës në tërësi, nuk e shkel parimin e shqyrtimit gjyqësor të drejtë, të përcaktuar në Nenin 6 (1) të *Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*. Ky parim nuk përmban një përkufizim shterues të rregullave procedurale. Pikërisht ajo që kërkohet, do të varet deri-diku nga natyra e lëndës, përfshirë natyrën dhe rëndësinë e asaj që është në shqyrtim ndërmjet palëve. Duhet të ketë garanci procedurale të mjaftueshme të cilat i përshtaten natyrës së lëndës. Këto përfshijnë, sipas rastit, mundësinë e plotë për të paraqitur prova, për të kundërshtuar provat kundër, dhe për të paraqitur argumente lidhur me çështjet në shqyrtim.⁸

40) Analiza e ecurisë së procedurës hetimore tregon se Prokurori nuk ishte i prirë t'u mundësonte Mbrojtësve qasje në shkresat e lëndës. Për këtë arsye, më 15 tetor 2010 ata iu drejtuan Gjyqtarit të Procedurës Paraprake me një kërkesë të rregullt. Në përgjigje të saj më 2 nëntor 2010, Gjykata mori Aktvendim në të cilin Prokurori u urdhërua ta lejonte Mbrojtjen vetëm të këqyrte sendet e përcaktuara në Nenin 142 (1) të KPPK-së (proces-verbalet e marrjes në pyetje të të pandehurit, materialet e siguruara nga i pandehuri ose që i përkisnin të pandehurit, materialet lidhur me ato veprime hetimore në të cilat Mbrojtësit ishin pranuar ose duhej të ishin pranuar, ose ekspertizat). Gjyqtari i procedurës paraprake nuk e pranoi qasjen e Mbrojtjes në materiale të tjera (shkresa të veçanta, libra, dokumente, fotografi dhe sende të tjera materiale në posedim, ruajtje ose kontroll të Prokurorit), për shkak të gjasës së fortë se kjo mund të rrezikonte qëllimin e hetimeve.

41) Për shkak të vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, Mbrojtja e F.L. pati qasje në dokumentet e përmendura më lart.

⁷ Neumeister kundër Austrisë, Aktgjykim i GJEDNJ-së, 27 qershor 1968, 1936/63

⁸ H. kundër Belgjikës, Aktgjykim i GJEDNJ-së, 30 nëntor 1987, 8950/80

42) Duhet theksuar se ky kufizim që vendoset mbi të drejtën për qasje në shkresat e lëndës në fazën hetimore, është plotësisht në pajtim me parimet e mishëruara në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërmjet të drejtave të të pandehurit, nga njëra anë, dhe nevojës për të mos penguar a rrezikuar hetimet e ndërlikuara, duhet të ketë balancë të drejtë.

43) E drejta e të pandehurit për të pasur qasje në provat e mbledhura nga Prokurori përgjithësisht mund të kufizohet vetëm gjatë fazës së hetimeve. Siç është parashikuar në Nenin 142 (3) të KPPK-së, me përfundimin e hetimeve, Mbrojtja gëzon të drejtën të këqyrë, kopjojë ose fotografojë të gjitha shkresat dhe provat fizike në zotërim të gjykatës. Gjithashtu, Neni 307 (1) i KPPK-së kërkon që Prokurori t'i dorëzojë Mbrojtësit ato materiale ose kopje të tyre, që janë në posedim, kontroll ose ruajtje të tij, në rast se këto materiale nuk i janë dhënë tashmë Mbrojtësit gjatë hetimeve:

- proces-verbale të deklaratave ose dëshmime, të nënshkruara ose të panënshkruara, nga të pandehurit;
- emrat e dëshmitarëve të cilët Prokurorit synon t'i thërrasë për të dëshmuar, dhe çdo deklaratë të mëparshme të bërë nga këta dëshmitarë;
- informacion që identifikon ndonjërin nga personat të cilët Prokurori e di se ka prova ose informacion të pranueshëm dhe shfajësues për lëndën, dhe çdo proces-verbal të deklaratave, të nënshkruara ose të panënshkruara, nga këta persona për lëndën;
- rezultatet e ekzaminimeve fizike ose mendore, testet ose eksperimentet shkencore të bëra në lidhje me lëndën;
- kallëzimet penale dhe raportet policore; dhe
- një përmbledhje të provave materiale, ose referenca në këto prova të siguruar në hetime.

44) Në parashtrësat e saj, Mbrojtja ngriti gjithashtu çështjen se Prokurorit nuk respektoi Nenin 77 (3) të KPPK-së, çka përbënte shkelje të së drejtës së të pandehurit për shqyrtim gjyqësor të drejtë. Kjo dispozitë përcakton që mbrojtësi ka të drejtën të njoftohet paraprakisht për vendin dhe kohën e ndërmarrjes së çdo veprimi hetimor dhe të marrë pjesë në të dhe të këqyrë shkresat dhe provat e lëndës, në pajtim me dispozitat e këtij Kodi. Ky rregull është përsëritur në Kodin e ri (Neni 61 (3) të KPP-së).

- 45) Për mendimin e Gjykatës, ky kundërshtim është i pabazuar, pasi është e qartë se dispozitat e cituara më lart i japin Mbrojtësit vetëm të drejtën për t'u njoftuar paraprakisht për vendin dhe kohën e ndërmarrjes së çdo veprimi hetimor dhe për të marrë pjesë në të dhe të këqyrë shkresat dhe provat e lëndës. Siç kërkohet në Nenin 77 (3) të KPPK-së, kjo e drejtë duhet të zbatohet në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.
- 46) Në bazë të KPPK-së, nuk ka prezumim të përgjithshëm se i pandehuri dhe/ose Mbrojtësit e tij kishin të drejtën të merrnin pjesë në të gjitha veprimet e ndërmarra nga Prokurori gjatë fazës hetimore të procedurës. Kodi përcakton me përpikëri situatat konkrete në të cilat prania e mbrojtësit është e detyrueshme. Këto janë si vijon: të gjitha marrjet në pyetje të të arrestuarit nga policia (Nenit 218), mundësia hetimore e jashtëzakonshme (Nenit 238) dhe seanca e paraburgimit (Nenit 282).
- 47) Mbrojtja gjithashtu ngriti argumentin se Prokurori nuk i lejoi të merrnin pjesë në marrjet në pyetje të dëshmitarëve gjatë hetimeve dhe, kështu, argumentoi se kjo duhet ta bindë Gjykatën të arrijë në përfundimin se këto prova janë të papranueshme. Për ta mbështetur këtë pikëpamje, Mbrojtja iu referua Nenit 131 (2), këtë herë të Kodit të tanishëm, që përcakton:
- Prokurori i shtetit mund ta lejojë mbrojtësin, viktimën ose përfaqësuesin e viktimës të marrë pjesë në marrjen në pyetje në procedurën paraprake.*
- 48) Në parim, një zgjidhje e ngjashme parashikohej edhe në Kodin e mëparshëm. Neni 237 (4) i KPPK-së përcakton se prokurori publik (gjatë hetimeve) mund të vendosë ta ftojë të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe palën e dëmtuar për të qenë prezent gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit ose ekspertit.
- 49) Interpretimi i të dy neneve, të Kodit të ri dhe atij të vjetër, nuk ngre asnjë dyshim. I lihet Prokurorit të vendosë sipas gjykimit të tij nëse ai dëshiron ta ftojë mbrojtësin për të marrë pjesë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve gjatë hetimeve. Atij i lejohet ta bëjë këtë, por nuk është i detyruar.
- 50) Gjykata e sheh të nevojshme të theksojë përsëri se Prokurori nuk i shkeli dispozitat e Kodit kur përdori gjykimin e tij për ta ndaluar Mbrojtjen të marrë pjesë në veprimet hetimore. Asnjëra prej situatave të parashikuara në nenet 218, 238 dhe 282 të KPPK-së nuk ishte e pranishme në këtë rast, që do ta bënte të detyrueshme praninë e Mbrojtjes në këto veprime hetimore dhe,

kësisoj, provat e mbledhura gjatë këtyre veprimeve hetimore nuk konsiderohen të papranueshme.

51) Dispozitat e përmendura më lart janë elemente të parimit të barazisë së palëve në procedurën penale, të përcaktuar në Nenin 10 të KPPK-së (dhe Nenin 9 të KPP-së). Duhet theksuar se në të dy Kodet garantohet parimi i barazisë së palëve, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe. Kjo është qasje e arsyeshme, që i garanton Prokurorit mundësinë të kryejë hetime të efektshme, në interes të publikut që ai përfaqëson. Pjesëmarrja e mbrojtjes në fazën hetimore të procedurës duhet të kufizohet, përndryshe Prokurori nuk do të ishte në gjendje të verifikonte me efektivitet nëse ka dyshime të bazuara se i pandehuri e ka kryer krimin.

52) Duke marrë parasysh se qasja e të pandehurit në veprimet hetimore të kryera nga Prokurori është e kufizuar, e drejta për shqyrtim gjyqësor të drejtë duhet të garantohet plotësisht në ndonjë fazë para Gjykatës. Të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre do t'u jepet mundësia të kundërshtojnë provat gjatë shqyrtimit gjyqësor, çka është një prej komponentëve vendimtarë të drejtave për mbrojtje.

3. Pranueshmëria e marrjeve në pyetje dhe intervistave të të pandehurve dhe dëshmitarëve, të kryera nga Zyrtari Ligjor i PSRK-së.

i. Parashtrësia e palëve

53) Mbrojtja e F.L. dhe FI.L. parashtron se marrja në pyetje e të pandehurve, si dhe intervistat e disa prej dëshmitarëve, janë të papranueshme në bazë të Nenit 156 (1) të KPPK-së, sepse këto veprime hetimore nuk u kryen nga Prokurori siç kërkohet nga nenet 231 (1), 237 (1) të KPPK-së. Është parashtruar se Zyrtari Ligjor i PSRK-së, B.K., luajti rol aktiv të paligjshëm duke u bërë pyetje të pandehurve dhe dëshmitarëve, gjë që ai nuk lejohej ta bënte sipas Kodit procedural të zbatueshëm.

54) Prokurori parashtron se të gjitha marrjet në pyetje dhe intervistat u ndërmorën në pajtim të plotë me ligjin në Kosovë. Në përgjigje të parashtrësës së Mbrojtësit të FI.L., Prokurori nënvizoi se ai "i kërkoi Zyrtarit Ligjor Ndërkombëtar të tij t'u jepte shpjegime të pandehurve në prani të

Prokurorit, i cili qëndroi në sallë dhe mbajti kontroll të plotë të tërë situatës ndërkohë që jepej shpjegimi”. Prokurori theksoi se të pandehurit vendosën të qëndrojnë në heshtje.

55) Për ta mbështetur pikëpamjen e tij se një Zyrtar Ligjor Ndërkombëtar mund të jetë aktiv në marrjen në pyetje në procedurën paraprake, Prokurori i PSRK-së iu referua aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Komunale të Prishtinës në Lëndën PPS 10/11, duke cituar paragrafët përkatës të arsytimi. Kur vendosi lidhur me pranueshmërinë e dëshmisë së njërit prej të pandehurve, Gjykata shpalli se:

Z. (...) argumentoi se, për shkak se disa pyetje ishin bërë nga (...), Zyrtari Ligjor i PSRK-së, marrja në pyetje e të dyshuarit ishte kryer në shkelje të Nenit 231 të KPPK-së. Gjykata nuk pajtohet me këtë. Neni 231 parashikon se “marrja në pyetje e të pandehurit kryhet nga prokurori publik”. Marrja në pyetje e Z. (...), e zhvilluar më prill 4, u krye nga Prokurorja Speciale (...), ajo ishte qartazi përgjegjëse për mënyrën dhe drejtimin e marrjes në pyetje dhe vetëm sa u ndihmua, në disa raste, nga Zyrtari Ligjor.

ii. Ligji i zbatueshëm

56) Një prej elementeve të sundimit të ligjit është parimi se të gjitha autoritetet publike lejohen të veprojnë vetëm në bazë të ligjit dhe brenda kufijve të vendosur prej tij. Ky komponent i parimit të sundimit të ligjit është përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Nenin 3 (1), që përcakton se shteti është i rregulluar në mënyrë demokratike, në respekt të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të tij legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

57) Neni 109 i Kushtetutës përkufizon pozitën e prokurorit të shtetit. Paragrafi 1 përcakton se prokurori i shtetit është institucion i pavarur me autoritetin dhe përgjegjësinë për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerje të veprave penale dhe veprave të tjera të përcaktuara me ligj. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij Neni, prokurori i shtetit është institucion i paanshëm dhe vepron në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

58) Meqenëse Kushtetuta qartazi përmban vetëm rregullat e përgjithshme lidhur me të gjitha autoritetet shtetërore, përfshirë prokurorët, roli i prokurorit të shtetit duhet të vlerësohet më tej në bazë të Ligjit për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr. 03/L-225 i datës 30 shtator 2010), Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, (Ligji nr. 2008/03-L052) dhe Kodit të Procedurës Penale, që përcaktojnë kompetencat dhe pozitën e Prokurorit në procedurën penale.

59) Neni 1.1 i Ligjit për *Prokurorin e Shtetit* e përkufizon Prokurorin e Shtetit si institucion i pavarur me autoritetin dhe përgjegjësinë për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerje të veprave penale dhe veprave të tjera të përcaktuara me ligj.

60) Në bazë të Nenit 4.1 të Ligjit për *Prokurorit të Shtetit*, funksionet prokuroriale ushtrohen vetëm nga prokurorët e shtetit dhe prokurorët specialë kompetentë dhe të autorizuar me rregull, siç parashikohet nga *Ligji i posaçëm për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës*. Siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij Neni, prokurori i shtetit i emëruar me rregull është i autorizuar të nisë një hetim penal, të ngrejë aktakuzë ose propozim-akuzë, të kryejë ndjekje penale, ose të zbatojë detyra dhe funksione të tjera që janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme.

61) Neni 7 i Ligjit për *Prokurorin e Shtetit* specifikon detyrat dhe kompetencat e prokurorëve, që përfshijnë:

- ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit (1.1.);
- zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare (1.2.);
- sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe kodin e etikës profesionale (1.3.);
- ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit (1.4.);
- mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar (1.5.);
- ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penal (1.6.);
- marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale (1.7.);
- ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës (1.8.);

- ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore (1.9.);
- bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera (1.10.);
- ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj (1.11.).

62) Pozita e prokurorëve të EULEX-it është e rregulluar nga Ligji *për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës* (Ligji nr. 03/L-052). Neni 2 i tij përfshin përkufizimin e Prokurorit të EULEX-it – si prokuror që i përket EULEX KOSOVË e që është përzgjedhur dhe emëruar nga autoriteti kompetent për të punuar në Kosovë në këtë pozitë specifike.

63) Në bazë të Nenit 3.5 të Ligjit të cituar më lart, prokurorët specialë do të kenë kompetencë dhe përgjegjësi për të ushtruar funksionet e tyre, duke përfshirë edhe kompetencat dhe përgjegjësinë për të zhvilluar hetime dhe ndjekur penalisht krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PSRK-së, në të gjitha prokuroritë dhe në të gjitha gjykatat që veprojnë në Kosovë.

64) *Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës* është shumë i rreptë dhe i përpiktë për sa i përket mundësisë për t'ia deleguar ndonjë prokurori që punon në Kosovë ndërmarrjen e veprimtarive dhe veprimeve të veçanta të procedurës penale, ose ndërmarrjen e hetimeve ose ndjekjeve të veçanta të rasteve. Në pajtim me Nenin 3.8 të Ligjit, ky vendim kërkon autorizimin e Kryeprokurorit të PSRK-së. Gjithashtu, një prokuror i autorizuar nga Prokurori i PSRK-së është i detyruar t'i raportojë menjëherë Kryeprokurorit të PSRK-së pasi të jetë ndërmarrë veprimtaria ose veprimi, dhe t'i përcjellë Prokurorit Special në ngarkim të hetimeve ose ndjekjes të gjithë informacionin përkatës, dokumentet dhe shkresat e mbledhura nga veprimtaria ose veprimi i deleguar. Ai ka gjithashtu detyrën të informojë Prokurorin Special në ngarkim të hetimeve ose ndjekjes rreth zhvillimeve të rëndësishme lidhur me procedurën (Neni 3.11).

65) Kodi i Procedurës Penale përsërit tezën e përgjithshme se të gjitha institucionet përgjegjëse për procedurën penale duhet të veprojnë në pajtim me ligjin. Ky parim rezulton nga Neni 1 (2) i Kodit të mëparshëm, i cili shpall sa më poshtë:

“Ky Kod cakton rregullat që garantojnë se asnjë person i pafajshëm nuk do të dënohet, ndërsa fajtorit t’i shqiptohet dënim ose sanksion tjetër penal sipas kushteve të parapara me

Kodin e Përkohshëm Penal dhe me ligjet tjera të Kosovës në bazë të të cilave janë paraparë veprat penale, sipas procedurës së zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.”

I njëjti parim është përfshirë në Nenin 1 (2) të KPP-së.

66) Në bazë të Nenit 51 (1) të KPPK-së, prokurori publik vetë ndërmerr të gjitha veprimet në procedurë penale, për të cilat është i autorizuar sipas ligjit ose nëpërmjet personave të autorizuar sipas Ligjit mbi Prokurorinë Publike për ta përfaqësuar atë në procedurë penale. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij Neni, prokurori publik i ndërmerr veprimet hetimore vetë ose nëpërmjet policisë gjyqësore.

67) Kompetenca për të marrë në pyetje të pandehurin përcaktohet në Nenin 231 (1) të KPPK-së, i cili shpall se:

“Të pandehurin e merr në pyetje prokurori publik. Prokurori publik marrjen në pyetje mund t’ia besojë policisë gjyqësore ose, në raste të jashtëzakonshme, policisë së rregullt.”

68) Lidhur me papranueshmërinë e deklaratave të të pandehurit, Nenit 156 i KPPK-së parashikon se deklaratat e dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e neneve 229 deri në 236 të këtij Kodi. Këto deklaratat mund të përdoren për të kundërshtuar dëshminë e të pandehurit në gjykatë (Neni 372 paragrafi 2 i këtij Kodi).

69) Deri-diku në konflikt me këtë, formulimi i Nenit 235 të KPPK-së parashikon sa më poshtë:

“Nëse marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar me shkelje të dispozitave nga neni 155, paragrafi 1, neni 231, paragrafët 2 dhe 3 ose neni 234 paragrafi 2 i këtij Kodi, deklaratimet e të pandehurit janë të papranueshme.”

70) Kështu, ndërsa Neni 156 (1) i KPPK-së përmban gjithashtu kërkesat e vendosura në Nenin 231 (1) të KPPK-së, Neni 235 nuk e bën këtë. Kryetarja e Trupit Gjyqësor gjen se e vetmja mënyrë e arsyeshme është të lexohet Neni 235 i KPPK-së si një dispozitë që i shërben vetëm qëllimit të qartësisimit të katër situatave të përmendura. Meqë të gjitha këto situata janë trajtuar edhe nga Neni 156 (1) i KPPK-së, Neni 235 nuk ka ndonjë kuptim të veçantë thelbësor.

71) Papranueshmëria e deklaratave të dëshmitarëve rregullohet nga Neni 161 i KPPK-së, i cili nuk përmban paragraf gjegjësisht me Nenin 156 (1) të KPPK-së. Megjithatë, do të zbatohen rregullat për kompetencën, të përcaktuara në ligjet që rregullojnë pozitën e prokurorëve. Siç u përmend më lart, vetëm prokurori i autorizuar me rregull ka kompetencë të ndërmarrë veprime hetimore. Për më tepër, në pajtim me Nenin 249 (1.1) të KPP-së, Mbrojtja mund të ngrejë kundërshtimin se provat nuk u siguruan në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit, ose subjektet e tjera shtetërore.

72) Kodi nuk e specifikon kuptimin e nocionit “në mënyrë të ligjshme”, megjithatë është e qartë se ai do të interpretohet si “në pajtim me ligjin”, ose “bazuar në ligj”. Më e rëndësishme është se në Kod nuk ka dispozitë që të përcaktojë pasojat e një situatë ku provat janë siguruar “në mënyrë të paligjshme”. Kodi qartazi shpall se provat janë të papranueshme vetëm në bazë të dispozitave të parashikuara në Kod. Sidoqoftë, Gjykata është e mendimit se mungesa e dispozitave të përpikta nuk e lejon Gjykatën që provat e siguruar në mënyrë të paligjshme t’i trajtojë të pranueshme. Në radhë të parë, nga leximi i Nenit 249 në tërësi, mund të supozohet ose nënkuptohet se provat, për shkak se u gjet se ishin siguruar “në mënyrë të ligjshme” sipas Nenit 249 (1.1), do të konsiderohen të papranueshme. Neni 249 (3) dhe (4) – që buron nga Neni 249 (1) – parashikon se Gjyqtari mund t’i “lejojë ose përjashtojë provat” dhe se “provat e papranueshme do të veçohen nga shkresat e lëndës dhe do të vulosen” dhe “nuk do të shqyrtohen ose përdoren në procedurë penale.” Së dyti, trajtimi i provave të pranueshme si të siguruar në mënyrë të paligjshme nuk do të ishte i palogjikshëm, por, më e rëndësishmja, do të përbënte shkelje të parimeve kushtetuese të së drejtës për shqyrtim gjyqësor të drejtë, dhe do të binte ndesh me sundimin e ligjit.

iii. Gjetjet e Gjykatës

73) Të gjitha dispozitat e cituara më lart vërtetojnë se pozita e prokurorit është individuale dhe ai lejohet t’ia delegojë kompetencat e tij prokurorëve të tjerë, policisë, ose policisë gjyqësore vetëm kur kjo gjë është parashikuar rreptësisht me ligj. Ligji i zbatueshëm nuk parashikon mundësinë për t’ia besuar veprimet hetimore zyrtarëve ligjorë, roli dhe pozita profesionale e të cilëve nuk është rregulluar ligj, por përgjithësisht mund të përshkruhet për sa i përket mbështetjes për një gjyqtar a prokuror “të krahasueshëm me një vrojtues ose këshilltar”⁹.

⁹ Gjykata Supreme, Ap.-Kz. Nr. 527/2012 (“Kleçka”), Aktvendim, 11 dhjetor 2012, paragrafi 28

Asnjëra prej dispozitave të ligjeve të cekura nuk parashikon ndonjë kompetencë për zyrtarët ligjorë në procedura penale.

- 74) Gjykata ndan të njëjtin mendim me Gjykatën Komunale në Lëndën KA 44/12, të cituar nga Prokurori në përgjigjen e tij ndaj parashtresave të Mbrojtjes së F.L. dhe FI.L., se pjesëmarrja e zyrtarit ligjor në marrjen në pyetje të të pandehurve dhe dëshmitarëve në parim nuk përbën shkelje të Nenit 231 të KPPK-së, por vetëm në rast se kjo është kryer nga Prokurori i cili është qartazi përgjegjës për mënyrën dhe drejtimin e marrjes në pyetje.
- 75) Nisur nga objektivi dhe qëllimi i Nenit 231 (1) të KPPK-së, që është të shmanget marrja në pyetje e të pandehurit nga persona të pa autorizuar, është e qartë se termi “kryen” duhet kuptuar se Prokurori duhet të ketë kontroll në drejtimin e marrjes në pyetje. Kështu që pjesëmarrja aktive e një zyrtari ligjor ose këshilltari ligjor në marrjen në pyetje të një të pandehuri nuk përbën shqetësim për sa kohë që marrja në pyetje qartazi udhëhiqet nga prokurori kompetent. Kjo kërkon jo vetëm praninë e përhershme të Prokurorit gjatë marrjes në pyetje, por edhe ushtrimin e autoritetit të përgjithshëm të tij në bërjen e pyetjeve dhe drejtimin e aspekteve themelore të marrjes në pyetje.
- 76) Përgjithësisht, Prokurori i autorizuar në këtë lëndë kreu pjesën më të madhe të marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të pandehurve në fazën e procedurës paraprake. Ai ishte prezent gjatë këtyre veprimeve hetimore, dhe marrjet në pyetje u kryen nën kontrollin e tij, megjithëse jo gjithnjë ai i bëri pyetjet vetë, por, në vend të kësaj, përdori Zyrtarin Ligjor të tij. Kjo vlen për marrjet në pyetje të të pandehurit F.L. dhe dëshmitarëve B.R. dhe V.K., të cilat u bënë objekt i kundërshtimit nga Mbrojtja e F.L..
- 77) Megjithatë, në lëndën në shqyrtim pati gjithashtu marrje në pyetje ku roli i Zyrtarit Ligjor shkoi shumë përtej standardit të paraqitur më lart, sepse ai ishte plotësisht i pavarur dhe veproi në mungesë jo vetëm të kontrollit gjatë tre marrjeve në pyetje, por pa praninë e vetë Prokurorit.
- 78) Gjatë Seancës Dëgjimore të të pandehurit FI.L. që u zhvillua më 4 shtator 2012, Prokurori i PSRK-së, Johannes Pickert, dhe Zyrtari Ligjor i tij, B.K., ishin prezent. Pasi e filloi zyrtarisht Seancën, Prokurori i kërkoi Zyrtarit Ligjor t'i paraqesë akuzat FI.L.. Mbrojtësit e kundërshtuan këtë mënyrë të vepruar duke thënë:

“Unë nuk jam këtu për të mësuar ndokënd, aq më pak ju, por jam këtu për të respektuar dispozitat ligjore dhe Nenin 239 (duhet të jetë 231) që ju cekët, ku në dispozitën e parë shpallet se i pandehuri merret në pyetje nga prokurori publik, ndaj në këtë rast unë njoh vetëm prokurorin publik dhe askënd tjetër. Për çdo veprim ose ndërhyrje tjetër nga një person tjetër, unë e konsideroj proces-verbalin si të paligjshëm. Gjykata nuk njuh që zyrtari ligjor ka të drejtën të marrë në pyetje. Le të mos i hyjmë debatit të mëtutjeshëm, ju mund të autorizoni policinë ta marrë atë në pyetje, ndërsa KPPK nuk njuh të drejtën që ju t’ia jepni autorizimin ndihmësit ligjor për t’u përfshirë në marrjen në pyetje të klientit tim, sepse kjo është e paligjshme dhe nuk njihet nga ligji dhe ne vetëm kërkojmë të respektohet ligji dhe asgjë më shumë¹⁰.”

79) Prokurori vetë nuk reagoi ndaj kësaj deklaratë, por Zyrtari Ligjor i tij, B.K., u përgjigj:

“Ju faleminderit për deklaratën, për proces-verbalin po prezantohem. Unë jam B.K. dhe jam zyrtar ligjor ndërkombëtar, që kam dhënë të dy provimet shtetërore të Gjermanisë në drejtësi, çka më kualifikon mua sipas ligjit gjerman të shërbej si prokuror, avokat dhe gjyqtar gjerman. Gjithashtu kam doktoruar në të drejtë penale ndërkombëtare dhe kam titullin master në drejtësi në lëmin e së drejtës tregtare. Prandaj, lidhur me deklaratën tuaj, mendoj se jam i kualifikuar të bëj pyetje gjatë dëgjimit të të dyshuarit¹¹.”

80) Për mendimin e Gjykatës, duke u vetë-prezantuar në këtë mënyrë, B.K. qartazi pranoi se ai luajti rol të pavarur në marrjen në pyetje të të pandehurit. Ai e nxori këtë kompetence për të marrë në pyetje Fl.L. jo nga ligji, por nga kualifikimet dhe ekspertiza e tij, të siguruara gjatë arsimimit të tij.

81) Analiza e proces-verbaleve të marrjes në pyetje të disa prej dëshmitarëve gjithashtu të shpie në përfundimin se Zyrtari Ligjor luajti rol të paligjshëm proaktiv në to, veçanërisht sepse ato u kryen pa praninë e Prokurorit. Pozicioni i pavarur i ndërmarrë nga Zyrtari Ligjor është i dukshëm në këto veprime hetimore:

- marrjen në pyetje të B.P., mbajtur më 8 nëntor 2011¹², të R.E., mbajtur më 9 nëntor 2011¹³ dhe V.O., mbajtur më 3 prill 2012¹⁴. Seancat e të tre këtyre dëshmitarëve u zhvilluan nga

¹⁰ Dosja 20C, faqe 203

¹¹ Dosja 20C, faqet 203 - 204

¹² Dosja 19b, faqet 256 - 263

Zyrtari Ligjor dhe Hetuesi i Policisë së Kosovës, pa praninë e Prokurorit. Pjesa më e madhe e pyetjeve u bënë nga Zyrtari Ligjor. Dy marrjet e para në pyetje u filluan prej tij, çka gjithashtu provon se ai luajti rol të ndjeshëm aktiv në hetime.

- marrja në pyetje e A.I., mbajtur më 11 nëntor 2011¹⁵, u zhvillua plotësisht nga Zyrtari Ligjor, pa praninë e Prokurorit. Hetuesi i Policisë së Kosovës nuk bëri asnjë pyetje të vetme.

82) Analiza e zhvillimit të marrjes në pyetje në rastet e treguara më lart shpie në përfundimin se Zyrtari Ligjor luajti rol vendimtar në to. Nuk mund të thuhet se ai u bëri pyetje të pandehurit dhe dëshmitarëve vetëm në raste sporadike, por në të vërtetë ai i kreu marrjet në pyetje. Pasi mernte përgjigjen e pyetjes/pyetjeve, ai vijonte me të njëjtën çështje dhe i bënte pyetjen a pyetjet e tjera personit që po merrej në pyetje. Ndërmjet pyetjeve që iu bënë dëshmitarëve dhe përgjigjeve të tyre ekziston një lidhje e dukshme shkakësore. Zyrtari Ligjor nuk bëri vetëm pyetjet e përgatitura paraprakisht, por ai reagoi dhe vijoi në të njëjtën linjë ndaj informacionit të marrë, dhe i përshtati pyetjet sipas përgjigjeve të personave që po merreshin në pyetje. Mungesa e Prokurorit gjatë marrjeve në pyetje të renditura më lart, tregon se ai nuk e kontrolloi zhvillimin e këtyre veprimtarive hetimore. Fakti që hetuesit e policisë morën pjesë në to (ose ishin prezent) nuk i bënë të vlefshme këto veprime.

83) Praktika që zyrtari ligjor, roli i të cilit është i rëndësishëm, por vetëm mbështetës, të kryejë marrjen në pyetje të dëshmitarëve pa kontrollin *de facto* të prokurorit, është e papranueshme dhe e paligjshme, sepse bie ndesh me ligjin e zbatueshëm.

84) Pasi ka shqyrtuar ligjin dhe faktet e paraqitura më lart, Gjykata arrin në përfundimin se deklarata e të pandehurit F.L. është provë e papranueshme, sepse ajo nuk u mor në pajtim me dispozitat e neneve 229 deri në 236 të KPPK-së (Neni 156 i KPPK-së). Deklaratat e dëshmitarëve B.P., R.E., V.O. dhe A.I. janë gjithashtu të papranueshme, pasi u siguruan në mënyrë të paligjshme (Neni 249 (1.1) i KPP-së), sepse ato u drejtuan nga personi i paautorizuar me ligj për të kryer veprime hetimore, dhe pa kontrollin e Prokurorit përgjegjës për lëndën.

¹³ Dosja 19b, faqet 274 - 278

¹⁴ Dosja 19b, faqet 382 - 402

¹⁵ Dosja 19b, faqet 285 - 295

4. Pranueshmëria e provave të siguruara nga kontrolli dhe sekuestrimi i kryer në shtëpinë e F.L. në C. dhe në Kuvend më 28 prill 2010.

i. Sfondi faktik

- 85) Më 23 prill 2010, Prokurori kompetent paraqiti kërkesë me shkrim tek Gjyqtari i procedurës paraprake për urdhra-kontrolli ndaj mjediseve të F.L. dhe N.K.¹⁶. Lidhur me F.L., Prokurori kërkoi nxjerrjen e urdhër-kontrolleve për shtëpinë në Rrugën e Goloshit / Rexhep Luci, në B.M. (ndryshimi) dhe zyrat e MTPT-së. Urdhri me shkrim u lëshua nga Gjyqtari i procedurës paraprake më 28 prill 2010 në orën 10.00.¹⁷ Siç rezulton nga shkresat e lëndës, në të njëjtën ditë, rreth orës 12.00 të mesditës, Kryetari i Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) u informua se ndoshta ekzistonte edhe një objekt tjetër (C.) që duhej të kontrollohej, ngase mendohej se i përkiste F.L.¹⁸.
- 86) Më 28 prill 2010, bazuar në urdhër-kontrollin me shkrim të lëshuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake, u kryen kontrole në zyrat e MTPT-së dhe shtëpinë që i përket F.L. në Rrugën e Goloshit / Rexhep Luci. Krahas kësaj, policia gjyqësore kontrolloi, në prani të Prokurorit, shtëpinë e F.L. të ndodhur në C., megjithëse kjo pronë nuk ishte përfshirë në urdhër-kontrollin me shkrim. Të gjitha kontrollet u filluan rreth orës 15.00. Ambientet në B.M. u kontrolluan vetëm më 29 prill 2010¹⁹.
- 87) Policia siguroi leje verbale nga Gjyqtari kompetent i procedurës paraprake për të kontrolluar shtëpinë në C.. Është e pakontestueshme se raporti i kërkuar nga Neni 245 (6) i KPPK-së nuk u dërgua brenda dymbëdhjetë orëve pasi ishte kryer kontrolli. Raportin për kontrollin në C. Prokurori e mori vetëm më 5 maj 2010, dhe ky raport nuk iu dërgua asnjëherë gjyqtarit të procedurës paraprake, ndonëse ai ishte caktuar tashmë në këtë lëndë. Gjatë kontrollit nuk u mbajt proces-verbal për këtë veprim (çka kërkohet nga Neni 86 (1) i KPPK-së).
- 88) Sfondi faktik i kontrollit të kryer në ndërtesën e Kuvendit më 28 prill 2010 është përshkruar në Aktakuzë dhe në raportet policore të datave 28 prill dhe 11 maj 2010. Nga këto shkresa tregohet se hetuesit u informuan gjatë kryerjes së kontrollit se serverët e IT-së për Ministrinë ndodheshin

¹⁶ Dosja 3, faqet 1 - 7, 8 - 15

¹⁷ Dosja 3, faqet 27 - 30, 31 - 34

¹⁸ Dosja 7, faqet 82 - 83

¹⁹ Dosja 4a, faqet 74 - 78, 85 - 91

në ndërtesën e Kuvendit në dhomat 206 dhe 305. Prokurori në vendngjarje kontaktoi me telefon me Gjyqtarin kompetent të procedurës paraprake dhe siguroi leje verbale për t'i kontrolluar këta serverë. Bazuar në këtë leje verbale, hetuesit IT të NJHKO-së, bashkë me Prokurorin e PSRK-së, Joachim Stollberg, hynë në ndërtesën e Kuvendit në orën 18:30 dhe gjetën dhomat, të cilat ishin të dyja të kyçura. Është e pakontestueshme se as Sekretari Permanent i Ministrisë së Administratës Publike, as Kryetari i Kuvendit nuk u informuan për kontrollin dhe nuk u ftuan për të qenë të pranishëm.

- 89) Hetuesit identifikuan të pandehurin G.Z. si mbajtësi i çelësave të dhomave në fjalë dhe e udhëzuan atë në orën 19:40 të vinte në ndërtesën e Kuvendit për të hapur dyert. Në orën 20:15, i pandehuri G.Z. mbërriti në vendngjarje dhe kërkoi nga Prokurori të shihte urdhër-kontrollin me shkrim. Prokurori i shpjegoi G.Z. se gjyqtari i procedurës paraprake i kishte dhënë leje verbale për të kryer kontrollin. Me gjithë këtë, ai përsëri refuzoi t'i dorëzonte çelësat. Pasi Prokurori Stollberg i telefoni Gjyqtarit kompetent të procedurës paraprake dhe përsëri mori konfirmimin për të kryer kontrollin. Rreth orës 20:49 G.Z. pranoi të hapte derën e Dhomës 206. Hetuesit harxhuan një orë për të identifikuar se cilët serverë ishin prezent.
- 90) Kur u bë e qartë se asnjë prej serverëve në Dhomën 206 nuk ishin kontrolluesi i domeinit, G.Z. iu kërkua të hapte Dhomën 305. Meqenëse ai refuzoi përsëri, hetuesit e NJHKO-së, pasi ishin udhëzuar nga Prokurori i PSRK-së, i morën çelësat G.Z. dhe hynë në Dhomën 305. Me të hyrë në Dhomën 305, hetuesit gjetën serverin e shkresave për MTPT-në. G.Z. u udhëzua të kyçej në to me të drejtat e administratorit dhe menjëherë pas kësaj hetuesit kontrolluan qendrën e menaxhimit të kompjuterëve, për të identifikuar nëse kishte ndonjë seancë të mëparshme aktive. Hetuesit vunë re se serveri kishte pasur qasje nga distanca në katër raste të ndryshme dhe në desktop panë një ikonë për një program të quajtur Fshirësi i Sigurt, një produkt për fshirjen dhe heqjen e të dhënave në mënyrë të sigurt. Dosja e përbashkët e MTPT-së përfshinte vetëm katër skedarë të formatit *pdf*, që nuk kishin të bënin me kontrollin. Hetuesit arritën në përfundimin se dosja ose ishte kaluar në një lokacion tjetër, ose ishte fshirë. Serveri nuk u konfiskua për faktin se ai i shërben gjithë shtyllës kurrizore të IT-së së Qeverisë së Kosovës dhe do të kishte pasur ndikim e pasojë të rëndë në operacionet e Qeverisë së Kosovës.

Më 29 prill dhe 11 maj 2010, Hetuesit IT të Krimteknikës, T.W. dhe H.E., i paraqitën Prokurorit kompetent dhe Gjyqtarit të procedurës paraprake një "Raport Urgjencë dhe Urdhër Gjykatë me Gojë" dhe një "Raport të hollësishëm lidhur me dhomën e serverëve në Kuvendin e Kosovës më

28 prill 2010".²⁰ Asnjë miratim me shkrim për kontrollin e dhomave të serverëve të Kuvendit nuk u lëshua nga Gjyqtari i procedurës paraprake.

ii. Parashtrësia e palëve

- 91) Mbrojtësit e F.L., F.Z. dhe E.L. parashtruan se kontrolli në shtëpinë e F.L. në C. më 28 prill 2010 ishte në shkelje të Nenit 110 të KPP-së, prandaj provat e siguruar nga kontrolli janë të papranueshme, për shkak se u siguruan në mënyrë të paligjshme, siç parashikohet nga Neni 111 i KPP-së. Mbrojtja argumenton se, edhe sikur KPP të mos jetë i zbatueshëm për vlerësimin e pranueshmërisë së provave në këtë lëndë, Neni 246 (1) dhe Neni 245 (6) i KPPK-së gjithashtu i bënë të papranueshme provat e siguruar.
- 92) Mbrojtja pohon se kontrolli nuk mund të bazohet vetëm në një urdhër verbal gjykate, pa miratim gjyqësor me shkrim më pas. Është parashtruar se Neni 246 (1) i KPPK-së qartazi parashikon se kontrolli i zbatuar pa urdhër nga gjyqtari i procedurës paraprake është në shkelje të Kodit dhe Nenit 245 (6) i KPPK-së, ngase ai kërkon që kontrolli i kryer pa urdhër me shkrim t'i raportohet gjyqtarit të procedurës paraprake brenda 12 orëve.
- 93) Më tej, është parashtruar se Neni 36.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës kërkon miratim të mëposhëm të kontrollit nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjë që logjikisht nënkupton urdhër gjykate të nxjerrë më pas. Nga Mbrojtja është argumentuar se Akuzat nuk nxori ose nuk zbuloi asnjë provë në materialet që i bëri të ditur Mbrojtjes, që do të konfirmonte se raporti lidhur me kontrollin e kryer pa urdhër gjykate me shkrim në shtëpinë e F.L. në C. iu dërgua Gjyqtarit kompetent jo më vonë se 12 orë pasi ishte kryer ky kontroll. Është parashtruar se raporti i NJHKO-së, 12/20100428, i datës 5 maj 2010, nuk mund të shërbejë si raport bazuar në Nenin 245 (6) të KPPK-së, sepse kontrolli ndodhi më 28 prill 2010, ndërsa raporti u dorëzua gati një javë më vonë.
- 94) Akuzat parashtron se kundërshtimi i ngritur nga Mbrojtja është pa meritë. Për mendimin e Akuzës, është KPPK dhe jo KPP që është i zbatueshëm për të përcaktuar nëse është shkelur ligji kur ndodhi mbledhja e provave, mbi bazën se ky vlerësim duhet të bazohet në ligjin që ekzistonte në kohën kur ndodhi veprimi hetimor. Akuzat ka argumentuar se kontrolli në shtëpinë

²⁰ Dosja e Procedurës Paraprake të Gjykatës 1, tabela 3.

e F.L. u krye në pajtim me Nenin 245 (3) të KPPK-së, bazuar në urdhër-kontrollin gojor të gjyqtarit të procedurës paraprake të EULEX-it, Ferdinando Buatier de Mongeot.

95) Akuza pohon më tej se, nëse NJHKO ka vepruar në pajtim me Nenin 245 (6) të KPPK-së, kjo është e parëndësishme për çështjen e pranueshmërisë së provave, sepse Neni 246 (6) i KPPK-së nuk i referohet Nenit 245 (1) të KPPK-së. Më tej, urdhër-kontrolli gojor i gjyqtarit nuk nevojitet të "fuqizohet" me urdhër gjykate me shkrim më pas, pasi KPPK nuk e kërkonte këtë. Së fundi, Akuza parashtron se urdhri gojor i Gjyqtarit vetëm sa e zgjeroi vendimin me shkrim thjesht në një pronë tjetër të F.L.. Argumentet e Mbrojtjes duket se janë artificiale, sepse arsytimi në kërkesën e Prokurorit, si dhe në vendimin e Gjyqtarit më 28 prill 2010, vlen njësoj edhe për shtëpinë e F.L. në C..

96) Lidhur me kontrollin e kryer në ndërtesën e Kuvendit, Mbrojtja e G.Z. pretendon se ka pasur shkelje të Nenit 245 (3) dhe (4) të KPPK-së, sepse nuk ekzistonin rrethana urgjente dhe përjashtimore, që do ta kishin arsyetuar kontrollin bazuar vetëm në lejen verbale të gjyqtarit të procedurës paraprake, dhe në mungesë të dëshmitarëve. Është parashtruar se Akuza nuk demonstroi ekzistencën e ndonjë rreziku të madh për shkak të vonesës, që do të kishte rezultuar në humbje të provave. Mbrojtja argumenton se parashtrësja e Akuzës në paragrafin 121 të Aktakuzës është e keq-bazuar, sepse kryerja faktike e kontrollit tregon se një rrezik i tillë për shkak të vonesës nuk ekzistonte. Hetuesit jo vetëm pritën tridhjetë minuta në mënyrë të panevojshme që i pandehuri Zogaj të mbërrinte në vendngjarje, por ata gjithashtu e pranuan kërkesën e Zogajt për të pritur për lejen e eprorëve të të pandehurit për të dorëzuar çelësin e dhomës së serverit. Sikur çështja të kishte qenë tejet urgjente, hetuesit do të kishin përdorur menjëherë forcë fizike për të hyrë në dhomë. Krahas kësaj, është parashtruar se kontrolli u krye në shkelje të Nenit 243 (6) të KPPK-së, sepse as Sekretari Permanent i Ministrisë së Administratës Publike, as Kryetari i Kuvendit nuk u informuan për kontrollin dhe nuk u ftuan për të qenë prezent. Prandaj, Mbrojtja parashtron se provat e siguruara janë të papranueshme si në bazë të Nenit 111 të KPPK-së, ashtu dhe në bazë të Nenit 246 të KPPK-së.

97) Në përgjigjen voluminoze të saj të datës 7 maj 2013, Akuza argumenton se kontrolli në ndërtesën e Kuvendit u krye në mënyrë të ligjshme dhe asnjëra prej situatave të përshkruara në Nenin 246 të KPPK-së nuk ka ndodhur. Është parashtruar se gjatë kontrollit hetuesit jo vetëm vepruan krejtësisht në mënyrën e duhur dhe me shpejtësinë e nevojshme, por edhe urgjenca e situatës u vlerësua në mënyrë të rregullt nga Gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it dhe

mund të demonstrohet më tej me faktin se provat ishin fshirë ndërkohë që po kryhej kontrolli. Vonesa prej dy orësh deri në ekzekutimin e urdhër-kontrollit gojor ndodhi për faktin se hetuesit nuk e dinin se ku ndodhej serveri. Në këto rrethana, përdorimi i menjëhershëm i forcës fizike, si dhe shkëputja e të gjithë serverëve të gjithë qeverisë së Kosovës, do të kishin qenë të tepruara.

98) Lidhur me çështjen e mospranisë së kryetarit të entit publik gjatë kontrollit, Prokurori parashtron se prania e tij nuk ishte e detyrueshme, sepse ai nuk përmendet në Nenin 243 (1) ose (2) të KPPK-së. Për sa i takon çështjes nëse kontrolli mund të kryhet vetëm në bazë të urdhrit verbal të gjykatës, Akuza parashtron të njëjtat argumente që parashtron në lidhje me kontrollin në C..

iii. Ligji i zbatueshëm

99) Njëra prej të drejtave themelore kushtetuese është e drejta e pacenueshmërisë së rezidencës, që është e garantuar nga Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

Në pajtim me paragrafin 2 të të njëjtit Neni:

Kontrollet e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.

100) Gjykata vëren se në Nenin 16 të saj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon përparësinë e këtij akti mbi ligjet dhe aktet e tjera ligjore, që duhet të jenë në pajtim me të. Pozita e përparësisë së Kushtetutës në sistemin ligjor kërkon gjithashtu që të gjitha aktet ligjore të nivelit më të ulët duhet të interpretohen në pajtim me dispozitat e këtij akti dhe në dritën e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, siç është përvijuar tashmë më lart, Kushtetuta parashikon zbatueshmëri të drejtpërdrejtë të konventave ndërkombëtare që

mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut (Neni 22). E rëndësishme është se, në rast rënieje ndesh, ligjet ndërkombëtare kanë përparësi kundrejt dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

- 101) E drejta e respektit për jetën private dhe familjare është njëra prej të drejtave njerëzore më të rëndësishme të garantuara by *Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ)*, e rregulluar në Nenin 8 të saj, që shpall si vijon:

“1. Çdokush ka të drejtë që t’i respektohet jeta private e familjare, vendbanimi dhe korespondenca e tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

- 102) Shprehja “e parashikuar nga ligji”, brenda kuptimit të Nenit 8 § 2 të Konventës, kërkon së pari që masa e kundërshtuar duhet të ketë një farë baze në të drejtën kombëtare. Së dyti, e drejta kombëtare duhet të jetë e qasshme nga ana e personit të interesuar. Së treti, personi i prekur duhet të jetë në gjendje, nëse është nevoja duke i dhënë këshillën e duhur ligjore, të parashikojë pasojat e së drejtës kombëtare për të, dhe, së katërti, e drejta kombëtare duhet të jetë e pajtueshme me sundimin e ligjit.²¹

- 103) Tre elementet e para të pajtimit me ligjin janë mjaft të qarta dhe nuk ka dyshim se e drejta e Kosovës i përmbush këto kërkesa. Megjithatë vlen të shpjegohet kuptimi i dispozitës “të jetë e pajtueshme me sundimin e ligjit”. Në kuadrin e kontrollit dhe sekuestrimit, e drejta kombëtare duhet t’i ofrojë disa garanci individit kundër ndërhyrjes arbitrare në të drejtat e parashikuara në Nenin 8 të KEDNJ-së. Ky ligj duhet të jetë veçanërisht vigjilent në rastet kur, si në lëndën në fjalë, autoritetet kanë kompetencë, në bazë të së drejtës kombëtare, të urdhërojnë dhe kryejnë kontrolle pa urdhër gjykate. Në rast se kërkohet që individët të mbrohen nga ndërhyrja arbitrare

²¹ Rotaru kundër Rumanisë [GC], nr. 28341/95, § 52, GJEDNJ 2000 V; Liberty dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 58243/00, § 59, 1 korrik 2008; dhe Kennedy kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 26839/05, § 151., GJEDNJ 2010

nga ana e autoriteteve në të drejtat e garantuara nën Nenin 8 të KEDNJ-së, nevojiten korniza ligjore dhe kufizime shumë të rrepta mbi këto kompetenca²².

- 104) Nga Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është e qartë se metoda tejet e parapëlqyer e kryerjes së kontrollit të një rezidence private është për shkak të një urdhri gjykate. Shmangia nga ky rregull lejohet vetëm në një numër të kufizuar rrethanash të përkufizuara me ligj, në të cilat raste veprimet duhet të miratohen më pas nga gjykata.
- 105) Në linjë me rëndësinë parësore të ruajtjes së pacenueshmërisë së rezidencës dhe rëndësinë e përfshirjes dhe mbikëqyrjes gjyqësore të kontrolleve, KPPK ka përcaktuar një kornizë të hollësishme materiale procedurale për nxjerrjen e urdhrave gjyqësorë të kontrollit të një shtëpie. KPPK kërkon që urdhër-kontrolli të lëshohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake, kundrejt kërkesës me shkrim të Prokurorit (Neni 240 (3) i KPPK-së). Gjyqtari duhet të bindet se ekziston dyshim i bazuar se personi ka kryer veprë penale, dhe se ka gjasa të forta se kontrolli do të rezultojë në zbulimin dhe konfiskimin e provave të rëndësishme. Krahas kësaj, urdhri me shkrim duhet të përmbajë informacion të hollësishëm, të tillë si identifikimi i personit dhe veprës penale, shpjegimi i bazës për dyshim të bazuar dhe gjasave të forta, përshkrimi i objektivave që kërkohet të arrihen, dhe përshkrimi i veçantë i objekteve që do të kontrollohen.
- 106) KPPK përkufizon situata të caktuara kur kontrolli lejohet pa urdhër gjykate, përfshirë rrethanat urgjente, siç përkufizohet nga Neni 245 (4) i KPPK-së në vijim:

“Përfundimisht, kontrolli mund të zbatohet pa praninë e dëshmitarëve nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Arsyet për zbatimin e kontrollit pa praninë e dëshmitarëve shënohen në procesverbal.”

- 107) Në rast se kontroll kryhet pa urdhër gjykate me shkrim, Neni 245 (6) i KPPK-së i kërkon policisë t’i dërgojë raport lidhur me këtë prokurorit publik dhe gjyqtarit të procedurës paraprake, jo më vonë se dymbëdhjetë orë pas kontrollit. Është e pakontestueshme se në lëndën në fjalë Prokurorit ose Gjyqtarit të procedurës paraprake nuk iu dërgua asnjë raport i tillë. Prokurori e mori raportin vetëm më 5 maj 2010, domethënë, një javë më vonë pasi ishte kryer kontrolli.²³

²² Camenzind kundër Zvicrës, 16 dhjetor 1997, § 45, Raporte të Aktgjykimeve dhe Vendimeve, 1997-VIII

²³ Dosja 4 A, faqet 108 - 109

- 108) Gjykata pohon se Neni 245 (6) i KPPK-së duhet interpretuar në pajtim me Nenin 36 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi kushtetues lidhur me kontrollin e kryer gjatë procedurës penale shpie në përfundimin se, në rastet kur kontrolli është kryer pa urdhër me shkrim të lëshuar nga gjyqtari kompetent në bazë të Kodit të mëparshëm, edhe atëherë ai duhet të jetë miratuar më pas nga gjykata. Fakti që Neni 245 (6) i KPPK-së nuk kërkon miratim të mëparshëm të Gjykatës, nuk ka pasojë ligjore, sepse kjo dispozitë duhet interpretuar në një mënyrë që është në përputhje me Kushtetutën, si ligji më i lartë i Kosovës.
- 109) Analiza e ligjit të zbatueshëm për kontrollin shpie në përfundimin se, në bazë të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, miratimi i kontrollit të kryer pa urdhër gjykate me shkrim mund të ishte dhënë në mënyrë të nënkuptuar, *per fakta concludentia*. Vendimtare është që gjyqtari duhet të ketë mundësinë të verifikojë nëse kontrolli u krye në pajtim me ligjin, çka do të thotë se ai duhet të marrë një raport të kontrollit, bazuar në Nenin 245 (6) të KPPK-së. Në rast se ai nuk gjen ndonjë shkelje, nuk është e nevojshme sipas Kodit të mëparshëm të nxjerrë aktvendim. Ky interpretim është në pajtim me dispozitën e Nenit 36.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, kjo është e arsyeshme, sepse përndryshe detyrimi për të dërguar raport lidhur me kontrollin do të ishte artificial, pa ndonjë kuptim, në qoftë se, në rast të një shkeljeje të rëndë të ligjit, gjyqtari nuk do të lejohej të reagonte ndaj saj.
- 110) Gjykata thekson se masat e kontrollit dhe sekuestrimit përfaqësojnë ndërhyrje të rëndë në të drejtat e përcaktuara në Nenin 8 dhe, për rrjedhojë, duhen bazuar në një ligj që është i përpiktë. Është thelbësore që në këtë fushë të ketë rregulla të qarta, të hollësishme, rregulla që parashikojnë garanci kundër abuzimit ose arbitraritetit të mundshëm. Mungesa e një urdhri gjykate të mëparshëm mund të kundër-baraspeshohej me dhënien e një vlerësimi gjyqësor *ex post faktum*. E drejta e respektit për pronën private në rast të mungesës së një urdhri gjykate të mëparshëm kërkon mundësinë për të siguruar një vlerësim të efektshëm gjyqësor *a posteriori* qoftë të vendimit për të urdhëruar kontrollin, qoftë të mënyrës në të cilën është zbatuar ai.
- 111) Kodi i ri i Procedurës Penale është më i rreptë dhe i përpiktë në lidhje me detyrimet se si duhet kryer kontrolli pa urdhër me shkrim të gjyqtarit. Në bazë të Nenit 110 (6) të KPP-së, në këto raste policia është e detyruar t'i dërgojë raport lidhur me kontrollin Prokurorit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake, nëse ky i fundit është caktuar përgjegjës për lëndën, jo më vonë se dymbëdhjetë orë pas kontrollit, me qëllim që të sigurohet miratimi i mëparshëm i kontrollit, në

pajtim me dispozitat kushtetuese. Në rast se kontrolli nuk miratohet më pas nga Gjykata, provat e siguruara nga kontrolli janë të papranueshme (Nenit 111 (1.1) i KPP-së).

- 112) Procedura penale e zbatueshme gjithashtu kërkon praninë e dëshmitarëve gjatë kontrollit. Ky detyrim është përcaktuar shprehimisht në Nenin 243 (2) të KPPK-së:

“Gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve të tjera kërkohet të jenë të pranishëm dy persona të rritur si dëshmitarë. Para fillimit të kontrollit, dëshmitarët paralajmërohen që me kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe njoftohen mbi të drejtën e tyre për të bërë vërejtje, nëse kanë, për përmbajtjen e procesverbalit të kontrollit para se të nënshkruhet.”

- 113) Lidhur me kontrollin e kryer në ambientet e një enti publik, KPPK kërkon në Nenin 243 (6) që drejtuesi i entit publik të ftohet për të marrë pjesë në të.

- 114) Një përjashtim në detyrimin për praninë e dëshmitarëve është mishëruar në Nenin 245 (4) të KPPK-së, i cili parashikon:

“Përjashtimisht, kontrolli mund të zbatohet pa praninë e dëshmitarëve nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Arsyet për zbatimin e kontrollit pa praninë e dëshmitarëve shënohen në procesverbal.”

- 115) Papranueshmëria e provave e siguruara nga kontrolli është rregulluar shprehimisht nga Neni 246 i KPPK-së:

“Provata e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse:

- 1) Kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi;*
- 2) Urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake është lëshuar në kundërshtim me procedurën e paraparë me këtë Kod;*
- 3) Kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake;*
- 4) Personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit (neni 243, paragrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi) ose*

5) *Kontrolli është zbatuar në kundërshtim me nenin 245, paragrafët 1, 3, 4 dhe 5 të këtij Kodi.”*

iv. Gjetjet e Gjykatës

116) Provat e siguruara nga kontrolli i shtëpisë së F.L. në C., si dhe në ndërtesën e Kuvendit, Gjykata i gjen të papranueshme në bazë të Nenit 246 (2) dhe (6) të KPPK-së. Kontrollat e ambienteve u kryen në bazë të lejeve verbale të Gjyqtarit të procedurës paraprake, pa miratim të mëpasshëm, siç kërkohet nga Neni 246 (6) i KPPK-së dhe Neni 36 (2) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për më tepër, kontrollat u kryen në shkelje të Nenit 245 (3) të KPPK-së, sepse nuk ekzistonin rrethana urgjente të pranishme, që do ta lejonin Akuzën të fillonte dhe të kryente kontrollat pa urdhër gjykatë me shkrim. Krahas kësaj, kontrolli i dhomave të serverëve në ndërtesën e Kuvendit u krye në shkelje të Nenit 243 (2), lidhur me Nenin 245 (4) të KPPK-së, gjë që i bën të papranueshme provat e siguruara, në bazë të nenit 246 (5) dhe (6) të KPPK-së.

a. Provat e siguruara nga kontrolli në C. janë të papranueshme, sepse kontrolli u ekzekutua pa urdhër nga Gjyqtari i procedurës paraprake, në shkelje të dispozitave të KPPK-së (Neni 246 (1) të KPPK-së)

117) Siç është ravijëzuar tashmë, ligji procedural kërkon që gjyqtari i procedurës paraprake të nxjerrë urdhër-kontrolli me shkrim në lidhje me kërkesën me shkrim të Prokurorit. Një përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm është parashikuar në Nenin 245 të KPPK-së, i cili lejon kontroll pa urdhër gjykatë me shkrim, bazuar në lejen verbale të Gjyqtarit të procedurës paraprake. Në këtë rast të fundit, megjithatë, miratimi i mëpasshëm jo vetëm që kërkohet nga Neni 245 (6) i KPPK-së, por është edhe i detyrueshëm, për shkak të përcaktimit në Nenin 36 (2) të Kushtetutës së Kosovës.

118) Kërkesa për të nxjerrë urdhër-kontrolli me shkrim është veçanërisht e rëndësishme për të informuar personin e prekur në mënyrën e duhur për arsyet e kësaj mase hetimore dhe, kësaj, për t'i mundësuar atij të kërkojë rekurs të rregullt ligjor. Argumenti i paraqitur nga Akuza se kundërshtimi i Mbrojtjes është “artificial”, ngase i pandehuri u informua për arsyet për shkak të kontrolleve të ambienteve të tjera, që u bazuan në urdhrin me shkrim të gjykatës, është jo vetëm në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, por minon gjithashtu vetë thelbin e së drejtës për pacenueshmëri të vendbanimit të personit. Ligji kërkon të nxirret urdhër-kontrolli jo vetëm

kundër një personi konkret, por edhe lidhur me ambiente konkrete, që duhen përshkruar në mënyrë të duhur në urdhër-kontroll. Qëllimi i urdhër-kontrollit me shkrim është të mbrohet çdo person kundër ndërhyrjes së paarsyetuar, arbitrare dhe të paligjshme në shtëpinë e tij.

- 119) Për sa i takon kontrollit të kryer në C., raporti për këtë qëllim iu dërgua Gjyqtarit të procedurës paraprake vetëm pasi i ishte dorëzuar Prokurorit. Gjyqtari nuk pati mundësi të verifikonte nëse kontrolli ishte kryer në pajtim me ligjin dhe lejen verbale të tij. i pandehuri u privua nga kontrolli gjyqësor mbi kontrollin.
- 120) Situata e kontrollit të kryer bazuar në urdhër verbal gjykate, pa miratim të mëpasshëm të gjyqtarit (madje edhe *per fakta concludentia*) përbën shkelje që parashikohet nga Neni 246 (2) i KPPK-së. Arsyeja përse shkelja e kërkesave të përcaktuara në Nenin 245 (6) të KPPK-së nuk përmendet në Nenin 245 (6) të KPPK-së, siç thekson Akuza me të drejtë, nuk është sepse ligjvënësi nuk e gjeti këtë shkelje aq të rëndë, sa për t'i bërë provat të papranueshme, por thjesht sepse situata mbulohet tashmë nga Neni 246 (2) i KPPK-së.
- 121) Në pamje të parë mund të duket se Neni 246 (2) supozohet të mbulojë vetëm kërkesat procedurale materiale dhe jo kërkesat procedurale formale, siç është forma e shkruar. Megjithatë, për mendimin e Gjykatës, e vetmja kërkesë procedurale materiale lidhur me kontrollet e shtëpive, sipas KPPK-së, është që gjyqtari kompetent i procedurës paraprake duhet të nxjerrë urdhër. Në rast se Neni 264 (2) i KPPK-së do të kishte për qëllim të mbulonte vetëm këtë të fundit, dispozita do të ishte e tepërt, sepse rasti kur provat sigurohen me urdhër kontrolli jo të nxjerrë nga gjyqtari i procedurës paraprake është parashikuar tashmë nga Neni 246 (1) i KPPK-së. Për më tepër, situatat e përshkruara në Nenin 245 (1) ose (3) të KPPK-së janë parashikuar tashmë nga Neni 246 (1) dhe (6) i KPPK-së. Prandaj, është e arsyeshme të arrihet në përfundimin se Neni 246 (2) vërtet mbulon kërkesën procedurale të përcaktuar në Nenin 240 (4) të KPPK-së, që është forma e shkruar e urdhër-kontrollit, ose para kryerjes së kontrollit, ose me miratim të mëpasshëm.

b. Kontrollet në C. dhe në Kuvend u kryen në shkelje të Nenit 245 (3) të KPPK-së (Neni 246 (6) të KPPK-së)

- 122) Gjykata është e mendimit se nuk ekzistonin rrethana urgjente, që do ta kishin arsyetuar policinë gjyqësore të kryente kontrollin në C. dhe ndërtesën e Kuvendit bazuar vetëm në lejen verbale të Gjyqtarit të procedurës paraprake.
- 123) Gjykata thekson se raporti lidhur me kontrollin në C., që iu dërgua Prokurorit, nuk përmban ndonjë shpjegim përse kontrolli u krye pa urdhër me shkrim. Ekziston vetëm një tregues se ai u bazua në lejen verbale të Gjyqtarit të procedurës paraprake. Asnjë shpjegim nuk u dha lidhur me ekzistencën e rrethanave urgjente, që do ta kishin arsyetuar këtë mënyrë të vepruari.
- 124) Për mendimin e Gjykatës, rrethanat urgjente që do ta arsyetonin këtë sjellje, nuk ekzistonin. Për ta argumentuar këtë arsyetim, duhet nënvizuar se kontrolli i ambienteve në B.M., që u përfshi në urdhër-kontrollin me shkrim të lëshuar më 28 prill 2010, u krye vetëm më 29 prill 2010, që është një ditë pas kontrollit në C.. Sikur të kishte pasur rrezik të madh real për shkak të vonesës, që do të kishte sjellë si pasojë humbje të provave, kontrollet e të gjitha ambienteve të pretenduara se i përkasin F.L., do të ishte kryer në të njëjtën kohë, d.m.th. në një veprim të bashkërenduar dhe njëkohësisht, me qëllim që i pandehuri ose ndonjë person tjetër të mos lejohej të ndërmerre ndonjë hap me synimin për të asgjësuar sende me peshë potenciale për lëndën. F.L. u informua për kontrollet e kryera më 28 prill 2010 në zyrat e MTPT-së, në shtëpinë e tij në C. dhe në banesën e tij në Rr. Rexhep Luci. Për këtë arsye, ai mund të kishte hamendur që do të kontrolloheshin edhe ambientet e tij në B.M., gjë që ndodhi më 29 prill 2010. Kësisoj, në rast se i pandehuri F.L. do ta kishte gjetur të nevojshme të asgjësonte ose fshihte ndonjë provë potencialisht fajësuese, të mbajtur në B.M., ai do të kishte pasur kohë të mjaftueshme për ta bërë këtë.
- 125) Mungesa e bashkërendimit të kontrolleve të kryera në prill 2010 në ambientet e F.L. e shpie Gjykatën në përfundimin se nuk ekzistonin rrethana urgjente përjashtimore, që do ta kishin lejuar policinë gjyqësore ta fillonte kontrollin vetëm me lejen verbale të Gjyqtarit të procedurës paraprake.
- 126) Për më tepër, Gjykata është e mendimit se Prokurori mund ta kishte siguruar në kohë urdhër-kontrollin me shkrim për C.n. Prokuroria mori informacion për adresën e shtëpisë së tij më 28 prill 2010 rreth orës 12.00 të mesditës, dy orë pasi Gjyqtari i procedurës paraprake e kishte nxjerrë urdhrin me shkrim dhe tre orë para se të nisnin kontrollet. Nuk ishte arsye për të mos paraqitur kërkesë urgjente për urdhër-kontrollin për këtë pronë, veçanërisht sepse arsyetimi i

kërkesës do të kishte qenë pothuajse i njëjtë me ato që u referoheshin ambienteve të tjera të F.L.. Krahas kësaj, ishte mesi i ditës së punës, prandaj nuk do të kishte pasur asnjë lloj problemi për ta kontaktuar Gjyqtarin kompetent të procedurës paraprake, të cilit nuk do t'i ishte nevojitur shumë kohë për ta shqyrtuar kërkesën, sepse ai ishte tashmë i njohur me lëndën dhe tashmë kishte lëshuar urdhra-kontrolli mbi bazën e provave dhe arsyeve të njëjta që do të kishte qenë e mundur të kërkoheshin për të arsyetuar kontrollin në C..

127) Po kështu, edhe në lidhje me kontrollin e kryer në dhomat e serverëve të Kuvendit nuk ekzistonin rrethana urgjente. Sipas “Raportit të Urgjencës dhe Urdhrit Verbal të Gjykatës”, urgjenca buron nga fakti se *“kushdo që kishte lidhje rrjeti ose interneti, mund të kishte qasje nga distanca në këta serverë dhe të fshinte, ose ndryshonte provat e ruajtura në to”*²⁴. Megjithatë, Gjykata gjen se kjo parashtresë është e keq-konceptuar dhe Gjykata pajtohet me argumentet e paraqitura nga Mbrojtja se një urgjencë e tillë nuk ishte e pranishme. Siç është veçanërisht e qartë nga raporti policor i datës 11 maj 2010, nga koha kur Prokurori dhe hetuesit mbërritën në vendndodhjen e dhomave të kyçura të serverëve në ndërtesën e Kuvendit e deri në fillimin faktik të ekzaminimit të serverëve, kaluan më shumë se dy orë. Mungesa e urgjencës mund të perceptohet nga fakti se Prokurori në vendngjarje, si dhe hetuesit që zbatuan udhëzimet e tij, u treguan të gatshëm ta praninin vonesën e ndjeshme në kryerjen e kontrollit për asnjë arsye tjetër. Në rast se çështja do të kishte qenë vërtet urgjente, hetuesit nuk do të kishin ngurruar të përdornin forcë fizike, me qëllim që të siguronin qasje në dhomat e kyçura të serverëve. Krahas kësaj, meqë Prokurori ishte disa herë në kontakt të drejtpërdrejtë përmes telefonit me Gjyqtarin përgjegjës të procedurës paraprake, bashkërendimi për urdhër gjykate me shkrim mund të ishte realizuar kollaj. Prandaj, Gjykata është e mendimit se urdhër-kontrolli me shkrim mund të ishte siguruar në kohë, pa shkaktuar rrezik të madh për shkak të vonesës, që mund të kishte rezultuar në humbje të provave.

c. Kontrolli i dhomave të serverëve në ndërtesën e Kuvendit u krye në shkelje të Nenit 243 (2), lidhur me Nenin 245 (4), të KPPK-së (Neni 246 (5) dhe (6) i KPPK-së)

128) Gjykata gjen se kontrolli në ndërtesën e Kuvendit u krye në shkelje të Nenit 243 (2) të KPPK-së. Krahas kësaj, kërkesat e Nenit 245 (4) të KPPK-së nuk janë përmbushur, sepse mungesa e dy dëshmitarëve në moshë madhore nuk u arsyetua në bazë të rrethanave të lëndës.

²⁴ Dosja 3, faqet 35 -38

- 129) Është e pakontestueshme se gjatë kontrollit të ndërtesës së Kuvendit, Akuza nuk veproi në pajtueshmëri me Nenin 243 (6) të KPPK-së. Gjykata pajtohet me gjetjen e Akuzës se kjo shkelje procedurale nuk i bën provat të papranueshme sipas KPPK-së, sepse Neni 246 (3) qartazi i referohet vetëm Nenit 243 (1) dhe (2). Megjithatë, për sa i takon kërkesës së përcaktuar në Nenin 243 (2) të KPPK-së, Gjykata nuk sheh ndonjë provë në proces-verbal se kontrolli u krye në prani të dëshmitarëve në moshë madhore. Krahas kësaj, Gjykata gjen se nuk u përmbushën as kërkesat materiale, as kërkesat formale të Nenit 245 (4) të KPPK-së.
- 130) Në bazë të Nenit 245 (4) të KPPK-së, së pari duhet vendosur nëse prania e dëshmitarëve nuk mund të sigurohej menjëherë. Raportet policore nuk përmbajnë ndonjë deklaratë në lidhje me këtë. Ndonëse mund të kishte qenë e papërshtatshme, po të kemi parasysh kohën kur u krye kontrolli, mendimi i Gjykatës është se prapëseprapë ekzistonte detyrimi për të bërë të paktën një farë përpjekjeje. Fakti që kontrolli u krye pas orarit zyrtar të punës, nuk është gjë e pazakontë dhe *per se* nuk mund ta bëjë një situatë përjashtimore. Në lidhje me përcaktimin nëse do të kishte qenë e rrezikshme të vonohej fillimi i kontrollit, i bëhet referencë vlerësimit nga Gjykata të rrethanave urgjente, tashmë të përvijuara më lart.
- 131) Gjykata është e mendimit se, nisur nga ecuria faktike e kontrollit në Kuvend, nuk duket se kishte ndonjë urgjencë që do të kishte pamundësuar ftesën për drejtuesin e entit publik dhe veçanërisht për të siguruar praninë e dëshmitarëve në kontroll. Gjykata gjen se proces-verbali i kontrollit nuk përmban shënime për sa u përket arsyeve përse nuk pati dëshmitarë prezent. Ky proces-verbal është i detyrueshëm, sipas Nenit 245 (4) të KPPK-së (“duhet”). Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se detyrimi për praninë e dy dëshmitarëve në moshë madhore thjesht u shpërfill ose u harrua. Pajtueshmëria me këtë kërkesë është shumë e rëndësishme jo vetëm për të verifikuar veprimet e policisë, por edhe për të siguruar që policia të mos përfshihet në veprime arbitrare ose të paligjshme.
- 5. Nëse deklaratat e marra si provë nga Prokurori pas datës 23 prill 2012 janë të pranueshme, ngase veprimet hetimore për sigurimin e atyre provave u ndërmorën pas kalimit të afatit prej dy vjetësh për të përfunduar hetimet.**

i. Parashtrësia e palëve

- 132) Mbrojtësit e F.L., D.L. dhe N.K. parashtrojnë se, në bazë të Nenit 159 të KPP-së, hetimet duhej të kishin përfunduar brenda dy viteve. Kur nuk ngrihet aktakuzë brenda periudhës dy vjeçare, ose nuk është regjistruar ndonjë pezullim në bazë të Nenit 157 të KPP-së, hetimet ndërpriten vetvetiu. Argumentohet se në lëndën në fjalë, afati dy vjeçar për kryerjen e hetimeve, për të pandehurit F.L. dhe N.K. përfundoi më 23 prill 2012 dhe nga Prokurori nuk u ndërmor asnjë zgjerim i hetimeve të nisura tashmë, as ndonjë hetim i ri. Krahas kësaj, Mbrojtja parashtron se Akuza shkeli ligjin procedural duke e ngritur Aktakuzën pas përfundimit të afatit dy vjeçar.
- 133) Mbrojtja më tej argumenton se shpjegimet ligjore të bëra nga Prokurori në Aktakuzë, për të mbështetur mënyrën e tij të veprimit, janë të keq-konceptuara, sepse Neni 225 i KPPK-së nuk jep të drejtën e zgjerimit të hetimeve veçant për çdo të pandehur dhe për çdo vepër penale. Nga Mbrojtja është parashtruar se interpretimi i parapëlqyer nga Prokurori do të sillte leje të paarsyetuar dhe të palejueshme që Prokurori të vazhdonte hetime pa fund, me çka do të fitonte kohë shtesë thjesht duke shtuar individë sipas dëshirës, për ta bërë të tepërt gjithë kundërshtimin dhe qëllimin e Nenit 159 të KPP-së.
- 134) Më tej parashtrohet se Akuza gaboi në mbështetjen nga ana e saj në Aktvendimin e Gjykatës Supreme të datës 6 prill 2012, ngase Gjykata nuk ka vendosur nëse afati ligjor i zgjerimit të hetimeve duhet të vlerësohet veçan për çdo vepër penale dhe për çdo të pandehur, sepse ajo nuk ka vendosur lidhur me meritat.
- 135) Krahas këtij kundërshtimi të përgjithshëm të bërë nga Mbrojtja, Mbrojtja e D.L. parashtron se Prokurori nuk kishte të drejtë t'i zgjeronte hetimet kundër të pandehurit D.L., sepse afati i hetimeve kundër të pandehurit F.L. dhe Nexhat Krasniqit tashmë kishte përfunduar.
- 136) Në përgjigjen e saj Akuza parashtron se, për vlerësimin e kësaj çështjeje duhet të jetë i zbatueshëm KPPK dhe jo KPP, sepse ky ishte ligji në fuqi kur u ndërmor veprimi faktikisht. Akuza më tej mbështetet në argumentet ligjore tashmë të parashtruara në Aktakuzë, kur u përvijua përse veprimet hetimore të kryera pas 23 prillit 2012 mbeten të papranueshme për të gjithë të dyshuarit dhe akuzat, përveç atyre që përfunduan në atë datë. Nga Akuza është parashtruar se kufizimi kohor i 23 prillit 2012 vlente vetëm për F.L. dhe Nexhat Krasniqin për pesë akuzat e pastrimit të parave deri në vitin 2010, krimin të organizuar, përvetësimin gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrimin në detyrë dhe pranimin të ryshfeteve. Hetimet kundër F.L. për akuzat e pastrimit të parave deri në vitin 2012, shpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar, lidhjes së

kontratës së dëmshme dhe mosdeklarimit të parave të marra për fushatë u vazhduan nga PSRK mbi bazë ligjore.

- 137) Prokurori parashtron se, kur vendosi për afatet kohore të specifikuara në Nenin 225 (2) të KPPK-së, Gjykata Supreme me aktvendimet e datës 19 gusht 2011 dhe 6 prill 2012 qartësoi se (1) rregullat ligjore që udhëheqin vazhdimet e hetimeve dhe zgjerimet e hetimeve duhen parë si të ndara dhe të pavarura nga njëra-tjetra; dhe (2) vazhdimi i hetimeve duhet të vlerësohet individualisht për çdo të pandehur dhe çdo akuzë përkatëse. Akuza mëton se kur i vazhdoi hetimet në lëndën në fjalë, ajo ka vepruar rreptësisht në pajtim me këto dy parime. Për sa i përket argumentit të Mbrojtjes se Aktakuza duhej të ishte ngritur brenda afatit kohor dy-vjeçar, Akuza parashtron se kundërshtimi është i pabazuar, sepse ngritja e Aktakuzës nuk mund të konsiderohet si “veprim hetimor” në bazë të Nenit 225 të KPPK-së.

ii. Ligji i zbatueshëm

- 138) Gjykata është e mendimit se ligji i zbatueshëm për të vlerësuar kundërshtimin e Mbrojtjes është KPPK dhe jo KPP, sepse KPPK ishte ligji i zbatueshëm në kohën e kryerjes së hetimeve. Zbatimi i dispozitave të reja të KPP-së do të ishte jo vetëm i paarsyeshëm, por edhe i padrejtë për Akuzën, sepse ligji që rregullonte shqyrtimin, pezullimin, pushimin dhe afatet kohore për hetimet penale ishte objekt i ndryshimeve sipas Kodit të ri procedural, që Prokurori nuk mund t'i kishte parashikuar gjatë kohës që u kryen hetimet. Ligji lidhur me afatin kohor për kryerjen e një hetimi sipas KPPK-së shprehet, në pjesët përkatëse, si vijon:

Neni 220 (1)

Prokurori publik e fillon hetimin kundër personit të caktuar duke u informuar nëpërmjet kallëzimit penal ose burimeve të tjera, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se ai person ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Neni 221 (1)

Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit publik. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale dhe provat me informacionin e mbledhur deri në

atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake.

Neni 222 (1) (2)

Hetimi kryhet vetëm lidhur me veprën penale dhe me të pandehurin e përcaktuar në aktvendim mbi fillimin e hetimit.

Nëse gjatë hetimit procedura duhet të zgjerohet për një veprë tjetër penale ose për një person tjetër, prokurori publik fillon hetim të ri ose e zgjeron hetimin ekzistues. Gjithë kjo duhet shënuar në procesverbalin e hetimit dhe prokurori publik e informon për këtë gjyqtarin e procedurës paraprake.

Neni 225 (1) (2)

Nëse hetimi nuk përfundon brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, prokurori publik i paraqet kërkesë me shkrim gjyqtarit të procedurës paraprake së bashku me arsyet për zgjatjen e hetimit.

Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim të hetimit deri në gjashtë muaj kur kjo arsyetohet me ndërlikueshmërinë e çështjes. Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me të paktën pesë vjet burgim, gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë edhe një vazhdim deri në gjashtë muaj. Gjykata Supreme e Kosovës, përjashtimisht, mund të autorizojë edhe një vazhdim prej gjashtë muajsh.

- 139) Nga këto dispozita është e qartë se hetimi penal mund të fillohet kundër një personi të caktuar vetëm nëse ka dyshim të arsyeshëm se ky person ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare. Shtrirja e hetimeve duhet të përcaktohet nga Prokurori kompetent në aktvendimin për fillimin e hetimeve, që duhet të specifikojë të pandehurin dhe veprën penale. Prokurori ka të drejtë ta zgjerojë hetimin ekzistues për një veprë tjetër penale, ose kundër një personi tjetër. KPPK e lejon kryerjen e hetimit për maksimumi 24 muaj. Në kundërshtim me nenet 158 (3) dhe 159 (1) të KPP-së, KPPK nuk specifikon pasojat ligjore të kalimit të afatit të hetimit.

iii. Gjetjet e Gjykatës

- 140) Zbatimet e Nenit 222 të KPPK-së dhe afatet kohore të parashikuara në Nenin 225 të KPPK-së kanë qenë objekt i praktikave të kundërta nga prokurorët dhe gjyqtarët në tërë Kosovën. Konkretisht, disa gjyqtarë e kanë interpretuar Nenin 225 se zbatohet në bazë “lënde në tërësi”, domethënë, se e gjithë periudha prej 24 muajsh zbatohet për hetimet në tërësi, duke nisur nga nxjerrja e Aktvendimit për Fillimin e Hetimit. Sipas këtij interpretimi, hetimi duhet vazhduar për të gjithë të dyshuarit në të njëjtën kohë, pavarësisht nga koha kur ata janë shtuar si të dyshuar përmes një aktvendimi për zgjerimin e hetimeve.
- 141) Praktika e dytë në zhvillim i jep të drejtë gjyqtarit ta miratojë vazhdimin e hetimit në bazë “për çdo të dyshuar”, domethënë që afati kohor i hetimit kundër një individi fillon të llogaritet vetëm nga data e aktvendimit përkatës për zgjerimin e hetimit. Për këtë arsye, afati kohor për të dyshuarit në fillim (aktvendimi fillestar për fillimin e hetimit sipas Nenit 221 (1) të KPPK-së) është i ndryshëm nga afati kohor i zbatueshëm për të dyshuarit të cilët përfshihen në lëndë më vonë, me aktvendim për zgjerimin e hetimit, sipas Nenit 222 (2) të KPPK-së. Çdo i dyshuar ose grup të dyshuarish u nënshtrohen afateve të ndryshme gjashtë mujore, prandaj, në rast se një i dyshuar i është shtuar hetimit vetëm në një fazë të mëvonshme, Prokurori vazhdon të ketë afatin e mundshëm prej 24 muajsh për hetimin – edhe në rast se afati i hetimeve ka kaluar në lidhje me të dyshuarin/t e parë.
- 142) Kohët e fundit praktika e gjykatave, veçanërisht e Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe e Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës Themelore të Pejës, i ka interpretuar Nenin 222 dhe 225 të KPPK-së në mënyrë të tillë që afatet kohore përkatëse të vazhdimin dhe zgjerimit të hetimeve duhet të llogariten në mënyrë të pavarur. Krahas kësaj, është mbajtur qëndrimi se Gjykatat duhet të vlerësojnë mundësinë për vazhdimin e hetimeve veçanërisht për çdo të pandehur dhe vepër penale (krahaso *Gjykata Supreme e Kosovës, PN-KR 440/11 (“Lënda e tokave”), 17 gusht 2011, f. 8; Gjykata Supreme e Kosovës (“Kleçka”), Pn-Kr 406/2011, 19 gusht 2011; Gjykata Supreme e Kosovës, Pns.-Krs. Nr. 1/2012 (“MTPT”), 6 prill 2012, f. 3; Gjykata Themelore e Prishtinës, GJPP242/12, 4 janar 2013, f. 6; Gjykata Themelore e Pejës, Aktvendim mbi Kërkesën e Prokurorit për Qartësim, 6 shkurt 2013, f. 5*). Në Aktvendimin e Gjykatës Supreme në lëndën numër PN-KR 440/11, të datës 17 gusht 2011, u shpall se (faqe 8, paragrafi 4):

“Në rast se hetimi është filluar kundër një të dyshuari, dhe më vonë është zgjeruar për një të dyshuar tjetër, data e kalimit të afatit të hetimit për të dyshuarin e parë do të ishte më herët se data e kalimit të afatit për të dyshuarin e dytë.”

Për rrjedhojë, Gjykata Supreme i ndau të dyshuarit nga datat e ndryshme në të cilat ata iu shtuan lëndës me aktvendimin fillestar për fillimin e hetimit ose zgjerimet e mëpasshme.

- 143) E njëjta qasje u paraqit nga Gjykata Supreme në lëndën në fjalë në arsyetimin e aktvendimit të shqiptuar më 13 prill 2012, në të cilin u pranua kërkesa e Prokurorit për të vazhduar hetimet.²⁵
- 144) Në lëndën në fjalë, Prokurori i filloi hetimet më 23 prill 2010 me shqiptimin e Aktvendimit për Fillimin e Hetimit kundër të pandehurit F.L. dhe N.K. për veprat penale të pastrimit të parave, krimit të organizuar, përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe kërkimit të ryshfeteve. Hetimet u vazhduan dhe u zgjeruan disa herë në lidhje me akuza të ndryshme dhe të pandehur të tjerë. Po të zbatohet qasja e parë e përvijuar më lart, afati i hetimeve do të kishte përfunduar në të vërtetë për të gjithë të pandehurit më 23 prill 2012 dhe provat e siguruara pas kësaj dite nuk do të mbuloreshin me një hetim penal të efektshëm, siç parashtron Mbrojtja. Kryetarja e trupit gjykues është e mendimit se kundërshtimi i paraqitur nga Mbrojtja është i keq-bazuar, sepse, duke marrë parasysh jurisprudencën e fortë e të konsoliduar, veprimet hetimore që u kryen nga Akuza në lëndën në fjalë pas 23 prillit 2013 mbeten të pranueshme për të gjithë të dyshuarit dhe akuzat, përveç atyre që u përfundoi afati më 23 prill 2012.
- 145) Gjykata e gjen të arsyeshme t'i interpretojë Nenet 222 dhe 225 të KPPK-së në mënyrë të tillë që ta konsiderojë zgjerimin e një hetimi dhe vazhdimin e atij hetimi në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, qasja ligjore për të vlerësuar vazhdimin e hetimit individualisht për çdo të pandehur dhe çdo akuzë përkatëse është, për mendimin e Kryetares së trupit gjykues, racionale, sepse përndryshe mund të ndodhte situata e vështirë që në lidhje me një të dyshuar, i cili i është shtuar lëndës me zgjerim të hetimit vetëm pak ditë para përfundimit të afatit të përgjithshëm 24 major, afati kohor fillestar do të zbatohet njësoj për të, çka mund të pengonte hetimin e duhur.
- 146) Me qëllimin për të shmangur lejen e paarsyetuar dhe të palejuar të Prokurorit për hetime pa fund, një rrezik që Mbrojtja e thekson me të drejtë, kjo qasje duhet t'i ketë kufijtë e natyrshëm të saj në keqpërdorim, p.sh. në rast se Akuza përpiqet të realizojë afate hetimore pothuajse pa fund nëpërmjet ndarjes artificialisht të fillimit ose zgjerimit të hetimeve. Në lëndën në shqyrtim, megjithatë, Gjykata nuk gjen ndonjë tregues se Akuza e tejkaloi kompetencën e saj duke keqpërdorur procesin e hetimeve. Përkundrazi, lidhur me këtë ajo veproi në pajtueshmëri të

²⁵ Dosja 2, faqet 139 – 142, 143 - 148

plotë me kornizën ligjore të zbatueshme, siç është vendosur nga KPPK dhe jurisprudenca e Gjykatës Supreme të Kosovës.

- 147) Gjykata gjen se kundërshtimi i bërë nga Mbrojtja se aktakuza është e kufizuar nga afate kohore, sepse ajo u ngrit pas afatit dy vjeçar, nuk mund të bazohet Nenin 249 të KPP-së, sepse ngritja e Aktakuzës si e tillë nuk është kundërshtim ndaj provave të renditura në Aktakuzë, por më tepër kërkesë për të rrëzuar aktakuzën. Megjithatë, Kryetares së trupit gjykues nuk i duhet të vendosë nëse kjo kërkesë mund të jetë e bazuar në njëren prej arsyeve të mishëruara në Nenin 250 (1) të KPP-së dhe nëse Mbrojtja duhej t'ia kishte ngritur çështjen Gjyqtarit të Konfirmimit të Aktakuzës menjëherë pas ngritjes së Aktakuzës sepse, në çdo rast, argumentet e paraqitura nga Mbrojtja janë të keq-bazuara sipas ligjit të zbatueshëm. KPPK nuk përshkruan çfarë ndikimi e pasoje ligjore mund të kishte në lëndë kalimi i afatit të hetimit. Ndërsa KPP qartazi parashikon "hetimi pushohet vetvetiu me kalimin e afatit të tij" (Nenet 159 (3); 159 (1) të KPP-së), KPPK hesht në lidhje me këtë. Afatet kohore të parashikuara në Nenin 225 të KPPK-së lidhen qartazi me mbledhjen e provave dhe jo me ngritjen e aktakuzës, që nuk është veprim hetimor *sensu stricto*.
- 148) Gjykata ndjek qasjen ligjore të zbatuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, që mbajti qëndrimin se kalimi i afatit të hetimit nuk shënon pushimin e hetimit, por lënda mbetet aktive dhe Prokurori mund të ngrëjë aktakuzë në çdo kohë, me kufizimin e vetëm të afatit të parashkrimit (*krahaso: Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz 465/08 (Idriz Gashi), 2 qershor 2009, p. 5; Gjykata e Qarkut e Prishtinës, GJPP 125/10 ("PTK"), Aktvendim për Konfirmimin e Aktakuzës, paragrafi 13; Gjykata Themelore e Pejës, Gjykata Themelore e Pejës, Aktvendim lidhur me Kërkesën e Prokurorit për Qartësim, 6 shkurt 2013, p. 6*).

6. Pranueshmëria e deklaratave dhe letrave të dëshmitarit M.S.

i. Parashtrësia e palëve

- 149) Mbrojtja e F.L. parashtron që provat e dëshmitarit të ndjerë kyç M.S. duhen gjetur të papranueshme sepse janë të pambështetshme, të pabesueshme dhe nuk janë kundërshtuar nga Mbrojtja në ndonjë fazë të procedurës penale. Në lidhje me deklaratat që M.S. i dha Agjencionit kundër Korrupsionit ("AKK") dhe deklaratën që dha para EULEX-it, Mbrojtja argumenton se këto deklarata janë të papranueshme në bazë të Nenit 262 (1) të KPP-së (ose Nenit 156 (2) të KPPK-

së), sepse Mbrojtja nuk e ka pasur dhe nuk do ta ketë mundësinë t'i kundërshtojë këto deklaratat.

- 150) Mbrojtja thekson se e drejta e përgjithshme e të akuzuarit për t'u ballafaquar me dëshmitarin kundër tij në një lëndë penale është e drejtë themelore e njohur jo vetëm nga instrumente të ndryshme të të drejtave të njeriut, përfshirë KEDNJ-në, por edhe në bazë të garancive kushtetuese të Kosovës. Mbrojtja u referohet Neneve 61 (3) dhe 132 (6) të KPP-së, sipas të cilave Mbrojtja duhet të njoftohet për datën, orën dhe vendin e dëshmisë në procedurë paraprake. Moslejimi nga Akuza i Mbrojtjes për të marrë pjesë në veprimet hetimore që ndërmori Akuza, është si shkelje e të drejtave procedurale, ashtu dhe e atyre kushtetuese ndër të tjera sipas Nenit 31 (4) të KPP-së.
- 151) Më tej është parashtruar se argumentet e paraqitura nga Akuza në Aktakuzë në lidhje me ndërlidhjen ligjore ndërmjet Nenit 156 (2) dhe Nenit 157 (1) dhe (2) të KPPK-së janë të keq-konceptuara, sepse, që të zbatohen dispozitat e Nenit 157 (1) dhe (2) të KPPK-së, në radhë të parë duhet përmbushur dispozita e Nenit 156 (2) të KPPK-së, çka nuk është kështu në procedurën në fjalë.
- 152) Lidhur me letrat e shkruara nga M.S. për organet shtetërore të Kosovës, Mbrojtja parashtron se ato nuk mund të konsiderohen si prova shkresore sepse, përsëri, këto letra nuk janë testuar nëpërmjet marrjes në pyetje e nga pala tjetër dhe e drejta e ballafaqimit nuk është përmbushur. Më tej, është parashtruar se letrat në fjalë nuk u shkruan nën betim, dhe besueshmëria dhe mbështetshmëria e M.S. nuk janë testuar.
- 153) Mbrojtja kundërshton referencën dhe mbështetjen nga Akuza në aktvendimin për konfirmimin e aktakuzës në lëndën GJPP 125/10, sepse lëndët janë të dallueshme lidhur me faktet. Ndërsa në lëndën GJPP 125/12 dëshmitari është gjallë, por nuk është thirrur për të dëshmuar në fazën hetimore, dëshmitari M.S. ka vdekur dhe Mbrojtja nuk e ka pasur mundësinë ta marrë atë në pyetje dhe nuk do ta ketë këtë mundësi në të ardhmen.
- 154) Nën pjesën E 3. të Aktakuzës, Akuza parashtron tashmë se të gjitha dëshmitë e marra nga dëshmitari i ndjerë M.S. janë të pranueshme. Provat e siguruara nuk u bënë të papranueshme me vdekjen e papritur të dëshmitarit. Në lidhje me letrën e M.S. drejtuar qeverisë së Kosovës dhe duke iu referuar aktvendimit konfirmues në lëndën GJPP 125/12, Akuza pohon se letra

është provë shkresore që nuk përfshihet në kufizimin e Nenit 156 (2) të KPPK-së. Më tej Akuza parashtrohet se argumenti i Mbrojtjes lidhur me lidhjen e ndërsjellë ndërmjet Nenit 156 dhe 157 të KPPK-së është e keq-bazuar, ngase Neni 157 (2) i KPPK-së sa i referohet vetëm Nenit 156 (1) të KPPK-së dhe jo edhe Nenit 156 (2) të KPPK-së. Në kundërshtim me parashtresën e Mbrojtjes, Akuza mëton se vendimi i Gjyqtarit të Konfirmimit të Aktakuzës në GJPP 125/12 është i zbatueshëm edhe për lëndën në fjalë, sepse nuk është e rëndësishme nëse dëshmitari nuk mund të ballafaqohet nga Mbrojtja, sepse ai ka vdekur, ose është thjesht i paqasshëm. Lidhur me deklaratat e M.S. të bëra para AKK-së, Akuza argumenton se Neni 156 (2) i KPPK-së nuk është i zbatueshëm, sepse deklarata nuk iu dha policisë ose prokurorisë publike, por një institucioni tjetër. Krahas kësaj, akuza argumenton se dëshmia është e pranueshme mbi bazën se ajo nuk është provë vendimtare për të përcaktuar fajësinë e të pandehurve në pajtim me Nenin 157 (1) të KPPK-së. Së fundi, Akuza parashtrohet se deklarata e dëshmitarit M.S. para EULEX-it mund të lexohet dhe është e pranueshme si provë në procedurës së provave, me qëllim të “bërjes së vlefshme të kësaj prove materiale”.

ii. Ligji i zbatueshëm

155) Kushtet për ta shpallur të papranueshme deklaratën e një personi i cili është marrë në pyetje si dëshmitar, janë specifikuar në Nenin 161 (1) të KPPK-së si vijon:

- 1) Personi nuk mund të pyetet si dëshmitar (neni 159 i këtij Kodi);
- 2) Personi nuk ka detyrim dëshmimi (neni 160 i këtij Kodi) e nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal;
- 3) Personi është fëmijë, i cili nuk kupton të drejtën e tij për të refuzuar dëshmimin ose;
- 4) Dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, me kanosje ose me ndonjë mjet tjetër të ngjashëm të ndaluar (neni 155 i këtij Kodi).

156) Në bazë të Nenit 156 (2) të KPPK-së, deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale. Gjithashtu, Neni 157 (1) të KPPK-së parashtrohet se gjykata nuk

e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi, ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër, e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

- 157) Në Nenin 262 të tij, Kodi i ri parashikon se Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi, ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër, e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.
- 158) Interpretimi i dispozitave të përmendura më lart shpie në përfundimin se deklaratat e dëshmitarit dhënë policisë ose Prokurorit mund të jenë prova të pranueshme në Gjykatës edhe nëse Mbrojtja nuk ka pasur mundësinë t'i kundërshtojë nëpërmjet marrjes në pyetje. Por ato nuk mund të jenë provat e vetme ose vendimtare të fajësisë. Kjo qasje është pranuar edhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Fakti që dëshmitari vdiq pasi dha deklaratën, duke i pamundësuar Mbrojtjes ta kundërshtojë nëpërmjet marrjes në pyetje, nuk shpie në papranueshmërinë e këtyre provave.
- 159) Neni 6 § 3(d) i KEDNJ-së mishëron parimin se, para se një i akuzuar të mund të dënohet, të gjitha provat kundër tij duhet të paraqiten normalisht në prani të tij, në një seancë publike, me synimin e argumentimit kundërshtar. Përrjashtimet në këtë parim janë të mundshme, por nuk duhet të shkelin të drejtat e Mbrojtjes, që, si rregull, kërkojnë që të akuzuarit duhet t'i jepet mundësi e mjaftueshme dhe e rregullt për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje dëshmitarin kundër tij, ose kur ky dëshmitar jep deklaratën e tij, ose në një fazë të mëvonshme të procedurës. Parimi themelor është se i pandehuri në shqyrtim gjyqësor penal duhet të ketë mundësi të efektshme për të kundërshtuar provat kundër tij. Ai kërkon jo vetëm që i pandehuri duhet të dijë identitetin e dëshmitarëve që dëshmojnë kundër tij, me qëllim që ai të jetë në pozitë të kundërshtojë vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre, por edhe që ai duhet të ketë mundësinë të testojë vërtetësinë dhe mbështetshmërinë e provave të tyre, duke i marrë ata në pyetje gojarisht në prani të vet, ose në kohën që dëshmitari po jep deklaratën, ose në ndonjë fazë të mëvonshme të procedurës.
- 160) Duke pasur parasysh jurisprudencën e GJEDNJ-së, nga parimi i mësipërm i përgjithshëm burojnë dy kërkesa. Së pari, për mos-pjesëmarrjen e dëshmitarit duhet të ketë arsye të fortë. Së dyti, kur dënimi është bazuar vetëm ose në shkallë vendimtare në deklaratat që janë dhënë nga një

person të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësinë ta marrë në pyetje, nëse gjatë hetimit ose në shqyrtim gjyqësor, të drejtat e Mbrojtjes mund të kufizohen deri në një shkallë që është e papajtueshme me garancitë e ofruara nga Neni 6 (i ashtuquajtur "rregulli i vetëm ose vendimtar").

- 161) Kërkesa që, për pranimin e provave të dëshmitarit mungues duhet të ketë arsye të fortë, është çështja paraprake që duhet shqyrtuar, para se të jepet ndonjë vlerësim tjetër nëse këto prova ishin të vetmet ose vendimtare. Edhe kur provat e dëshmitarit mungues nuk kanë qenë të vetmet ose vendimtare, prapëseprapë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur shkelje të Nenit 6 1 dhe 3 (d) kur nuk është treguar ndonjë arsye e fortë për mosmarrjen në pyetje të dëshmitarit. Arsyeja është sepse, si rregull i përgjithshëm, dëshmitarët duhet të japin dëshmi gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se për të siguruar praninë e tyre, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e arsyeshme. Prandaj, kur dëshmitarët nuk paraqiten për të dhënë dëshmi drejtpërdrejt, ekziston detyrimi që të hetohet nëse kjo mungesë është e arsyetuar. Është e qartë se, kur dëshmitarit ka vdekur, që provat e tij të merren parasysh, do të jetë e nevojshme të paraqitet deklarata e tij si dëshmitar.
- 162) Kuptimi i rregullit e vetme ose vendimtare gjendet në lëndën *Unterpertinger kundër Austrisë (Aktgjykim i GJEDNJ-së, 24 nëntor 1986, § 33)*, që gjithashtu përcakton racionalen për testin që duhet zbatuar: në rast se dënimi i të pandehurit bazohet vetëm ose kryesisht në dëshminë e dhënë nga dëshmitarët të cilët i akuzuari nuk ka mundësi t'i marrë në pyetje në ndonjë fazë të procedurës, të drejtat e tij për mbrojtje janë kufizuar në mënyrë të parregullt.
- 163) Siç është shpallur në Aktgjykimin në lëndën e *Al – Khawaja dhe Tahery kundër MB-së (Aktgjykim i GJEDNJ-së, 15 dhjetor 2011)* në lidhje me kuptimin e këtij rregulli, fjala "e vetme", në kuptimin e provës së vetme kundër të akuzuarit, nuk duket se ka krijuar vështirësi, dhe kritika kryesore drejtohet ndaj fjalës "vendimtare". "Vendimtare" në këtë kontekst do të thotë më shumë se "provuese". Madje do të thotë më shumë se kaq, pa këtë provë, mundësitë e dënimit do të dobësoheshin dhe gjasat e lirimit nga akuza do të forcoheshin. Fjala "vendimtare" duhet kuptuar ngushtësisht se tregon provë të asaj peshe ose rëndësie që ka të ngjarë të jetë përcaktuese e rezultatit të lëndës. Kur prova e patestuar e dëshmitarit mbështetet me prova të tjera vërtetuese, vlerësimi nëse kjo provë është vendimtare do të varet nga fuqia e provave mbështetëse; sa më të forta provat vërtetuese, aq më e pakët gjasa që dëshmia e dëshmitarit mungues të trajtohet si vendimtare.

- 164) Dispozitat përkatëse të të dy Kodeve të Procedurës Penale, që rregullojnë pjesëmarrjen e Mbrojtjes në marrjen në pyetje të dëshmitarëve në fazën e hetimit, janë këto:

Neni 237 (4) i KPPK-së

Prokurori publik mund të vendosë të thërret të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe të dëmtuarin të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit ose ekspertit.

Neni 131 (2) i KPP-së

Prokurori i shtetit mund të lejojë mbrojtësin, viktimën apo mbrojtësin e viktimave që të marr pjesë në marrjen në pyetje në procedurë paraprake.

- 165) Interpretimi i të dy neneve të përmendura më lart nuk ngre asnjë dyshim lidhur me atë Prokurori ka diskrecionin të vendosë nëse ta ftojë Mbrojtësin për të marrë pjesë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve gjatë hetimit. Ai lejohet ta bëjë këtë, por nuk është i detyruar.

iii. Gjetjet e Gjykatës

- 166) Procedura në këtë lëndë u fillua si rezultat i deklaratave të dhëna nga M.S. para AKK-së në vitin 2009. Më pas ai u mor në pyetje nga Policia e EULEX-it, gjë që ndodhi më 12 janar 2010. Në shkurt 2010, M.S. vdiq në një aksident me veturë. Hetimet kundër dy të pandehurve të parë (F.L. dhe N.K.) u filluan vetëm më 28 prill 2010.

a. Deklaratat para Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit (AKK)

- 167) Siç rezulton nga *Informacioni lidhur me pretendimet për korrupsion*, i marrë nga PSRK më 20 tetor 2009, më 06 maj 2009 M.S. i bëri kërkesë Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës hetimore kundër F.L. – Ministër i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe N.K. – Menaxher i Prokurimit në MTPT²⁶. Duke vepruar lidhur me raportin e siguruar nga M.S., Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit (AKK) nisi hetimet paraprake për të verifikuar informacionin për korrupsionin e pretenduar brenda Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit lidhur me tenderët për ndërtimin e rrugëve. M.S. u kontaktua disa herë nga AKK dhe dha deklarata në të cilat ai përshkroi shembuj të korrupsionit të pretenduar.

²⁶ Dosja 19 A, f. 1 - 7

- 168) Pasi përfundoi këtë fazë të procedurës, AKK përcaktoi se kishte të dhëna të mjaftueshme dhe dyshim të arsyeshëm se mund të ishin kryer vepra penale, dhe ia paraqiti lëndën PSRK-së. AKK i bashkëngjiti kësaj përcjelljeje letrën e M.S. "Për Organet Shtetërore të Kosovës"²⁷, CD-në me incizimin e deklaratës së M.S. dhe transkriptin e saj²⁸.
- 169) Analiza e incizimeve në CD dhe transkripteve të tyre që AKK i dorëzoi PSRK-së, shpie në përfundimin se ato nuk mund të trajtohen si deklaratë dëshmitari. M.S. nuk u intervistua në këtë cilësi nga një prokuror ose polic i autorizuar, ai nuk u udhëzua se ishte i detyruar të tregonte të vërtetën dhe për të drejtën për të mos fajësuar vetveten. Gjithashtu, nuk është e qartë nëse personi që i dha deklaratat ishte vërtet M.S., sepse nuk u mbajt asnjë proces-verbal për këtë veprim dhe ai nuk nënshkroi ndonjë dokument. Identiteti i tij nuk u verifikua në ndonjë mënyrë, për shembull, përmes paraqitjes së letër-njoftimin nga ana e tij. Duhet nënvizuar se nuk është as e qartë kush ia mori deklaratat M.S., sepse personat që vepronin në emër të AKK-së nuk u prezantuan, emrat e tyre nuk ishin në incizime dhe transkripte. Më tej, vendi dhe data e dhënies së deklaratave nuk janë të ditura, sepse nuk ka tregues në incizime.
- 170) Të gjitha këto rrethana e shpjen Gjykatën në përfundimin se deklaratat bashkëngjitur informacionit nga AKK janë thelbësisht të pambështetshme, ngase origjina e këtyre provave është e paditur dhe nuk mbështetet nga të dhëna vërtetuese. Për këtë arsye, incizimet dhe transkriptet e tyre duhet të deklarohen të papranueshme, në pajtim me Nenin 259 (2) të KPP-së.
- 171) Gjykata është e mendimit se këto deklarata mund të ishin përdorur vetëm për qëllime të shërbimit të inteligjencës dhe ato duhej të ishin shndërruar në prova të pranueshme përmes marrjes në pyetje të M.S. në cilësinë e dëshmitarit, në pajtim të plotë me parimet e vendosura nga Kodi i Procedurës Penale.

b. Deklaratat para Policisë së EULEX-it

- 172) M.S. është marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit nga policia e EULEX-it pas lënda i është dorëzuar PSRK-së nga AKK-ja. Intervista është mbajtur më 12 janar të vitit 2010 dhe, veç kësaj, është regjistruar me audio incizim²⁹. M.S. ka vdekur në një aksident me veturë më 21 shkurt të vitit 2010. Në këtë fazë të procedurës nuk ishin filluar hetime kundër askujt, kështu që nuk ka

²⁷ Dosja 19a, f. 21 - 27 (përkthimi në anglishte, f. 8 -14),

²⁸ Dosja 19a, f. 27,

²⁹ Dosja 19a, f. 58 – 92 a (përfshirë versionin në gjuhën angleze).

pasur të pandehur dhe mbrojtës (hetimet janë filluar kundër të pandehurve të parë – F.L. dhe N.K. – më 23 prill të vitit 2010).

173) Deklarata që M.S. e ka dhënë në cilësinë e dëshmitarit është provë e pranueshme, përkundër faktit se të pandehurit nuk kanë pasur asnjë mundësi për ta kundërshtuar atë. Kjo nuk mund të jetë provë e vetme dhe vendimtare në rast të dënimit. Një arsyetim i tillë mbështetet nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që është shpjeguar më lart.

c. Letra e M.S.

174) Në maj të vitit 2009, M.S. ua ka dërguar një letër autoriteteve të Kosovës për korrupsionin e supozuar në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit. AKK-ja e ka pranuar letrën më 6 maj të vitit 2009 dhe ia ka bashkëngjitur më vonë parashtresës që i ishte dërguar PSRK-së.

175) Gjykata konstaton se letra është provë e dokumentuar, prandaj pranueshmëria e saj nuk mund të vlerësohet duke i zbatuar kërkesat ligjore për deklaratat e dëshmitarëve. Për shkak të vetë natyrës së saj, kjo letër nuk mund të kundërshtohet me anë të marrjes në pyetje, e as të shkruhet nën betim. Po ashtu, ka indikacione se kjo letër është marrë në mënyrë të paligjshme. Qasje të ngjashme ka shfaqur Gjykata Supreme e Kosovës në lidhje me një ditar të shkruar nga një dëshmitar.³⁰

176) Prandaj, nuk ka arsye për ta shpallur letrën e M.S. provë të papranueshme.

7. Pranueshmëria e provës SMS në të cilën është mbështetur prokuroria

177) Edhe pse Gjykata i ka shpallur të papranueshme të gjitha provat që janë mbledhur nga bastisja në C., për shkak të shkeljes së ligjit procedural, ajo ende e konsideron të nevojshme që të ofrohen përgjigje për të gjitha vërejtjet që i ka bërë pala.

a. Nëse provat në formë të SMS-ve janë falsifikuar

i. Parashtresat e palëve

³⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap.-Kz. Nr. 527/2012, Aktgjykim, 11 dhjetor 2012, par. 70.

- 178) Mbrojtësit e F.U. dhe E.L. pretendojnë se mesazhet e shkruara në formë të SMS-ve në të cilat është mbështetur aktakuza janë të papranueshme për shkak se nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme dhe janë thelbësisht të pambështetshme. Mbrojtja argumenton se këto SMS janë falsifikime të qëllimshme dhe se në pasqyrën zyrtare të PTK-së që është lëshuar me kërkesë të prokurorisë në vitin 2012 nuk figurojnë komunikime me anë të SMS-ve që përputhen me to. Më tutje, prokuroria nuk ka dëshmuar apo tentuar që të verifikojë nëse SMS-të vërtetë janë dërguar/pranuar nga të pandehurit E.L. dhe F.U. më datat dhe në kohën e cekur në aktakuzë dhe nëse përmbajtja e çdo SMS-je ka qenë e vërtetë dhe e saktë.
- 179) Gjatë intervistës së tij dhënë prokurorisë më 20 prill të vitit 2012, i pandehuri F.L. ka deklaruar se kopjet e shtypura të këtyre SMS-ve, të cilat janë konfiskuar gjatë bastisjes së shtëpisë së tij në C., i janë dorëzuar në mënyrë anonime kryeministrit Hashim Thaçi me anë të një "letre anonime", i cili ia ka përcjellë letrën ministrit përkatës, përkatësisht të pandehurit F.L.. Në intervistën e tij, i pandehuri F.L. ka deklaruar se ai e ka marrë këtë çështje seriozisht dhe e ka përballur shefin e kabinetit, të pandehurin E.L., me të njëjtën dhe ka kërkuar shpjegime. E.L., i cili ka mohuar të ketë dërguar apo pranuar SMS të tilla ndonjëherë, e ka marrë nga PTK-ja një kopje të faturave të thirrjeve telefonike dhe SMS-ve të tij për periudhën përkatëse.
- 180) Mbrojtësi E.L. dorëzon si eksponent për kundërshtimin e provave një faturë të PTK-Valës për shërbime të telekomunikimit që i janë ofruar E.L. nga PTK-ja dhe e cila përfshin një listë të dokumentuar të komunikimeve që janë bërë nga i pandehuri gjatë kohës relevante. Krahas kësaj, mbrojtësi i E.L. dorëzon si eksponent të kundërshtimit të tij një shkresë të pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Republikës së Kosovës, në të cilën thuhet se E.L. nuk ka qenë nën hetime dhe se ndaj tij nuk janë zbatuar masa të fshehta gjatë viteve 2008-2010.
- 181) Gjatë deklaratës së tij dhënë prokurorit më 20 prill të vitit 2012, i pandehuri F.L. ka argumentuar se nga një krahasim me listën zyrtare të marrë nga PTK-ja mund të shihet se kopjet e shtypura të SMS-ve janë fiktive dhe të falsifikuara. Mbrojtësit e F.L. dhe E.L., në kundërshtimet e tyre ndaj provave, sugjerojnë se prokuroria – ndonëse ka qenë e informuar për këto rrethana – ka dështuar në mënyrë fatale gjatë hetimit, duke mos i hetuar SMS-të si duhet paraprakisht për ta vërtetuar vërtetësinë, besueshmërinë dhe autenticitetin e tyre.
- 182) Edhe mbrojtësi i F.Z. pretendon se SMS-të që janë paraqitur në aktakuzë janë falsifikim dhe, për këtë arsye, prova të papranueshme. Për ta mbështetur këtë pretendim, mbrojtja dorëzon si

provë një faturë të lëshuar nga PTK-VALA për shërbimet e telekomunikimit që i janë ofruar F.Z.. Fatura përmban edhe një listë të thirrjeve në lidhje me numrin e telefonit që F.Z. e ka përdorur në mars të vitit 2009. Mbrojtësi i F.Z. argumenton se, nëse krahasohet lista e PTK-Valës me kopjet e shtypura të SMS-ve që janë konfiskuar gjatë bastisjes në C., mund të vërehet se SMS-të që mungojnë në listën që i është bashkëngjitur faturës janë SMS-të inkriminuese në të cilat mbështetet prokuroria. Krahas kësaj, lista që PTK-VALA ia ka dërguar F.Z. përmban dhe një logo zyrtare të VALËS, përderisa e njëjta mungon në kopjet e shtypura të SMS-ve që janë konfiskuar gjatë bastisjes.

183) Në përgjigjen e saj ndaj kundërshtimit të mbrojtësit, prokuroria konstaton se mbrojtësi ka sjuar një “rrëfim konspiracioni” për gjoja falsifikimin e SMS-ve me të vetmin qëllim që provat të shpallëshin të pabesueshme dhe se gjykata nuk duhet të marrë në konsideratë pretendime të tilla të paprovuara dhe të pabazuara. Prokuroria thekson se mbrojtësi nuk ka dhënë shpjegim të besueshëm për atë se kush supozohet se e ka falsifikuar komunikimin me anë të SMS-ve, si janë bërë falsifikimet dhe cili ka qenë motivi i përgjithshëm i falsifikimit. Prokuroria më tej sugjeron se provat duhet të konsiderohen të besueshme dhe të diskutohen gjatë shqyrtimit gjyqësor, mes tjerash, sepse SMS-të e kontestuara ndërlidhen me përmbajtjen e SMS-ve që mund të gjenden pastaj në kopjet e shtypura të PTK-së. Në përgjigjen e saj ndaj pretendimeve të mbrojtësit, prokuroria nuk është përpjekur të vërtetojë nëse SMS-të e kontestuara vërtetë janë dërguar apo pranuar nga të pandehurit E.L. dhe F.Z., por prokuroria sugjeron se të pandehurit e kanë prezantuar këtë çështje në mënyrë proaktive vetëm gjatë marrjes së tyre në pyetje në vitin 2012, ndonëse kanë qenë në dijeni për të që nga viti 2009.

ii. Gjetjet e gjykatës

184) Çështja që mbrojtësit e kanë ngritur në kundërshtimet e tyre ka të bëjë me besueshmërinë e provave që i ka paraqitur prokurori. Ato mund të vlerësohen si duhet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur palët do të paraqesin prova në mbështetje të qëndrimeve të tyre. Vetëm gjatë kësaj faze të procedurës, gjykata do ta ketë mundësinë që t’i vlerësojë shkresat që mbrojtësit ua kanë bashkëngjitur parashtresave të tyre. Provat nuk mund të paraqiten në seancën e dytë, siç rezulton nga neni 254 (7) i KPP-së.

b. Nëse kopjet e printuara të SMS-ve që janë konfiskuar gjatë bastisjes në C. janë prova të papranueshme, meqë nuk janë marrë me anë të një urdhri të gjykatës për përgjim të telekomunikimeve

i. Parashtrësat e palëve

185) Mbrojtja e F.Z. sugjeron se kopjet e shtypura të SMS-ve që janë konfiskuar gjatë bastisjes në C. janë prova të papranueshme, meqë nuk janë marrë me anë të një urdhri të gjykatës për përgjim të telekomunikimeve. Pretendohet se kopjet e shtypura të SMS-ve përmbajnë informata të cilat mbulohen nga e drejta në privatësi dhe se, për këtë arsye, këto informata mund të merren vetëm duke i respektuar dispozitat ligjore të kodit të procedurës që kanë të bëjnë me masat e fshehta dhe teknike. Në kohën kur prokuroria i ka siguruar mesazhet, nuk ka pasur ndonjë masë të tillë të urdhëruar nga gjyqtari kompetent i procedurës paraprake sipas nenit 91 (2) të KPP-së. Marrja e përmbajtjes së SMS-ve nëpërmjet kanaleve të paligjshme i bën informatat e tilla të paligjshme.

186) Edhe mbrojtja e E.L. i kundërshton provat për shkak se kopjet e shtypura të SMS-ve janë marrë në kundërshti me nenin 258 të KPPK-së, përkatësisht nenin 91 të KPP-së dhe nenin 36 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kështu, argumentohet se provat duhet të konsiderohen të papranueshme sipas nenit 246 (1) të KPPK-së, përkatësisht nenit 97 (1) të KPP-së.

187) Prokuroria sugjeron se gjykata duhet të përmbahet nga shpallja e provave si të papranueshme, sepse pretendohet se ato janë marrë pa urdhër të gjykatës. Mënyra se si i pandehuri F.L. i ka marrë këto SMS mbetet e paqartë; as nuk është vërtetuar se këto SMS janë siguruar nëpërmjet kanaleve të paligjshme, siç argumenton mbrojtja. Prokuroria më tutje sugjeron se nuk ka parë asnjë vërtetim se shkresa që i përmban SMS-të ka ndonjë lidhje shkakore me hetimet, rastet apo urdhrat e tjerë për bastisje.

ii. Gjetjet e gjykatës

188) Gjykata vëren se kjo provë nuk mund të trajtohet si transkript i mesazheve që janë marrë si rezultat i përgjimit të telekomunikimit, meqë [përgjimi] nuk është urdhëruar asnjëherë nga prokurori apo gjykata. Kjo shkresë e shtypur është shkresë që është gjetur gjatë bastisjes. Vlera e saj si provë do të vlerësohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur do të verifikohet autenticiteti, besueshmëria dhe besueshmëria e saj.

8. Pranueshmëria e deklaratave të dëshmitarëve nëse nuk jepet paralajmërim sipas nenit 125 të KPP-së

i. Parashtrësit e palëve

189) Mbrojtja e F.L. kërkon nga gjykata që t'i refuzojë si të papranueshme "deklaratat e dëshmitarëve nëse nuk është dhënë paralajmërim sipas nenit 125 të KPP-së".

190) Prokuroria nuk ka paraqitur përgjigje në këtë kundërshtim.

ii. Gjetjet e gjykatës

191) Gjykata nënvijëzon se mbrojtja nuk i ka ofruar detajet e nevojshme dhe specifike për t'ia mundësuar Gjykatës që t'i vlerësojë bazat e këtij kundërshtimi në mënyrë adekuate. Mbrojtja nuk i ka dorëzuar as emrat e dëshmitarëve, as datat e intervistave kur thuhet se është bërë kjo shkelje procedurale. Përkundër kësaj, gjykata i ka analizuar shkresat e lëndës në mënyrë të thukët, për të marrë vendim të duhur për këtë kundërshtim, dhe, pasi e ka bërë këtë, ka përfunduar se të gjithë dëshmitarët janë udhëzuar si duhet për të drejtat dhe obligimet e tyre.

192) Sidoqoftë, mosdhënia e një paralajmërimi juridik dëshmitarit para intervistimit të tij nuk e bën deklaratën të papranueshme sipas KPPK-së, i cili ka qenë ligj i zbatueshëm në kohën kur janë zhvilluar intervistat me dëshmitarë. Sipas nenit 161 (2), në lidhje me nenin 160 (1) dhe (3) të KPP-së, të pranueshme do të jenë vetëm deklaratat e një dëshmitari të privilegjuar që është liruar nga obligimi për të dhënë dëshmi dhe është udhëzuar për të atë të drejtë. Në rastin konkret nuk është intervistuar asnjë dëshmitarë i privilegjuar.

9. Se a nuk është aktakuza në përputhje me kërkesat formale që janë përcaktuar në nenin 241 të KPP-së

i. Parashtrësit e palëve

193) Mbrojtësit e F.Z. dhe D.L. pretendojnë se aktakuza nuk është në përputhje me nenin 241 të KPP-së, sepse nuk i përmban elementet e nevojshme për ta përcaktuar kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale dhe rrethanat e tjera sipas ligjit dhe për të t'i përcaktuar veprat penale saktësisht dhe me precizitet të mjaftueshëm.

194) Prokuroria pretendon se Gjykata (e atëhershme) e Qarkut e Prishtinës tashmë është marrë me çështjen që ka të bëjë me kërkesat formale për aktakuzës dhe ka vendosur për të. Argumentohet se aktakuza është specifike sa i përket paraqitjes së fakteve dhe provave.

ii. Gjetjet e gjykatës

195) Gjykata e refuzon kundërshtimin e mbrojtjes si të papranueshëm. Aktakuza në këtë çështje është ngritur më 16 nëntor të vitit 2012 d.m.th. në kohën kur KPPK-ja ka qenë ende në fuqi. Lënda pastaj i është caktuar një gjyqtari të EULEX-it për konfirmimin e aktakuzës, i cili e ka analizuar aktakuzën sipas nenit 306 (2) të KPPK-së dhe ka kërkuar nga prokurori special që të bëjë ndryshime. Ankesa që e ka ushtruar prokuroria kundër vendimit të gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës është aprovuar, ndërsa Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, me anë të aktvendimit të datës 18 dhjetor 2012, e ka anuluar vendimin e gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës dhe ka konsideruar se aktakuza i plotëson kërkesat formale siç është paraparë me ligj.

196) Duke marrë parasysh këtë historik të procedurës, gjykata është e mendimit se gjykata ka qartësuar çështjen e përmbajtjes formale të Aktakuzës 425/09 në mënyrë bindëse dhe se, për këtë arsye, parimi juridik i *res iudicata* e pengon mbrojtjen që ta ngritë këtë çështje në këtë fazë të procedurës. Kjo gjetje nuk është në kundërshti me aktvendimin e kohëve të fundit të Gjykatës së Apelit në Çështjen PN 372/13, në të cilin konstatohet si vijon:

Edhe pse KPP i ri e ka eliminuar obligimin e qartë [rishikimin e aktakuzës sipas nenit 306 (2) të KPPK-së], nga dispozita e përgjithshme e nenit 442 të KPP-së ende mund të nxirret përfundimi se gjyqtari i procedurës paraprake i ka vlerësuar kuptueshmërinë dhe përputhjen e aktakuzës me kërkesat që janë paraparë në nenin 241 të KPP-së. Ky vlerësim duhet të bëhet para se të caktohet seanca fillestare e dëgjimit.

10. Nëse provat që kanë të bëjnë me të pandehurin G.Z. janë thelbësisht të pambështetshme

i. Parashtrësit e palëve

197) Mbrojtja pretendon se paragrafët e aktakuzës që i përmbajnë akuzat kundër të pandehurit G.Z. janë plotë me prova thelbësisht të pambështetshme që duhet të konsiderohen të papranueshme dhe të hiqen nga lënda sipas nenit 249 (1.3), në lidhje me nenin 259 (2) të KPP-

së. Pretendohet se deklaratat e ndryshme që janë përfshirë në aktakuzë janë vetëm përfundime që janë bazuar vetëm në supozime, e jo në fakte të vërejtura. Veç kësaj, mbrojtja pretendon se prokuroria ka dështuar plotësisht që t'i saktësojë në hollësi provat dhe informatat në të cilat është mbështetur.

198) Prokuroria përgjigjet duke pretenduar se çështja nëse provat janë thelbësisht të pambështetshme ndërlidhet me çështjen nëse provat janë relevante apo jo. Provat në fjalë përfshijnë shkresa dhe dëshmi që lidhen drejtpërsëdrejti me sjelljen e pretenduar kriminale të të pandehurit G.Z. dhe që e vërtetojnë qartë dyshimin e bazuar mirë. Mbetet të vërtetohet gjatë shqyrtimit gjyqësor se a janë provat mjaft të besueshme për ta vërtetuar kryerjen e veprave tej dyshimit të bazuar apo jo.

ii. Gjetjet e gjykatës

199) Gjykata konstaton se pretendimi i prokurorisë se çështja e pabesueshmërisë së provave ndërlidhet me relevancën e provave është i gabuar. Neni 259 i KPK-së i dallon qartë provat "qartazi të parëndësishme" nga provat "thelbësisht të pambështetshme". Provat janë qartazi të parëndësishme nëse thjesht nuk janë relevante për t'i provuar elementet e veprës penale, ndërsa për të qenë thelbësisht të pambështetshme origjina e provave apo informatave duhet të mos dihet, ato duhet të jenë të bazuara në thashetheme apo, në dukje të parë, provat apo informatat duhet të jenë të pamundshme apo të pabesueshme (neni 19 (1.29) i KPK-së).

200) Në anën tjetër, kundërshtimi i paraqitur nga mbrojtja është i pabazuar edhe për arsye se provat që i ka shpalosur prokuroria për t'i demonstruar akuzat kundër të pandehurit G.Z. thjesht nuk hyjnë në njërin nga tri kategoritë që janë përkufizuar në nenin 19 (1.12) të KPK-së. KPK-ja përmban një prag mjaft të lartë për t'i konsideruar provat si "thelbësisht të pambështetshme". Prokurori përpiqet ta provojë kryerjen e krimeve të saktësuara në aktakuzë përmes deklaratave që zyrtarët e policisë që kanë marrë pjesë në bastisjen e ndërtesës së Kuvendit të Kosovës më 28 prill të vitit 2010 i kanë dhënë në cilësinë e dëshmitarëve dhe që pritet të japin dëshmi për faktet që i kanë vërejtur gjatë këtij aksioni.

11. Nëse mendimi i ekspertit për testimin e cilësisë së rrugës është i pranueshëm, sepse është thelbësisht i pambështetshëm

i. Parashtrësit e palëve

201) Mbrojtja e F.Z. pretendon se gjetjet në mendimin e ekspertit se rruga Ponesh-Zhegoc nuk është ndërtuar si duhet, është provë thelbësisht e pambështetshme dhe se, si e tillë, duhet të konsiderohet e papranueshme dhe të hiqet nga shkresat e lëndës sipas nenit 249 (1.3), (4), në lidhje me nenin 259 (2) të KPP-së. Pretendohet se eksperti e ka kryer analizën e tij pa i pasur shkresat e lëndës dhe specifikimet teknike.

202) Prokuroria përgjigjet duke thënë se ekspertëve u janë ofruar informatat dhe specifikacionet teknike të nevojshme. Prokuroria po ashtu nënvijëzon se eksperti ka njohuri të mëdha për ndërtimin e rrugëve dhe se gjetjet e tij mund të barten lehtësisht në kontekstin e Kosovës.

ii. Gjetjet e gjykatës

203) Gjykata konstaton se mendimi i ekspertit për cilësinë e rrugës është provë e pranueshme, e cila duhet të vlerësohet gjatë shqyrtimit gjyqësor. Provat janë thelbësisht të pambështetshme nëse nuk dihet origjina e provave apo informatave, nëse janë të bazuara në thashetheme apo nëse, në dukje të parë, provat apo informatat janë të pamundshme apo të pabesueshme (neni 19 (1.29) i KPP-së). Sipas mendimit të gjykatës, asnjë nga këto kushte nuk është plotësuar.

IV. Shqyrtimi sipas detyrës zyrtare nga gjyqtari i procedurës paraprake

i. Vërejtje të përgjithshme

204) Siç është përmendur tashmë më herët, në kundërshti me kornizën ligjore që e ka qeverisur konfirmimin e procedurës së aktakuzës sipas KPPK-së, sipas KPP-së, gjykata nuk ka të drejtë më që ta vlerësojë plotësisht pranueshmërinë e provave sipas detyrës zyrtare. Kundërshtimet ndaj provave duhet të parashtrihen nga mbrojtësi sipas neneve 249 të KPP-së, për t'ia mundësuar gjykatës që ta bëjë një vlerësim përkatës. Kompetenca e vetme e mbetur e gjykatës për shqyrtim sipas detyrës zyrtare është ajo që është paraparë me nenin 249 (5) "*për të përcaktuar nëse pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Kosovës*". Ngjashëm, me nenin 97 (4) i KPP-së parashihet – si dispozitë *lex specialis* – se:

“Në çdo kohë para se aktgjykimi të merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sipas detyrës zyrtare mund të shqyrtojë pranueshmërinë e materialeve të mbledhura nga neni 88 i këtij Kodi për shkelje të të drejtave kushtetuese të të pandehurit nëse ka indikacione se materialet janë mbledhur në mënyrë të kundërligjshme.”

205) Në një vendim të kohëve të fundit, Gjykata e Apelit e ka konsideruar fushëveprimin e kësaj kompetence sipas detyrës zyrtare si vijon:

Gjykatës ende i është dhënë një kompetencë shumë e gjerë, sepse pranimi i provave të marra përmes masave hetimore të paligjshme zakonisht i shkelë të drejtat kushtetuese të të pandehurit (p.sh. neni 36 në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në rast të ndonjë bastisjeje të paligjshme të ndonjë shtëpie apo përgjimi të paligjshëm të telekomunikimit).

206) Pasi i ka rishikuar shkresat e lëndës në mënyrë të thukët, gjykata konsideron se është e domosdoshme që provat që janë marrë nga Qendra/Njësia e Inteligjencës Financiare të shqyrtohen sipas detyrës zyrtare, meqë në to raportohen transferet financiare midis të pandehurve dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre. Gjykata vëren se mbrojtja e çështjeve financiare të dikujt nga deklarimi i detyrueshëm publik është aspekt që hyn në zonën e privatësisë, e cila mbrohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

ii. Historik i fakteve

207) Më 15 gusht të vitit 2011, prokuroria ia ka paraqitur një kërkesë³¹ Drejtorit të Qendrës/Njesisë së Inteligjencës Financiare (NjIF-së)³², me të cilën janë kërkuar informata për llogarinë bankare, përshirë një analizë të aktiviteteve në xhirollogari, transferet e parave të huaja dhe transaksionet përmes dërguesve të parave për llogaritë bankare që janë mbajtur nga familja L. dhe familja Krasniqi. Në kërkesë nuk janë cekur arsyet për dyshim për shpëlarje të mundshme të parave, por vetëm është përmendur “natyra e krimeve” që të pandehurit dyshohej se i kishin kryer.

³¹ Dosja 6, f. 225.

³² Qendra e Inteligjencës Financiare e Kosovës (QIF) e ka përfunduar periudhën e kalimit në Njësinë e sapokrijuar të Inteligjencës Financiare të Republikës së Kosovës (NjIF).

208) NjIF-ja, si institucion qendror kombëtar i pavarur përgjegjës për t'i kërkuar, analizuar dhe shpërndarë tek organet kompetente informatat e shpalosura që kanë të bëjnë me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, ia ka ofruar prokurorisë tri raporte që mbajnë datat 21 qershor 2011³³, 30 janar³⁴ dhe 29 mars 2012³⁵. Raporti i datës 21 qershor 2011, i cili është shpalosur nga NjIF-ja “për veprime të mëtejme sipas nevojës” përmban informata të hollësishme për të dhënat financiare për të pandehurit F.L. dhe D.L., në të cilat prokuroria e mbështetet aktakuzën kur kemi të bëjmë me akuzat për shpëlarje të parave dhe mosdeklarim të parave të pranuar për fushatë.³⁶ Të dyja raportet përmenden edhe në listën e provave të rekomanduara në Aktakuzë.

209) Më 20 prill të vitit 2012, prokuroria ka parashtruar një kërkesë³⁷ për masa të fshehta për shpalosjen e të dhënave financiare, të cilën Gjykata e Qarkut e ka aprovuar me anë të urdhrit³⁸ të datës 30 Korrik 2012. Në kërkesën e saj, prokuroria është mbështetur në informatat që janë ofruar nga NjIF-ja. Informatat që janë marrë pas ekzekutimit të urdhrave të gjykatës të datës 30 korrik 2012 kanë qenë më pak përmbajtjesore se ato që janë marrë nga raportet e NjIF-së.

iii. Gjetjet e gjykatës

210) Detyrat dhe kompetencat e NjIF-së qeverisen nga *Ligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit* (Ligji 03/L-196). Neni 15 i këtij ligji e rregullon shpalosjen dhe shpërndarjen e informatave dhe shënimeve nga NjIF tek organet dhe institucionet e tjera brenda dhe jashtë Kosovës:

” NjIF-K-i mund të bëjë publik vetëm informacionin ose dokumentet zyrtare që përmbajnë këtë informacion, në pajtueshmëri me paragrafin 2. të këtij neni si më poshtë:

(1.1.) çdo të dhënë rreth personit ose subjektit i cili është lënda e një raporti të mbajtur nga NjIFK-ja që mund ta identifikojë personin ose subjektin në mënyrë direkte ose indirekte, duke përfshirë por jo edhe duke kufizuar në një emër ose adresë;

³³ Dosja 6, faqe 211; gjyqtari i procedurës paraprake supozon se data kur është lëshuar rapirit i NjIF-së nuk është 21 qershor 2011, siç është përmendur në shkresë, por 21 shtator 2011, sepse ky raport i referohet kërkesës së PSRK-së të datës 15 gusht 2011. Krahas kësaj, fakti se PSRK-ja e ka marrë këtë raport më 20 shtator të vitit 2011, siç mund të shihet nga vula e PSRK-së në shkresë, shkon në favor të datës 21 shtator 2011 si datë e vërtetë e lëshimit.

³⁴ Dosja 6, faqe 229.

³⁵ Dosja 6, faqe 233.

³⁶ Shih paragrafët 127 e më tej dhe paragrafët 154 e më tej të aktakuzës së ndryshuar.

³⁷ Dosja 5, faqet 175 dhe 255.

³⁸ Dosja 5, faqe 266.

(1.2.) çdo të dhënë identifikuese në lidhje me një transaksion, duke përfshirë por jo edhe kufizuar datën, vendndodhjen, vlerën ose llojin e pronës, numrin e llogarisë ose numrin e transaksionit; dhe

(1.3.) çdo të dhënë rreth një personi ose subjekti i cili i ka ofruar NJIF-K-së informacion ose dokument zyrtar që do ta identifikonte në mënyrë direkte ose indirekte personin ose subjektin.

(2) Informacioni i referuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të bëhet publik nga NJIF-K-ja në bazë të rrethanave të mëposhtme për:

(2.1.) njësinë përkatëse të policisë, Njësinë për Hetime Financiare, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, Prokurorin kompetent, Doganat e Kosovës, Departamentin e Administratës Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ose KFOR-in, nëse informacioni do të ishte relevant për hetimet në kuadër të kompetencës së saj ose për ndonjë organ jashtë Kosovës me funksione të ngjashme të NJIF-K-së;

(2.2.) një organ publik ose qeveritar të Republikës së Kosovës nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente NJIF-K-së;

(2.3.) organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe që kryejnë funksion të ngjashëm me NJIF-K-në, jashtë Kosovës, nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente ose do t'i ndihmonte NJIF-K-së që të kryejë funksionet e saj;

(3) Të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentet zyrtare bëhen publike nga NJIF-K-ja vetëm për qëllime inteligjence, me qëllim të ofrimit të bazës për hetime. Ato nuk mund të përdoren si prova përpara një gjyqi, përveç nëse miratohen me shkrim nga Drejtori, i cili autorizon një publikim të tillë vetëm atëherë kur nuk ka mundësi të tjera për organet zbatuese të ligjit që të marrin fakte (prova) përkatëse diku tjetër dhe/ose në mënyrë tjetër.”

211) Në rastin në fjalë, raportet që janë përgatitur nga Njif i janë shpalosur prokurorisë sipas nenit 15

(2.1). Nga neni 15 (3) i ligjit të lartpërmendur, është e qartë se shpalosja e informatave kufizohet vetëm me qëllimet e inteligjencës dhe mund të përdoret vetëm si bazë themelore për hetim.

Përdorimi i informatave të shpalosura në procedurë gjyqësore varet nga aprovimi paraprak i drejtorit të NjIF-së.

212) Raportet që janë shpalosur nga NjIF-ja dhe që gjenden në shkresat e lëndës janë shënjuar qartë si rreptësishtë konfidenciale, sa bashku me udhëzimin me shkrim në vijim, i cili është dhënë faqen e parë:

“Të dhënat që janë shqyrtuar në këtë shkresë duhet të përdoren vetëm për qëllime të inteligjencës dhe nuk duhet t’i shpërndahen apo shpalosen, tërësisht apo pjesërisht, asnjë personi, agjencie apo organizate, apo të përdoren në çfarëdo procedure gjyqësore apo administrative, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Qendrës së Inteligjencës Financiare.”

213) Gjykata është e mendimit se Drejtori i NjF-së nuk ka dhënë kurrfarë pëlqimi me shkrim në rastin konkret, meqë ai nuk gjendet në shkresat e lëndës që janë marrë nga prokurori. Nuk ka as ndonjë kërkesë me shkrim nga prokurori për ta marrë një pëlqim të tillë.

214) Ndonjë aprovim me shkrim për shfrytëzimin e këtyre raporteve si prova në gjykatë nuk mund të nxirret nga deklarata në paragrafin e parë të raporteve, ku është shkruar: “[n]ë pajtim me Ligjin Nr. 03/L-196, ne po e shpalosim këtë raport për veprime të mëtejme sipas nevojës”. Sipas mendimit të gjykatës, aprovimi me shkrim i Drejtorit të NjIF-së duhet të jetë i detajuar dhe i orientuar. Në të duhet të përmendet jo vetëm procedura hetimore e veçantë, por të saktësohen në hollësi provat që janë aprovuar për përdorim në gjykatë. Krahas kësaj, në këtë aprovim duhet të tregohet pse prokurori konsideron se është plotësuar elementi plotësues, përkatësisht pse organet e rendit nuk kanë mundësi të tjera për të marrë prova relevante gjetiu dhe/ose në ndonjë mënyrë tjetër. Një aprovim i përgjithshëm si ky që është përfshirë në raportet e pranishme nuk i plotëson këto kushte dhe bie ndesh me objektin dhe qëllimin e nenit 15 (3), i cili është që të themelohet një mekanizëm mbrojtës kundër anashkalimit të kushteve ligjore të rrepta për masat hetimore që janë paraparë në KPP. Për më tepër, as provat që prokuroria i ka përdorur në këtë rast nuk mund të konsiderohen të pranueshme – për shkak të mundësisë hipotetike të aprovimit me shkrim nga NjIF – as përdorimi i provave para gjykatës nuk mund të aprovohet në mënyrë retroaktive.

215) Pasi i ka marrë në konsideratë ato që u thanë më lart, gjykata konstaton se raportet e NjIF-së të datës the 21 qershor 2011, 30 janar dhe 29 maj 2012 janë prova të papranueshme, sepse

drejtori i NjIF-së nuk ka dhënë aprovim me shkrim, siç kërkohet me nenin 15 (3) të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit.

Përmbledhje

216) Provat në vijim janë të papranueshme dhe do të hiqen nga shkresat e lëndës dhe të mbyllen:

- provat që janë marrë gjatë bastisjes së shtëpisë në C. që është bërë më 28 prill të vitit 2010;
- provat që janë marrë gjatë bastisjes në dhomën e serverit të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës më 28 prill 2010,
- deklarata e të pandehurit F.L.
- deklaratat e dëshmitarëve: B.P., mbajtur më 8 nëntor 2011³⁹, R.E., mbajtur më 9 nëntor 2011⁴⁰, V.O., mbajtur më 3 prill 2012⁴¹ dhe A.I., mbajtur më 11th nëntor 2011⁴²,
- deklaratat e M.S. (dhe transkriptet e tyre) dhënë Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit (AKK-së),
- provat e marra nga Qendra/Njësia e Inteligjencës Financiare (raportet e datave 21 qershor 2011, 30 janar dhe 29 mars 2012).

V. Kërkesat për hedhje të aktakuzës

1. Standardi i zbatueshëm i shqyrtimit

217) Propozimi për ta hedhur Aktakuzën është paraparë me nenin 250 të KPP-së, i cili ia mundëson të pandehurit që ta kërkojë hedhjen e saj, nëse nuk ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur një dyshim të bazuar mirë se ai e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

³⁹ Dosja 19b, faqet 256 – 263.

⁴⁰ Dosja 19b, faqet 274 – 278.

⁴¹ Dosja 19b, faqet 382 – 402.

⁴² Dosja 19b, faqet 285 – 295.

218) Sa u përket kërkesave për ta hedhur Aktakuzën, KPP-ja parasheh kritere të qarta që duhet të merren në konsideratë. Në nenin 250 (1) thuhet si vijon:

Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:

1.1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;

1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;

1.3. afati i parashkrimit kishte kaluar, falja e mbulon veprën, ose ka rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen penale; ose

1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

219) Në pajtim me Nenin 253 (1) të KPK:

Për çdo kërkesë për hudhjen poshtë të aktakuzës nga Neni 250 i këtij Kodi, Gjyqtari i vetëm gjykues ose Kryetari i Trupit Gjykues merr aktvendim për hudhjen poshtë të aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se:

1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;

2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;

3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnesti apo falje;

4. ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose

5. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

220) Dyshimi i bazuar mirë është i përcaktuar në Nenin 19 (12.2) KPK dhe nënkupton posedimin e provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri. “Vëzhgues objektiv” në mënyrë standarde kërkon prova të cilat e bindin shumicën e njerëzve se krimi ishte kryer nga i pandehuri. Për të përcaktuar nëse duhet të hudhet aktakuza, Gjykata i merr parasysht vetëm provat të cilat janë të pranueshme.

- 221) Neni 241 i KPK kërkon që aktakuza të e përcaktojë veprën penale të pretenduar me saktësi duke e cekur kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat të tjera të nevojshme; Sipas Nenit 1 (3) të KPK-së përcaktimet e krimit duhet të interpretohen në mënyrë rigoroze, nuk lejohet me analogji, dhe në qoftë se ekziston ndonjë dykuptimësi, përcaktimi i krimit do të interpretohet në favor të personit i cili është duke u ndjekur penalisht.
- 222) Avokatët Mbrojtës të të Pandehurve kanë parashtruar kërkesa për hudhjen poshtë të aktakuzës mbi bazën e përcaktuar në Nenin 250 (1.4) të KPK që është mungesa e provave të mjaftueshme për të e mbështetur dyshimin e bazuar mirë që klientët e tyre i kishin kryer veprat penale për të cilat ata akuzohen.
- 223) Prokurori u përgjigj me shkrim ndaj kërkesave të Mbrojtjes për hudhjen poshtë të aktakuzës. Ai i qëndroi mendimit të tij se çdo akuzë kundër të të pandehurve është e mbështetur me prova të mjaftueshme të dyshimeve të bazuara se ata i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.
- 224) Gjithashtu duhet të theksohet se në vazhden e procedurës penale kundër të të pandehurve, kodi penal ishte subjekt i ndryshimeve themelore. Në pajtim me Nenin 3 (1) të Kodit Penal, Ligji 04/L-082 i vitit 2012 (i cili hyri në fuqi më 1 Janar 2013), ndaj kryerësit do të zbatohet ligji i cili ishte në fuqi në kohën kur ishte kryer vepra penale. Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm, që është paraparë në paragrafin 2 të dispozitës së cekur. Prandaj, në rast të çdo akuze, Gjykata i krahasoi dispozitat e duhura të Kodeve Penale të mëparshme dhe të tanishme për të përcaktuar se cili ligj është më i favorshëm për të pandehurit.

2. Pika 1 ndaj F.L., Fl.L. D.L., E.L. dhe N.K.

- 225) F.L., Fl.L. D.L., E.L. dhe N.K. janë të akuzuar me veprën penale të krimit të organizuar në kundërshtim me Nenin 274, paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) si të lexuar me paragrafin 1 të KPK-së dhe të dënueshme me gjobë deri në shumë të 5000.000 Euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vite, të lexuar bashkërisht me Nenin 23 të KPK.

- 226) Ashtu sikur që Prokurori e pohoi se që nga viti 2008 e deri në vitin 2010, dhe sa i përket pastrimit të parave deri në vitin 2012 në Kosovë, të pandehurit vepruan si anëtarë të një grupi të organizuar kriminal të cilët kryen krime të rënda si të specifikuara (përvetësim në detyrë, lidhje të kontratës së dëmshme, keqpërdorim i detyrës zyrtare, marrje të ryshfetit, pastrim i parave). Qëllimi i grupit ishte për të dhënë ndërtim rrugor fitimprurës, përkatësisht tenderë të rregullimit të rrugës tek kompanitë e ndërtimit rrugor të cilët premtuan pagesën e ryshfetit përkatës në shumë të 20% deri në vlerën totale të kontratave. Grupi kriminal kishte pretenduar të jetë i strukturuar dhe pjesëtarët e tij vepruan në bashkëpunim për një periudhë të konsiderueshme kohore. Pjesëtarët kishin lidhje familjare ose lidhje miqësore me F.L. i cili ishte udhëheqës i grupit.
- 227) Ashtu sikur që është cekë në Aktakuzë, D.L. i ndihmoi F.L. duke e bërë pastrimin e parave të ryshfetit pasi që ai i dha kreditë e tij personale në shumë të së paku 50.000 Eurove dhe bëri pagesa të konsiderueshme për shpenzimet ligjore të F.L. që tejkalojnë shumën e 400.000 Euro.
- 228) F.L. e bënte pastrimin e parave të ryshfetit për F.L. duke lëshuar depozitime në para të gatshme për trajtimin mjekësor të bashkëshortes së ndjerë të F.L. në vitet 2009 dhe 2010 në shumë të së paku 15.779, 31 Euro.

i. Ligji në fuqi

- 229) Neni 274, paragrafët 1 dhe 3 të KPK (të zbatuar nga Prokurori në Aktakuzë) përcaktojnë si në vijim:

(1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet.

(3) Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobën deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

Përkufizimet e detyrueshme ligjore janë të përfshira në paragrafin 7 të këtij Neni që cekë si në vijim:

1) Shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare;

2) Shprehja “grup kriminal i organizuar” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë pasurore apo financiare;

3) Shprehja “krim i rëndë” do të thotë veprë penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet;

4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë veprë penale dhe nuk do të thotë formalisht t’i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

230) Vepra penale e krimit të organizuar nënkupton kryerjen e një veprë “themelore” për t’u përfunduar, përpos veprës së krimit të organizuar sipas Nenit 274 të KPK. Formulimi i përdorur në tërë Nenin 274 të KPK qartazi e përcakton se kryerja e një veprë themelore është një element konstituiv i kësaj veprë. Në të kundërtën, një individ mund të shpallet fajtor për të njëjtin veprim, që është pjesë përbërëse e që të dy veprave penale, të krimit të organizuar dhe të veprës themelore⁴³.

231) Lidhur me veprën penale të krimit të organizuar, Kodi i ri Penal nuk është më i favorshëm për të Pandehurit sesa Kodi i Procedurës Penale. Kështu që, në përputhje me parimin e përcaktuar në Nenin 3 (1) të KP do të zbatohet ligji i cili ka qenë në fuqi kur ishte kryer vepra penale.

ii. Konstatimet e Gjykatës

232) Nuk ka prova të mjaftueshme për dyshim të bazuar se D.L. dhe F.L. e kishin kryer veprën penale të krimit të organizuar për të cilat janë akuzuar.

233) Para së gjithash, Gjykata është e pajtimit me Mbrojtjen se vetë fakti që D.L. dhe F.L. janë vëllezërit e të pandehurit F.L. nuk mjafton për të ardhur në përfundim se ata janë pjesëtarë të grupit të pretenduar të organizuar të udhëhequr nga ai. Për të i vlerësuar me të drejtë raportet ndërmjet këtyre tre të të pandehurve është e nevojshme që të merren parasysh tiparet e shoqërisë Kosovare bazuar mbi lidhjet familjare, ku mbështetja ndërmjet anëtarëve të familjes

⁴³ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 61/2012, Aktgjykimi i datës 2 Tetor 2012.

është njëra prej parimeve më të rëndësishme. Për këto arsye, është vështirë për të e gjetur elementin penal në mbështetjen financiare të F.L. nga ana e D.L. për trajtimin e bashkëshortes së tij të ndjerë përderisa ajo ishte duke qëndruar në spital në Vjenë. Për më tepër, fakti që F.L. kishte paguar për mbrojtjen e F.L. kur rasti i tij ishte gjykuar në Gjykatën Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë në Hagë nuk e ngrit çështjen e dyshimeve se ishte vetëm një veprim i zakonshëm i vëllezërve në shoqërinë Shqiptare në Kosovë.

234) Pavarësisht nga këto raporte familjare ndërmjet F.L., D.L. dhe F.L. duhet të theksohet se parakushti për të deklaruar se vepra e krimit të organizuar ekziston është kryerje e krimit themelor. Ashtu sikur që do të paraqitet në pjesën e mëtejme të arsyetimit nuk ka dyshime të bazuara se F.L. dhe Durim Lima e kanë kryer veprën e dytë penale me të cilën ata akuzohen që është pastrimi parave. Kjo gjendje e mbështet në mënyrë plotësuese vendimin e Gjykatës për hudhjen poshtë të akuzës së pjesëmarrjes të F.L. dhe Durim Lima në krim të organizuar dhe për ndërprerjen e procedurës kundër tyre.

235) Lidhur me F.L., N.K. dhe E.L., Gjykata e konsideron të domosdoshme që të shqyrtojë gjatë shqyrtimit gjyqësor nëse ata e kishin kryer veprën penale të krimit të organizuar. Shqyrtimi i provave të mbledhura nga ana e Prokurorit gjatë hetimit e arsyetojnë ekzistimin e dyshimit të bazuar për këtë akuzë kundër të të pandehurve. Ky përfundim i Gjykatës është i mbështetur me prova të pranueshme të paraqitura nga Prokurori, siç është deklarata e M.S. mbështetur nga përgjimi i thirrjeve telefonike dhe matja dhe shqyrtimi i gjësendeve të marra gjatë bastisjes së kryer në objektet që i përkasin të të pandehurve dhe zyrave të tyre, dokumentet e MTPT –së nga procedura e prokurimit. Përveç kësaj, ekspertët ndërkombëtar të ligjit të prokurimit gjetën shumë shkelje të *Ligjit mbi Prokurimin Publik* në procedurën e tenderimit të bërë nga ana e MTPT-së. Ata vlerësuan se numri dhe karakteristika e shkeljeve mund të shpie tek përfundimi se procedurat ishin shkelur me dashje. Shqyrtimi i deklaratave të M.S. në lidhje me përmbajtjen e porosive të dërguara nga të Pandehurit tek njëri-tjetri dhe natyra e raportit të tyre e mbështet dyshimin e bazuar se ata e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

3. Pika 2 kundër F.L. dhe N.K.

236) F.L. dhe N.K. janë të akuzuar për kryerjen e veprës së përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës në kundërshtim me Nenin 340, paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së dhe e dënueshme me burgim prej një deri në dhjetë vite, të lexuar së bashku me Nenin 23 të KPK-së.

237) Prokurori pohon se në vitet 2008 dhe 2010 në Kosovë, F.L. dhe N.K. në detyrat e tyre zyrtare si Ministër i MTPT-së dhe Shef i Prokurimit të MTPT-së administruan shfrytëzimin e buxhetit të MTPT-së. Duke pasur parasysh se F.L. e mbante përgjegjësinë kryesore të buxhetit, N.K. e bëri të mundur shfrytëzimin e buxhetit të caktuar duke i nënshkruar kontratat ligjërisht të detyrueshme me kompanitë *T.* dhe *M.* për tenderët me udhëzimin e F.L.. Realizimi i kontratave krijoi kërkesa ligjërisht të detyrueshme civile kundër buxhetit të MTPT-së dhe shpiu tek ekzekutimi i kërkesave dhe pagesave të Ministrisë së Financave.

238) Më tej, Prokurori pohon se të pandehurit e përvetësuan buxhetin financiar të MTPT-së gjatë kryerjes së detyrave të tyre, që në mënyrë të pandërgjegjshme e zbatuan buxhetin në shfrytëzimin e tyre për nevojat personale duke i zgjedhur tenderët *T.* dhe *M. Kompani*, me një proces të përzgjedhur dhe të manipuluar në shkëmbim të parave të rryshfetit. Ata morën para të përfituara-ryshfet-del se diku në shumë të së paku 250.000 Eurove dhe si të tilla e tejkaluan shumën e 5.000.000 Eurove, limit i paraparë me Nenin 340, paragrafin 3 të KPK-së.

i. Ligji në fuqi

239) Dispozitat e Nenit 340 të KPK-së të zbatuara në Aktakuzë nga Prokurori, cekin si në vijim:

(1) Personi zyrtar që përvetëson para, letra me vlerë ose pasuri tjetër të luajtshme që i është besuar personit në bazë të detyrës së tij ose pozitës brenda një organi publik ose personi juridik me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 EUR, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

240) “Për të përvetësuar” ka kuptim për të marrë në posedim ose në përdorim në mënyrë ekskluzive për veten, shpesh pa autorizim. Prona i është besuar dikujt në qoftë se i është dhënë në përkujdesje, mbrojtje, ose kryerje.

241) Për të i vlerësuar plotësisht bazat e akuzës është e domosdoshme që të bëhet referimi në fushëveprimin e detyrave dhe kompetencave të të pandehurve si Ministër i Transportit dhe Telekomunikacionit (F.L.) dhe të Shefit të Prokurimit (N.K.) në lidhje me buxhetin.

242) Detyra e ministrave është e përcaktuar në tërësi në Kushtetutën e Republikës të Kosovës, me Rregulloren Nr. 2011/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (që ka qenë në fuqi deri në muajin Tetor 2010) dhe në Ligjin Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (hyrë në fuqi nga muaji Tetor 2010).

243) Sipas nenit 1.3 të Rregullores mbi Degën e Ekzekutimit të Institucioneve të Përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë secili ministër, në pajtim me politikën e përcaktuar nga Qeveria:

- a) Udhëheq dhe përfaqëson ministrinë;
- b) I përgjigjet Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me ministrinë e tij apo të saj;
- c) Përcakton orientimin politik të punës së ministrisë;
- d) Nxjerr vendime dhe udhëzime administrative në mënyrë që t'i rregullojë aktivitetet e ministrisë në përgjithësi ose në fushat e veanta të ministrisë;
- e) Kryen detyra të tjera në suaza të kornizës së përgjegjësive të ministrisë të përcaktuara me ligj dhe
- f) I raporton Kuvendit në pënyrë periodike, dhe me kërkesë të Kuvendit, raporton për aktivitetet e Ministrisë, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha fondeve të pranuar.

244) Siç është paraparë me nenin 1.7 të Rregullores, gjatë kryerjes së përgjegjësive dhe funksioneve të tyre, Ministrat do të kujdesen se Ministrinë e tyre përkatëse: të formulojnë qartë prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare që i vehen në dispozicion nga buxheti për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe burimet tjera;

245) Posti i Ministrisë të Transportit dhe Telekomunikacionit tutje ishte rregulluar në Shtojcën VIII të Rregullores , dhe dispozita e tij (ix) përcakton se ai do të :

(ix) Në sektorin e infrastrukturës rrugore zhvillon programe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike, siguron financimin dhe organizon dhënien e koncesioneve sipas nevojës; mbikëqyr financimin dhe menagjimin e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë edhe kryerjen e punëve teknike, organizative dhe zhvillimore përkitazi me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike, kontrollojnë gjendjen e rrugëve, si dhe mirëmban dokumentacionin për rrugët publike dhe trafikun rrugor;

246) Ligji më domethënës në Kosovë duke ndikuar në kontrollin publik të brendshëm financiar është Ligji mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive (Ligji Nr. 03/L—048). Ky ligj mbulon marrëveshjet për zhvillim të buxhetit dhe proceseve të miratimit të tij, duke përfshirë proceset

parlamentare, sikurse edhe marrëveshjet për transfere dhe për për prezentimin e të ardhurave për Buxhetin. Ligji poashtu, përkufizon “ paratë publike), organizimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe caktimin e zyrtarëve kryesorë, kapiT.t dhe shpenzimeve të operimit, menagjimit financiar, përgjegjësive, dhe llogaridhënien e buxhetit, prezentimin e sistemeve financiare për autoritetet publike dhe ndërmarjet në Kosovë; përshkruan funksionet dhe detyrat e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe autoriteteve të tjera publike që merren me këto çështje.

247) Ligji sipas nenit 1.1 përkufizon “ organizatë buxhetore” do të thotë një autoritet ose ndërmarrje publike e cila drejtpërdrejtë pranon një ndarje buxhetore sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, ndarje buxhetore kjo që nuk është pjesë e një ndarje tjetër të përgjithshme buxhetore e cila i është bërë një autoriteti ose ndërmarrje tjetër publike. Poashtu përshkruan strukturën administrative që organizatat buxhetore të të gjitha llojeve duhet të themelojnë që të sigurojnë rregullimin e menagjimit financiar. Kjo strukturë përfshin Zyrtarin Kryesor Ekzekutiv (i cili është zyrtar kryesues), një auditor të brendshëm, një Zyrtar Kryesor Financiar, oficerin e prokurimit, dhe zyrtarin Çertifikues. Ligji, poashtu specifikon marrëveshjet për pranimin e kostos së shpenzimeve të parave publike për xhirollogaritë brenda Fodnit të Kosoliduar të Kosovës. Pjesa VIII e këtij Ligji paraqet kushtet për raportimin, llogaritjen, kontrollin e auditimit financiar, përfshirë një kërkesë për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që të përgatisë një sistem të klasifikimit të buxhetit dhe një skemë të llogarive duke i aplikuar standardet e dala nga Federata Ndërkombtare e Kontabilistëve-FNK.

248) 10.1. Posti i zyrtarit kryesor administrativ rregullhet me nenin 10 i cili përkufizon:

10.1 Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesor ligjore për të siguruar që organizata buxhetore (.....) dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë si dhe të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji dhe rregullat e KMF.

10.2 Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër të tjera është shprehimisht përgjegjës për:

a) Vendosjen e kontrolit të brendshëm në organizatën buxhetore, agjencinë autonome ekskluzive ose ndërmarjen publike sipas Rregullave të KMF;

- b) *Delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike në pajtim me Rregullat e KMF;*
- c) *Vendosjen e një kornize për vlerësim dhe menagjimin e performancës së personeli të organizatës buxhetore të cilave u janë deleguar funksionet e tilla;*
- d) *Vendosjen dhe zbatimin e masave të brendshme disiplinore për tu zbatuar në raste kur personeli nuk i ushtron funksionet e deleguara në mënyrë adekuate apo të rregullt; dhe*
- e) *Njoftimin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjitha rastet ku me arsye dyshohet se ka pasur shkelje – nga një person ose ndërmarrje – të këtij ligji, Rregullave KMF ose ndonjë ligji tjetër.*

249) Siç është paraparë me neinn 12 (1) të Ligjit secila organizatë buxhetore do të ketë Zyrtarin Kryesor Financiar. Detyrat dhe kompetencat e tij më tutje shvillohen në paragrafët 4 dhe 5 të rastit në fjale) i cili lexohet si në vijim:

.4. Çdo ZKF është përgjegjës për veprimtarinë e rregullt dhe të ligjshme financiare të organizatës buxhetore përkatëse, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike.

5. Për organizatën buxhetore ose agjencinë autonome ekzekutive, ZKF është i autorizuar dhe përgjegjës për:

(i) përgatitjen e propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore të organizatës përkatëse buxhetore apo agjencisë autonome ekzekutive;

(ii) të sigurojë që të gjitha transaksionet të regjistrohen në Regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit;

(iii) të sigurojë që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga organizata buxhetore të dorëzohen menjëherë për pagim përmes sistemit të thesarit; (

iv) mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve të raportimit buxhetor nga ana e organizatës buxhetore; dhe

(v) ushtrimin e të gjitha funksioneve që i janë dhënë ZKF-së sipas Rregullave KMF. Të gjitha detyrat e ZKF-së duhet të jenë në përputhje të plotë me Rregullat KMF.

250) Në përputhje me nenin 13.1 çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarje publike duhet të kenë Zyrtarin e Prokurimit, i cili do të jetë përgjegjës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit të organizatës buxhetore në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik.

251) Siç rezulton nga neni 34.1 Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore do të informojë Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit të;

i) për çdo kontratë të lidhur nga organizate buxhetore dhe për çfarëdo ndryshimi të ndonjë kontrate aktuale, nëse kontrata e tillë e obligon organizatë buxhetore që të bëjë pagesa gjatë vitit fiskal aktual apo gjatë viteve të ardhshme fiskale, dhe

(ii) për të gjitha obligimet jashtë-kontraktuese për pagesë të organizatës buxhetore sipas paragrafit 3 të këtij neni.

252) Rregullat e pagesës përshkruhen në nenin 38 dhe 39 të ligjit:

38.1 Nuk do të lejohen kurrfarë mjetes nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për bërjen e pagesave kur nuk ekziston një njoftim aktual për alokimin e fondeve me anë të të cilit autorizohet përdorimi i të hollave për bërjen e pagesave të tilla.

38.2 Procesi i cili do të ndiqet për bërjen e pagesave të autorizuara nga njoftimi për alokimin e fondeve, do të vendoset nga Rregullat KMF.

39.1 ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

39.2 Kur një person ka lëshuar një faturë ose kërkesë për pagim për një organizatë buxhetore dhe shuma në fjalë nuk është paguar për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë, personi në fjalë mundet ta dorëzojë një kopje të faturës ose kërkesës për pagim në Thesar. Pas pranimit të kopjes së faturës ose kërkesës për pagim, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda tridhjetë (30) ditëve të ardhshme, do të bëjë një hetim në organizatën buxhetore për të vërtetuar nëse (i) fatura ose kërkesa për pagim është e vlefshme dhe se

mallrat dhe shërbimet janë furnizuar ose punët janë realizuar, dhe (ii) shuma përkatëse nuk është paguar nga organizata buxhetore për një periudhë me të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë. Nëse rezultati i hetimit del të jetë pozitiv, Thesari do e paguan shumën në fjalë pa pasur nevojë të marrë miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore. Në raste të këtilla, Thesari është i autorizuar që të ekzekutojë një njoftim për bartjen e shpenzimit pa miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore.

ii. Konstatimet e Gjykatës

253) Fakete e prezentuar nga Prokurori për të justifikuar akuzën e veprës shpërdorim në detyrë nuk përbëjnë vepër penale si të përcaktuar me nein 340 të KPK-së (Kodi i vjetër) ngase nuk përmbajnë të gjitha elementet e veprës penale.

254) Analizat e rrethanave të rastit shpjen në përfundimin se F.L. dhe N.K. nuk i kanë përvetësuar paratë nga buxheti i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit ngase ata nuk i kanë marrë në posedim nga ai buxhet dhe nuk i kanë përdorë ekskluzivisht për vete. F.L. si Ministër ishte me të vërtetë përgjegjës për përdorim të drejtë të shpenzimeve të fondeve të cilat ishin ishin përvetësuar për organizatën buxhetore për të cilën ai ishte kryesues, sidoçoftë, nuk ekzistojnë prova që ai ka shfrytëzuar paratë për vete. Prokurori nuk pohon se shpenzimi i përshkruar në Aktakuzë nuk ishje kryer në përputhje me Ligjin mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjigjesive dhe në kuadër të kornizës organizative siç parashihet nga ky ligj. Si për të kundërtën, shpenzimi ishte bazuar në kontratat e lidhura ligjrisht në mes të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kompanive të cilat kishin fituar tenderët për rregullime të rrugëve specifike si rezultat i procedurave të prokurimit.

255) Prokurori duket të mos jetë noftuar se paratë e shpenzuara nga buxheti i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit ishte përvetësuar për rregullimin e rrugëve dhe kjo punë ishte kryer nga kompanitë e kontraktuarata.

256) Sa i përket N.K., duhet të theksohet se ai ka qenë Kryesues i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Transportit, dhe për këtë ai ishte përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit. Ai nuk ishte i besuar me ndonjë fond të MTPT-së, prandaj, ai poashtu nuk mund të ketë përvetsuar ato.

257) Prandaj, Gjykata ka hedhur poshtë akuzën e përvetësimit gjatë ushtrimit në detyrës ndaj F.L. dhe N.K..

258) Shkeljet e pohuara gjatë procedurave të prokurimit të cilat ishin bërë nga kompanitë e fituara T. dhe M. (përfshirë në Aktakuzë) bien/përfshihen brenda Pikës 4 të akuzës e cila nuk ishte hedhur poshtë dhe do të spjegohet në pjesën tjetër të arsytimit.

4. Pika 3 ndaj F.L., N.K. E.L. dhe F.Z.

259) F.L., N.K., E.L. dhe F.Z. akuzohen me Lidhjen e kontratës së dëmshme në shkelje të nenit 237 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-se (Kodit i vjetër), të dënueshme me burgim nga një vit deri ne dhjetë (10) vjet, ku kryesit e veprës penale kanë shkaktuar dëme që tejkalojnë shumën e 100.000 Eurove, të lexuar bashkërisht me neinn 25 të KPK-së (Ndihmë) për E.L. dhe F.Z..

260) Prokurori pohon se N.K. më udhëzim të F.L. ka vendosur/lidhur kontratat për tenderët publikë me kompanitë T. dhe M. me qëllim të marrin përfitimin personal (para ryshfet) në shkëmbim. Në rastin e tenderit të mirëmbajtjes gjatë stinës verore 2009, në regionin e Gjilanit, kompania fituese T. përmes ndërmjetësuesit E.L. ka paguar ryshfet F.L. në shumën prej 250.000 Eurosh si dhe partnerëve të tij të ngushtë.

261) Kontratat e vendosura ishin të dëmshme sepse ato ishin kompani më të lira që përmbushnin kriteret formale në procesin përkatës të ofertimit, që ishin në gjendje të kryejnë punën në mënyrën e duhur. Dëmi i shkaktuar në mendimin e Prokurorit arrin të paktën deri në vlerën e përgjithshme të tenderit siç e specifikuar në Pikën 1 e cila shumë është 2.467.607,50 Euro.

i. Ligji i zbatueshëm

262) Pasi që në vazhden e procedurës penale ndaj të pandehurve kodi penal ishte ndryshuar, Gjykata duhet të e vërtetojë se cili ligj është më i favorshëm për kryerësin. Krahasimi i elementeve të një veprës penale të Lidhjes së Kontratës së Dëmshme në që të dy Kodet Penale shpjen tek përfundimi se ligji më i favorshëm për të pandehurit është ky i riu.

263) Neni 237 i Kodit të vjetër KPK lexohet si në vijim:

1) *Personi i autorizuar a përfaqësuesi i organizatës së biznesit apo personit juridik që ushtron veprimtari ekonomike dhe lidh kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit ose për personin juridik apo lidh kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit apo personit juridik dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.*

(2) *Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 i këtij neni merr rryshfet apo nëse shkakton dëm në shumën e cila tejkalon 100,000 euro dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.*

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i hyrë në fuqi me 1 janar 2013 parasheh se neni 291 si në vijim:

1. *Personi përgjegjës i cili ushtron veprimtari ekonomike që lidh kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit apo që lidh kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit, dënohet me burgim prej tre (3) muajë deri në tre (3) vjet.*

2. *Kur kryesi i veprës nga paragrafi 1. i këtij neni merr rryshfet ose shkakton dëm në shumën që tejkalon njëqindmijë (100.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.*

264) Në përputhje me nenin 291 të KPK-së vepra penale e Lidhjes së Kontratës së Dëmshme mund të jetë kryer vetëm nga personi përgjegjës i cili është i angazhuar në veprimtari ekonomike dhe përmes veprimatrisë së tij/saj shkakton dëme për organizatën e biznesit.

265) Neni 120 (7) i KPK-së përkufizon organizatën e biznesit si një person fizik apo juridik ose grup personash që merren me veprimtari ekonomike, siç përcaktohet dhe rregullohet me Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Ligji Nr. 02/L-0123). Në përputhje me nenin 2 (2.1) “Shoqëri Tregtare e Kosovës” është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas këtij ligji, p.sh Ndërmarrjet individuale, shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

266) Kodi Penal i Kosovës (Kodi i vjetër) në nenin 237 paragrafi 1 siguron tjetër përkufizim të veprës penale të Lidhjes në Kontartë të Dëmshme duke siguruar se Personi i autorizuar a përfaqësuesi i organizatës së biznesit apo personelit juridik që ushtron veprimtari ekonomike dhe lidh kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit ose per personin juridik apo lidh

kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit apo personit juridik.

267) Në mendimin e Gjykatës përkufizimi i veprës të lidhjes në kontratë të dëmshme si parashihet me Kodin Penal (Kodin e Ri) është më i favorshëm për të pandehurit meçë kategoria e subjektëve në fjalë që është në gjendje të kryejë një vepër të tillë dhe mundësia për palë të dëmtuara është padyschim më e ngushtë.

ii. Konstatimet e Gjykatës

268) Gjykata konstaton se veprimet e supozuara të F.L., N.K. dhe E.L. nuk e dëmtojnë organizatën e biznesit sië parashihet me nenin 291 të KPRK-së. MTPT nuk përbën “organizatë biznesi” në kuptim dhe përkufizim sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare

269) I Pandehuri i vetëm që mund të kryer këtë vepër penale është F.Z. i cili është person përgjegjës që duke vepruar për kompaninë T.. Megjithëse nuk ka arsye të besohet se me një lidhje të kontratave me MTPT ai i shkaktoi ndonjë dëm kësaj organizate/shoqërie tregtare. Fare e kundërta, kontratat për kompaninë T. për mirëmbajtjen/ndërtimin e rrugëve ishin fitimprurëse.

270) Prandaj, Gjykata e hudh poshtë akuzën e lidhjes së kontratës së dëmshme ndaj F.L., N.K., E.L. dhe Floim Zukës.

5. Pika 4 ndaj F.L., N.K. dhe E.L.

271) F.L., N.K. dhe E.L. akuzohen për vepër shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit ne shkelje të nenit 339 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së (Kodi i vjetër), dhe të dënueshme me burgim nga një deri në tetë vite, lidhur me nenin 25 të KPK-së (Ndihmë) për E.L. neni 23 të KPK-së (në bashkë-kryerje) për F.L. dhe N.K., përvec kesaj si e lexuar lidhur me nenin 117.1 a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe rrjedhimisht të lexuar lidhur me krimet si në vijim të marrjes së rryshfetit si të specifikuar në Pikën 5 të akuzës.

272) Prokuroi pohon se F.L., N.K. dhe E.L. hanë shpërdorur pozitën e tyre zyrtare duke negociuar, premtuar respectivisht shpërblyer kompanitë ndërtimore T. dhe I.-E. për rregullimin e rrugëve me tenderë në kërkim të rryshfetit. Tenderët ishin dhënë duke iu shmangur dhe manipuluar

rregullat ligjore te prokurimit në shkelje të nenit 6.2 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili ndalon favorizimin e një kompanie mbi tjetrën në ndonjë fazë të procedurave të prokurimit.

i. Ligji i zbatueshëm

273) Neni 339 i KPK-së (Kodi i vjetër) i zbatuar nga Prokurori në Aktakuzë lexohet në pjesët përkatëse si më poshtë:

(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

274) KPK i cili ka hyrë në fuqi me 01 janar 2013 Kodi Penal i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013 përcakton një përkufizim më të lehtë të ndryshëm të kësaj vepre penale, poashtu ekziston një dallim në dënim i cili mund të shqiptohet.

Neni 422 i këtij kodi siguron:

1. *Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij/saj ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitojë çfardo, dobie për vete ose personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*

2. *Për qëllime të këtij nein, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshin, por nuk kufizohet në:*

2.1. shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit;

2.2. moskrerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj;

2.3. pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfardo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj;

2.4. keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij;

2.5. nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme, ose

2.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.

Nga krahasimi i shkallës së dënimit siç parashihet me dispozitat e lart-cekura Gjykata përfundon se në rastin konkret ku të pandehurit akuzohen sipas cilësimit të veprës penale të paraparë me nenin 339 (3) të Kodit të vjetër KPK-së, Kodi i Ri Penal është më i favorshëm për të pandehurit dhe meçë dënimi i mundshëm është më i ulët. Prandaj në përputhje me nenin 339 paragrafi 1 të kodit të vjetër KPK; Kodi i Ri do të zbatohet.

ii. Konstatimet e Gjykatës

275) Gjykata gjen të domosdoshme të vërtetojë gjatë shqyrtimit gjyqësor pohimet e Prokurorit nëse F.L., N.K. dhe E.L. kanë kryer veprën e shpërdorimit të pozitës zyrtare apo zutorizimit. Analizat e provave të mbledhura nga prokurori gjatë hetimit shpjen në konkludim se ekzistojnë prova të mjaftueshme të arsyetojnë dyshimin mirë të bazuar për këtë akuzë kundër të pandehurëve. Arsyetimi rezulton kryesisht nga analizat e dokumenteve nga procedurat e prokurimit, mendimet e paraqitura nga ekspertët në njohjen e ligjit për prokurimin (duke trguar manipulimetë dhe shkeljet të *Ligjit për Prokurimin Publik*) dhe sendet e marra gjatë bastisjeve të kryera në lokacionet/shtëpitë e të pandehurëve si dhe zyreve të përdorura nga ata. Përveç kësaj, mbështetet nga deklaratat e dëshmitarit M.S.. E gjithë kjo provë do të ekzaminohet tërësisht gjatë shqyrtimit gjyqësor ku palët do të paraqesin qëndrimet e tyre.

6. Pika 5 ndaj F.L., E.L. dhe N.K. dhe Pika 6 ndaj F.Z.

276) F.L., N.K. dhe E.L. akuzohen me marrje të rryshfetit në shkelje të nenit 343 paragrafi 2 të Kodit të Vjetër KPK, të dënueshme me burgim nga gjashtë muajë deri në pesë vjet, lidhur me nenin 23 të KPK-së (bashkë-kryerje), përveç kësaj e lexuar me nenin 117.1 a. dhe d. të Ligjit për Prokurimin Publik.

277) F.Z. akuzohet me dhënie të rryshfetit në shkelje të nenit 344 paragrafi 1 të KPK-së (Kodi i Vjetër), të dënueshme me burgim nga gjashtë muajë deri në pesë vite, lidhur me nenin 23 të KPK-së (bashkë-kryerje), përveç kësaj i lexuar me nenin 117.1. a dhe d. Të Ligjit për Prokurimin Publik.

278) Ekziston një mospërputhje e dukshme në Aktakuzën në mes të akuzave dhe përshkrimeve të saj meqë Prokurori duke arsyestuar akuzën ndaj F.L., N.K. dhe E.L. nuk deklaroi se kanë marrë rryshfet, por vetëm kufizon pohimet e tij në pranimin e premtimeve për rryshfet gjë që është në esencë e ndryshme. Ai pohon se në mes të vitit 2007 dhe 2010 F.L., N.K. dhe E.L. kanë marrë premtime të pagesës së rryshfetit në këmbin të shpërblimit të tenderit në regullimin e rrugëve nga ana e kompanisë “T. Company” F.Z. si pronar i kompanisë T. ka ofruar rryshfet që të marrë dokumentet e tenderit të tij fikse dhe të shpërblehet me fitim të tenderit nga Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit.

i. Ligji në Fuqi

279) Në përputhje me nenin 3.1 të Kodit të Ri Penal, Kodi i vjetër do të zbatohet te të gjithë të pandehurit për akuzën në fjalë meqë është më i favorshëm. Kodi i ri parasheh dënim më të lartë për veprat penale të marrjes apo dhënies së rryshfeteve

ii. Konstatimet e Gjykatës

280) Gjykata Gjykata është e mendimit se ekziston provë e mjaftueshme në mbështetje të dyshimit mirë të bazuar se F.L., N.K. dhe E.L. kanë kryer veprat e marrjes së premtimeve për rryshfet. Poashtu ekziston, provë e mjaftueshme të arsyetojë dyshimin e bazuar mirë se F.Z. ka kryer vepra penale të ofrimit së rryshfetit.

281) Konkludimi i Gjykatës rezulton kryesisht nga analiza e dokumenteve nga procedurat e prokurimit, mendimet e paraqitura nga ekspertët për ligjin e prokurimit dhe sendet e marra

gjatë bastisjes së zhvilluar në lokacionet që ju takojnë të panduhrëve dhe zyrve të vendeve të tyre të punës. Përveç kësaj mëshitet nga deklaratat e dëshmitarit M.S. dhe rezulton me shiritin e përgjimeve të thirrjeve telefonike dhe mesazheve të siguruar nga Prokurori në bazë të urdhërave për marrje të përgjimeve dhe matjeve telefonike urdhërit të lëshuar nga Gjyqtari kompetent. Është e dosmosdoshme të verifikohen të gjitha provat gjatë shqyrtimit gjyqësor.

7. Pika 7 Keqpërdorimi i Autorizimeve në Ekonomi në shkelje të nenit 236 paragrafi 1, nënparagrafi 5 dhe paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës ndaj F.Z.

282) F.Z. akuzohet për veprën penale Keqpërdorim i Autorizimeve në Ekonomi në shkelje të nenit 236 paragrafi 1 nënparagrafi 5 dhe paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës-KPK.(Kodi i Vjetër) të dënushme me burgim nga një deri në tetë vite.

283) Akuza bazohet në pohimet se në mes të 21 Marsit 2008 dhe 17 prill 2008, F.Z. në cilësi të pronarit të firmës “T. Compnay” seriozisht ka shkelur rregullat e veprimtarisë së biznesit duke zhvilluar, respektivisht duke lejuar marrëveshjen për caktimin të çmimit me Z.K. Kompaninë (tenderi për meremetimin e rugës Ponesh- Zhegovac në Gjilan), pronar i së cilës është vëllau i tij N.Z., pa e zbuluar bërë të ditur që të dy kompanitë do të punojnë s’ bashku, si rrjedhim përbëjnë shkelje të nenit 66.2 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ofertat të cilat iu ishin dhënë T. dhe Z.K. Kompanitë përmbajnë çmime identike në pozitat e kërkuara për të cilat ofertat duhej të specifikoheshin. F.Z. në këtë mënyrë ka manipuluar, përkatësisht toleruar manipulimin e procedurave të ofertimit gjë është supozuar të jetë e pa drejtë.

284) Mënyra e njëte ishte zhvilluar dhe zbatuar nga F.Z., në cilësi të pronarit të Kompanisë T. në lidhje me tenderin e *Mirëmbajtjes së Rrugëve Regjionale gjatë Verës në Gjilan gjatë vitit 2008* (në mes të 11 shkurtit dhe 24 prillit 2008) derisa ka lidhur/ nënshkruar marrëveshjen e çmimit fiks me kompaninë E. e cila udhëhiqet nga I.S.. Tenderi ishte fituar nga një kompani tjetër-e quajtur M..

285) Si rrjedhim lidhur me këtë akuzë Prokurori deklaroi se F.Z. ka rregulluar rrugën Ponesh-Zhegovac, me dëmtime/dëfekte përkundër dijenisë se këto dëfekte nuk do të pranohen

zyrtarisht nga MTPT, ai në këtë mënyrë ka kërkuar E.L. të e ndihmojë i cili i ka thënë atij të e vazhdojë punën dhe se nuk do të gjobitet.

i. Ligji i Zbatueshëm

286) Në përputhje me nenin 236 paragrafi 1 dhe nënparagrafi 5 të KPK-së personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili ushtron veprimtari ekonomike do të dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet nëse ai/ajo në ndonjë mënyrë tjetër (sesa që përcaktohet në nënparagrafet 1-4) seriozisht shkel ligjin apo rregullat e veprimatrisë së biznesit të cilat lidhen me asgjësimin, përdorimin apo menagjimin e pasurisë me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pausrore të kundërligjshme për otganizatën e biznesit ose personin juridik në të cilin është i punësuar apo organizatën tjetër të biznesit ose për personin juridik: Dispozita e njëjtë përfshihet në nenun 290 (1) të Kodit Penal të RK-së (Kodi i ri) prandaj Gjykata do të zbatoj Kodin e vjetër KPK meqë kodi ishte në fuqi, kur supozohet se ishte kryer vepra penale.

ii. Konstatimet e Gjykatës

287) Vendosja e për caktimin e Çmimit është një fshetësi në mes të konkuresëve të bizneseve të i vendosin çmimet e tyre të blejnë apo shesin mallra apo shërbime në një nivel të caktuar të çmimit. Ky caktim shpie në përfitim të të gjitha bizneseve apo individëve të cilët janë në një të njëjtn nivel të tregut dhe të përfshirë në këtë bashkepunim fshehtësi, ndonëse cmimet janë caktuar të larta, stabile, me zbritje apo të fiksuara. Kontrolli mbi çmimet shkel ligjin e konkurencës ngase ky kontrollon çmimin në treg apo ofertën dhe kërkesën e mallit apo shërbimit. Kjo i ndalon bizneset tjera që të jenë në gjendje të konkurojnë ndaj bizneseve në cmimin e fiksuar me marrëveshje, e cila i ndalon publikun nga të qenurit në gjendje të presin përfitimet e konkurencës së lirë.

288) Gjykata vlerëson se ekziston prova të mjaftueshme për dyshim mirë të bazuar se F.Z. ka kryer vepër penale për të cilën edhe akuzohet. Kjo mëshitetet nga provat e dokumenteve siç janë dokumentet e tenderëve të paraqitura nga kompanitë; T., M. dhe Z.K., analizat e ekspertëve të dokumenteve dhe dokument zyrtare të dala gjatë procedurave të prokurimit. Vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor do të jetë e mundshme të verifikohet nëse akuza arsyetohet.

8. Pika ndaj F.L., D.L. dhe Fl.L

289) F.L., D.L. dhe Fl.L. akuzohen me shpërlarje të parave në shkelje të nenit 10 paragrafi 2 pika b të Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/02 si të ndryshuar Mbi *Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale* dhe të dënueshme me burgim deri në dhjetë vite me gjobë deri më tre herë në vlerën e pasurisë e cila është subject i veprës penale.

290) Prokurori pohon se D.L. ka investuar ryshfet në para të marra nga familja L. duke i pranuar s'paku tri kredi private në shumën prej 20.000 eurove, 20.000 eurove dhe 9.950 €. Ai për më tutje ishte i përfshirë në pagesën e shpenzimeve ligjore të F.L.. Në nëntor 2011 ai i ka shitur tokë të padeklaruar A. D. për shumën në të holla prej 500.000 eurove. Me 06 dhjetor D.L. ka transferuar shumën prej 316.900 eurove dhe më 24 janar 2012 shumën prej 120.000 euro në llogarinë bankare të avokatit të L.

291) Fl.L. ka depozituar nga paratë e marra me ryshfet që familja L. ka pranuar në para të gatshme me 23 prill 2009 shumën 9.220 euro, me 11 shkurt 2010 5.436,20 euro dhe me 29 prill 2010 një shumë tjetër 1.123 euro në xhirologarinë bankare të klinikës në Vienë.

292) Prokurori pohon se D.L. dhe Fl.L. jetojnë me mënyrën e stilit të jetës që cilën nuk do të ishin në gjendje të e bënin me të ardhurat e fituara të deklaruara zyrtarisht, kjo edhe demonstron se ata janë në posedim të fondeve të padeklaruara.

i. Ligji i Zbauteshëm

293) Në pajtim me nenin 3.1 të Kodit Penal të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/02 si të Ndryshuar Mbi *Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale* do të zbatohet tek të gjithë të pandehurit. Ligji i ri mbi Pastrimin e Parave parashef saktësisht të njëjtat rregulla për këtë vepër penale.

294) Neni 10.2 i Rregullores përcakton si në vijim:

Kushdo që, duke ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale ose kushdo që, duke besuar se pasuria fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimit të zhvilluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/06 të datës 18 mars 2002 Mbi Masat e Fshehta dhe Teknike të Vëzhgimit dhe të Hetimit;

(b) Konvertion, transferon ose përpiqet të konvertojë a transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore a të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij/saj;

295) “Zhvillohet/buron në krim” përkufizohet me nenin 2(1.229. të kësaj rregulloreje dhe që nënkupton çdo pasuri që rrejdhet drejtpërdrejt apo indirekt nga presupozimi i veprës penale. Pasuria e dalë drejtpërdrejt nga presupozimi i veprës penale përfshin pasurinë në të cilën çdo pasuri që rrjedh drejtpërdrejt nga presupozimi i veprës penale dhe .ëe vonë konvertohet, transformohet apo përzihet sikurse një e ardhur, kapital apo përfitim tjetër ekonomik i dalë apo realizuar nga pasuria e tillë në çdo kohë që prej kryerjes së veprës penale.

ii. **Konstatimet e Gjykatës**

296) Parakushti të konstatohet se personi ka kryer veprë penale të pastrimit të parave është një vendosje se ekziston një veprë e presupozuar penale the pasuria të jetë një objekt i pastrimit të parave që rrjedh drejt apo indirekt nga kjo veprë’. Aktakuza është absolutisht e dykuptimtë dhe jo e saktë nga e cila vepra penale paratë pretendohet të i paraprin krimin dhe të dala nga krimi. Prokurori e kufizon veten vetëm për deklaratën se këto janë “para ryshfeti” të pranuar nga familja L. pa shenja, ndonjë detale të këtyre dhuratave të paligjshme ose përfitimeve avantazhe. Nuk është roli i Gjykatës të gjej çfarë Prokurori ka menduar derisa e ka vënë këtë akuzë.

297) Edhe sikur të presupozohet se Prokurori e lidh akuzën e pastrimit të parave me ryshfetet e përfshira në Aktakuzë në Akuzën 6 të saj, vlen të ceket përsëri mungesa e njëtrajtshmërisë, sepse Prokurori përdor ndërkëmbyeshëm “pranimin e ryshfeteve” dhe “pranimin e premtimeve

për ryshfete”. Siç përcaktohet në Aktakuzë, F.L. akuzohet vetëm me pranimin e premtimeve për ryshfete, pasi dhe si e tillë nuk ka tregues se mori para.

9. Akuza 9 dhe 10 kundër G.Z.

298) G.Z. akuzohet me pengim të provave, në shkelje të Nenit 309 paragrafi 2 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim deri në tre vjet, lidhur me Nenin 25 të KPK-së së vjetër (bashkë-ndihmë) dhe me asgjësimin ose fshehjen e materialeve arkivore, në shkelje të 324 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim deri në tre vjet.

299) Rrethanat janë të njëjta për të dyja akuzat kundër G.Z., gjë që pranohet nga Prokurori. Duket se akuza e re u ngrit kundër tij për shkak të nevojës për të vazhduar hetimin kundër tij dhe për të arsyetuar mbledhjen e provave të reja.

300) Prokurori pretendon se i Pandehuri më 28 prill 2010 si mbajtës i çelësave të Ndërtesës së Kuvendit në bashkëpunim me të tjerë të cilët janë ende të pidentifikuar, asgjësoi materialet arkivore të ndodhura në serverin IT, duke refuzuar në mënyrë të përsëritur t’u dorëzonte çelësin e dhomës së serverëve Prokurorit të EULEX-it, Joachim Stollberg, dhe hetuesve të NJHKO-së të EULEX-it ndërkohë që mjediset e MTPT-së kontrolloheshin prej tyre. Megjithëse u informua për urgjencën e situatës sepse kushdo që kishte të drejta administrator mund të fshinte skedarët dhe gjurmët e hyrjes nga distance në këta skedarë, dhe megjithëse iu tha se nuk nevojitej urdhër me shkrim, G.Z. kërkoi të shihte urdhër-kontrolli me shkrim para se të hapte dhomën. Pothuajse dy orë pasi iu kërkua të jepte ndihmën e vet, G.Z. pranoi ta hapte derën e dhomës 206. Para se ta bënte këtë, ai u tregoi hetuesve se të gjithë serverët e MTPT-së ndodheshin në këtë dhomë.

301) Me të hyrë në dhomën 206, G.Z. iu kërkua të tregonte kontrolluesin e domainit, gjë që ai e bëri. Megjithatë, server nuk ishte kontrollues domain dhe për këtë arsye serveri në fjalë nuk u gjet. Pastaj Zogaj tregoi një server tjetër si kontrollues domaini por përsëri, ai nuk ishte ajo që po kërkonin hetuesit. Atëherë hetuesit kontrolluan të gjithë serverët në dhomën 206, por asnjë prej tyre nuk ishte ai që po kërkonin hetuesit. G.Z. u tregoi atyre se serverët e MTPT-së ndodheshin në ndërtesë tjetër por në fund ai u gjet në dhomën 306 të ndërtesës së Kuvendit.

302) Kur hetuesit e gjetën serverin në falë, ata gjetën vetëm katër skedarë të MTPT-së dhe një ikonë për fshirjen e skedarëve.

i. Ligji i zbatueshëm

303) Neni 309 (2) i Kodit të Përkohshëm Penal parashikon si vijon:

Kushdo që me qëllim të parandalimit ose vështirësimit të mbledhjes së provave në procedurën gjyqësore, në procedurën kundërvajtëse, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore fsheh, asgjëson, dëmton ose bën të papërdorueshme, në tërësi ose pjesërisht, pronën e personit tjetër ose dokumentet që mund të përdoren si prova dënohet me gjobë ose burgim deri në tri vjet.

304) E njëjta dispozitë përmbahet në Nenin 394 (2) të Kodit të ri Penal. Prandaj, në pajtim me Nenin 3.1 të Kodit të ri Penal, për të Pandehurin do të zbatohet Kodi i cjetër.

305) Neni 324 i Kodit Penal të Përkohshëm shpall:

Kushdo që asgjëson, fsheh, bën të papërdorshme materialet arkivore apo nxjerr materialet e tilla jashtë Kosovës pa lejen paraprake të organit kompetent dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Neni 416 i Kodit të ri Penal parashikon:

Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme asgjëson, fsheh ose bën të papërdorshme materialet arkivore apo nxjerr materialet e tilla jashtë vendit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

306) Ka një dallim të dukshëm ndërmjet të dy Kodeve, për sa i takon formulimit të elementeve të veprës penale të asgjësimit të materialeve arkivore. Gjykata arrin në përfundimin se Kodi i vjetër do të zbatohet për sjelljen penale të pretenduar të të Pandehurit, sepse ai është më i favorshëm për të. Ky përfundim rezulton nga fakti se nocioni “në mënyrë të paligjshme” ka shtrirje më të gjerë se “pa lejen paraprake të autoritetit kompetent”. Është e mundur që dikush do t’i asgjësonte materialet arkivore në shkelje të ligjit në rastin kur nuk do të kishte organ kompetent për ta lejuar këtë veprim që do të përbënte vepër penale sipas Kodit të ri, por jo sipas atij të vjetër. Nga ana tjetër, kur dikush asgjëson materiale arkivore pa qenë i autorizuar për ta bërë këtë nga një organ kompetent, po vepron gjithashtu në mënyrë të paligjshëm, pasi kompetencat duhet ta kenë burimin e tyre në ligj.

ii. Gjetjet e Gjykatës

- 307) Të dyja akuzat kundër G.Z. bazohen në të njëjtat rrethana faktike – sjellja e tij gjatë kontrollit të kryer në ndërtesën e Kuvendit më 28 prill 2010. Hetimi i parë kundër të Pandehurit u fillua në vitin 2010 për shkak të dyshimit të bazuar se ai asgjësoi qëllimisht ato prova që mund të ishin përdorur në procedurën penale (Neni 309 (2) i KPK-së së vjetër), pastaj pasi kaloi afati dy vjeçar i hetimit, atij iu paraqit akuza e re e asgjësimit të materialeve arkivore, nga Neni 324 (1) i KPK-së së vjetër.
- 308) Nga Aktakuza dhe arsyetimi i Aktvendimit për Fillimin e Hetimit kundër G.Z. është e qartë se e vetmja arsye për t'i paraqitur atij akuzën e dytë ishte të sigurohej një afat tjetër dy vjeçar për të vazhduar kërkimin për prova kundër tij. Gjykata nuk e pranon këtë praktikë, sepse ajo përpiqet të anashkalojë ligjin që përcakton dispozita të rrepta që duhen zbatuar në lidhje me afatin e lejuar të hetimit. Krahas kësaj, shumëfishimi i akuzave bazuar në të njëjtat rrethana është artificial. Një zgjidhje e tillë është në kundërshtim me parimin se askush nuk duhet të dënohet dy herë për të njëjtën veprë penale.
- 309) Gjithashtu, Gjykata nënvizon se emërtimi ligjor i veprës penale sic është parashtruar nga Prokurori nuk është detyrues. Gjykata është kompetente të vjerësojë sjelljen e një të pandehuri në mënyrë të pavarur dhe si e tillë nuk është e detyruar të zbatojë qasjen e sugjeruar nga Prokurori. Të vetmet kufij që Gjykata është e detyruar t'u përmbahet është në lidhje me shtrirjen e Aktakuzës që përfshin të Pandehurin dhe përcakton kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objekti me të cilin lidhet vepra penale dhe mjeti me të cilin u krye vepra penale, dhe rrethana të tjera të nevojshme për të përcaktuar me përpikëri hollësitë e veprës penale.
- 310) Akuzat kundër G.Z. bazohen në raportin e përgatitur nga dy oficerë të policisë të cilët morën pjesë në kontrollin në ndërtesën e Kuvendit të cilët u propozuan nga Prokurori për t'u marrë në pyetje si dëshmitarë. Këta dëshmitarë paraqitën vlerësimin e tyre për sjelljen e të Pandehurit, që nga Akuza u interpretua si pengim i qëllimtë i mbledhjes së provave. Gjykata bie dakord me Mbrojtjen se të gjitha rrethanat e sjelljes së të Pandehurit u interpretuan nga Prokurori kundër të Pandehurit, dhe kështu Akuza nuk mori parasysh ndonjë fakt shfajësues që është e detyruar ta bëjë në bazë të Nenit 46 (7) të KPPK-së.

311) Prokurori nuk e mori aspak parasysh situatën e vështirë në të cilën vepronte i Pandehuri. Në radhë të parë, ai është punonjës i nivelit të ulët në Ministrinë e Administratës (i përshkruar nga Prokurori si “mbajtës çelësash”), i cili papritur u thirr të paraqitej në zyrë për të mbështetur hetuesit e EULEX-it në kryerjen e kontrollit të tyre. Është e qartë se ai dëshironte t’i paraqitej urdhri i Gjykatës që e autorizonte këtë kontroll. Në lidhje me sjelljen e tij të nevojës për të kontaktuar me eprorët e tij për të kërkuar leje për t’i hapur dyert në dhomat e serverëve apo jo, nuk ka asgjë të pazakontë. Ai mund të ishte trembur nga pasojat e lejimit të hetuesve për të hyrë në dhomat e serverëve. Duhet nënvizuar se këta ishin serverë të Qeverisë së Kosovës, një fakt tjetër që duhet ta ketë shtuar frikën e tij për shkak të pasojave me të cilat ai dhe vendi i tij mund të përballeshin për lejimin e njerëzve të tjerë për të pasur qasje në këta serverë.

312) Gjykata gjen se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se G.Z. i kreu veprat penale që i vihen në barrë. Sic është shpjeguar tashmë më lart, provat që u mbledhën gjatë kontrollit të dhomave të serverëve më 28 prill 2010 konsiderohen të papranueshme. Po kështu, me deklaratat e mundshme të hetuesve gjatë shqyrtimit gjyqësor, që raportojnë deklaratat e G.Z. dhe përshkruajnë sjelljen e tij gjatë kontrollit të datës 28 prill 2010, Akuza nuk do të jetë në gjendje të paraqesë prova të mjaftueshme kundër G.Z. për veprat penale me të cilat ai është akuzuar. Kjo është sepse Akuza nuk ka paraqitur asnjë lloj prove se i Pandehuri ka kryer *actus reus* lidhur me të dyja veprat penale, asgjësim ose fshehje të materialeve arkivore dhe pengim të provave, që është asgjësimi i dokumenteve. Fakti se mund të ketë pasur seanca nga distanca dhe ikonë fshirjeje të vendosur në desktop, sic u deklarua nga hetuesit të cilët ishin të pranishëm në vendngjarje, nuk shpie domosdo në përfundimin se dokumentet e ndodhura në serverin e MTPT-së u asgjësuan në atë kohë. Hetuesit e policisë raportuan se nuk kishte tregues të datës ose orës të zbatuar nga programi windows, që do të kishte bërë të mundur të gjurmohet se kush ishte përfunduar seanca nga distanca. Krahas kësaj, ekzaminimi i mëvonshëm i serverit nuk dha ndonjë provë se dokumentet ishin asgjësuar në atë kohë.

313) Po kusht, në lidhje me elementin *mens rea*, vetë fakti që i Pandehuri G.Z. nuk u tregua i gatshëm t’u lejonte hetuesve të EULEX-it qasje në serverët e Qeverisë së Kosovës nuk mjafton për të arritur në përfundimin se ai veproi me dashjen për të penguar provat ose ndonjë material arkivor.

10. Akuza 11 kundër F.L.

314) F.L. akuzohet me veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të Nenit 328 paragrafët 2 dhe 4 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim nga një deri në tetë vjet.

315) Prokurori pretendon se nga tetori / nëntori 2009 e tutje deri më 28 prill 2010 dhe nga një datë e papërcaktuar dëri më 28 prill 2010 F.L. ishte në pronësi, përkatësisht kontroll dhe posedim të një pistolete 9 mm, përfshirë krëhërin dhe 10 plumba përkatës, armës me numër 10005 dhe një revolveri të modelit NAA 22 LR Mini, armës me numër L0046. Ai nuk kishte lejen përkatëse për posedimin e tyre. Armet u gjetën gjatë kontrollit në shtëpinë e tij në C..

i. Ligji i zbatueshëm

316) Neni 328 (2) i KPK-së së vjetër parashikon si vijon:

Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 EUR ose me burgim prej një deri në tetë vjet.

Kodi i ri Penal në Nenin 374 (1) parashikon:

Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

317) Pasi ka shqyrtuar sa më lart dhe duke marrë parasysh Nenin 3(1) të Kodit të ri Penal, Gjykata gjen se ligji i ri është më i favorshëm për të Pandehurin dhe për këtë arsye do të zbatohet ligji i ri.

ii. Gjetjet e Gjykatës

318) Gjykata gjen se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se F.L. kreu veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të Nenit 328 paragrafët 2 dhe 4 të KPK-së së vjetër. Ky përfundim rezultoi nga fakti se e vetmja provë për ta mbështetur këtë vepër u shpall e papranueshme sepse ajo u gjet se gjatë kontrollit të kryer më 28 prill 2010 në shtëpinë në C. Prokurori nuk propozoi ndonjë provë tjetër për të mbështetur pretendimet e tij.

11. Akuza 12 kundër F.L.

319) F.L. akuzohet me mosdeklarim të parave të marra për fushatë, në shkelje të Rregullores Nr. 2004/02 të UNMIK-ut, e ndryshuar, *Për pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale*, Neni 10.8 dhe Neni 10.5, lidhur me Nenet 5.1 dhe 5.6, vepër e dënueshme me burgim deri në pesë vjet dhe gjobë deri në 100.000 euro.

320) Më 18 tetor 2007, F.L. mori 5000 euro nga I. M., si kontribut për fushatën politike për fushatën gjedhore të tij për kryetar të komunës së Prishtinës. F.L. nuk deklaroi ta kishte marrë këtë shumë parash.

i. Ligji i zbatueshëm

321) Rregullorja Nr. 2004/02 e UNMIK-ut, e ndryshuar, *Për pengimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të ngjashme*, vendos detyrime për kandidatët e regjistruar, në lidhje me mbështetjen financiare të veprimtarive politike të tyre.

322) Në bazë të Nenit 5.1 të Rregullores, kandidatët e regjistruar nuk do të pranojnë kontribute në para që tejkalojnë 1.000 euro nga një burim i vetëm brenda një dite. Po kështu, Dispozita 6 e këtij Neni i kërkon kandidatit të të vërtetojë se i përmbush detyrimet e mësipërme në formularin e tij/saj të regjistrimit të kandidatëve dorëzuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

323) Neni 10 i Rregullores parashikon përgjegjësinë penale për veprimet dhe mosveprimet që shkelin ligjin. Në bazë të Dispozitës 2, kushdo që, në dhënien e ndonjë informacioni, ose në bërjen e raporteve, vërtetimeve ose deklarimeve sipas (...) paragrafët 4 deri në 7 të Nenit 24, të këtij ligji, me dijeni bën ndonjë deklaratë materialisht të rreme ose me dashje nuk bën të ditur informacion material, kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në pesë (5) vjet dhe gjobë deri në njëqindmijë (100.000) euro.

324) Rregullorja Nr. 2004/02 e UNMIK-ut, e ndryshuar, *Për pengimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të ngjashme*, është zëvendësuar me *Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit Terrorist*, që hyri në fuqi në tetor 2010. Ligji i ri parashikon të njëjtat vepra penale dhe dënime për to si Rregullorja e UNMIK-ut. Prandaj, në bazë të Nenit 3 (1) të KPK-së, do të zbatohet ligji i mëparshëm.

ii. Gjetjet e Gjykatës

325) Interpretimi i dispozitave të Rregullores së UNMIK është i qartë. Jo vetëm kryetari i një partie politike por edhe një kandidat i vetëm i regjistruar është i detyruar të bëjë të ditur në formën e duhur informacionin për mbështetjen financiare të marrë për veprimtaritë politike. Shkelja e këtij detyrimi mund të shpjerë në përgjegjësi penale në rast se përmbushen të gjitha elementet e veprës penale të parashikuara me ligj.

326) Meqenëse ka prova të mjaftueshme (të dhëna nga llogaritë bankare, dëshmia e një personi i cili ka dhënë kontributin) për të mbështetur dyshimin e mirë-bazuar se F.L. kreu veprën penale të mosdeklarimit të parave të marra për fushatë, akuza duhet të vlerësohet nga Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përmbledhje

327) Meqenëse nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se veprat penale u kryen, akuzat e mëposhtme të Aktakuzë rrëzohen:

- krim i organizuar, kundër F.L. dhe D.L. (akuza 1),
- përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, kundër F.L. dhe N.K. (akuza 2),
- lidhja e kontratës së dëmshme, kundër F.L., N.K., E.L. dhe F.Z. (akuza 3),
- pastrim i parave, kundër F.L., F.L. dhe D.L. (akuza 8),
- pengim të provave dhe asgjësim ose fshehje të materialeve arkivore, kundër G.Z. (akuzat 9 dhe 10),
- mbajtje në pronësi, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, kundër F.L. (akuza 11)

328) Akuzat e mëposhtme të Aktakuzës nuk rrëzohen sepse kërkesat për ta bërë këtë nuk janë të bazuara:

- kundër F.L., E.L. dhe N.K., krim i organizuar, në shkelje të Nenit 274 paragrafi 3 të KPK-së së vjetër lidhur me paragrafin 1 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim nga shtatë në njëzet vjet, lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje);
- kundër F.L., N.K. dhe E.L., shpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar, në shkelje të Nenit 442 të KPK të ri, vepër e dënueshme me burgim nga një deri në tetë vjet; lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje) as to F.L. dhe N.K. dhe lidhur me Nenin 25 të KPK-së së vjetër (ndihmë) për E.L.; dhe po kështu lidhur me Nenin 117.1 a dhe d të Ligjit për Prokurimin Publik;
- kundër F.L., N.K. dhe E.L., pranim i rryshfeteve, në shkelje të Nenit 343 paragrafi 1 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet; lidhur me Nenin 23 të KPK-së së vjetër (bashkëkryerje) dhe po kështu lidhur me Nenin 117.1 a dhe d të Ligjit për Prokurimin Publik;
- kundër F.Z., dhënie e rryshfeteve, në shkelje të Nenit 344 paragrafi 1 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet;
- kundër F.Z., keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi, në shkelje të Nenit 236 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 dhe paragrafi 2 të KPK-së së vjetër, vepër e dënueshme me burgim nga një deri në tetë vjet,
- kundër F.L., mosdeklarim i parave të marra për fushatë, në shkelje të Rregullores Ne. 2004/02 të UNMIK-ut, e ndryshuar, *Për pengimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të ngjashme*, Neni 10.8 dhe Neni 10.5 lidhur me Nenin 5.1 dhe 5.6, dhe vepër e dënueshme me burgim deri në pesë vjet dhe gjobë deri në 100.000 euro.

Prishtinë, 1 korrik 2013.

Anna Adamska-Gallant,

Kryetare e Trupit Gjykses

MJET LIGJOR: Kundër këtij Aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës. Ankesa duhet të paraqitet brenda pesë (5) ditëve nga dorëzimi tek pala i vendimit më shkrim (Nenet 249 (6), 250 (4) të KPP-së).